AGIM HAMITI

ODISEJA E NJË DETEKTIVI 2

Ngjarje të jetuara

I

ANARSHI

“*Një popull i mësuar prej një kohe të*
gjatë me një sundim të ashpër humbet
gradualisht edhe vetë nocionin e lirisë.”
XH. Suift

Diksit iu desh të vraponte, për të kapur autobusin në nisje e sipër. Shoferi uli xhamin e i thirri:

— Për ku je?

— Për në Gjirokastër.

Dera e autobusit u hap dhe Diksi nxitoi të hynte. Mbasi u ul, filloi të fshinte djersën. Nuk kishte rënë shi gjatë gjithë verës dhe dielli digjte ende në atë mes shtatori 1991. Ndërmarrja e pastrimit të qytetit e kishte ndërprerë aktivitetin dhe ajri i mbingarkuar me pluhur vështirësonte frymëmarrjen.

Agjensia e autobusëve për në rrethet e tjera gjendej në periferi të Vlorës. Ndanë saj ndodheshin disa grumbuj mbeturinash, që kishin filluar të dekompozoheshin. Në pritje të nisjes së autobusit, udhëtarët bllokonin hundët me duar.

Kjo ishte vjeshta e parë pa diktaturën, të cilën po e pasonte anarshia. Rrëmuja, pasiguria e jetës dhe mbeturinat e dekompozuara si vetë diktatura, do ta shoqëronin për një kohë të gjatë tranzicionin politik shqiptar drejt iluzionit demokraci. Jo rastësisht. Një e keqe më e madhe bën që të kujtohet si e mirë e keqja e mëparshme. Si një bishë e plagosur, diktatura gati gjysmëshekullore hakmerrej për krimet e saj ndaj popullit të keqtrajtuar. Ky ishte misioni i forcave *të reja* politike, që ishin tentakulat e partisë mëmë me makijazh bashkëkohor.

Autobusi u nis. Brenda tij bënte nxehtë, por udhëtarët nuk guxonin t’i hapnin dritaret, pa iu larguar periferisë së qytetit. Ajri i nxehtë ishte më i pranueshëm se era e ndotur që vinte nga jashtë.

Para DP të brendshme – organit simbol të diktaturës – autobusi ndaloi. Dy policë dhe një oficer Sigurimi u ngjitën në të.

— Të gjithë pasagjerët në Gjirokastër shkojnë ? e pyeti oficeri shoferin.

— Jo të gjithë, shumica, – u përgjigj shoferi me një buzëqeshje servile, trashëgim nga e kaluara.

— Pasagjerët e Gjirokastrës do e ndalin vrapin në Greqi, besoj, apo jo ? hamendësoi buzagaz oficeri.

— Nuk e di ; autobusi deri në Gjrokastër shkon.

— E vazhdojnë udhëtimin në këmbë ata, nëpër male, se u duket sikur në Greqi do ta gjejnë shtruar trapezën.

Mandej, duke iu drejtuar udhëtarëve, oficeri shtoi :

— Nuk do t’ju a kontrolloj pasaportat sot, se partia na solli demokracinë, por *rrugë të mbarë*! do t’iu them vetëm atyre, që nuk do ta kalojnë kufirin shqiptar.

Njëri prej policëve i dha një pako shoferit, pastaj të tre ushtarakët zbritën prej autobusit.

I ulur siç ishte, Diksi e fiksoi shikimin mbi birucat e Degës së Brendshme. Iu kujtua dita e arrestimit dhe tha me vete :

«Kush do të jetë i izoluar sot në qelinë nr 3 ?»

Autobusi vazhdoi rrugën përmes blloqeve të ullinjve të moçëm, të cilët po e paguanin shtrenjtë tranzicionin vrastar neokomunist. Këto pemë frutore shekullore, simbol paqeje, nuk ishin cenuar kurrë prej pushtuesve të shumtë që e kishin shkelur tokën shqiptare. Por asnjëri prej këtyre të fundit nuk kishte pasur egërsinë e diktaturës komuniste, e cila po humbiste pjesërisht parajsën e dikurshme, për t'i lëshuar vendin lojës *demokratike* të organizuar prej saj. Diktatura e vlerësonte si pronën e vet gjithçka ekzistonte në atë vend fatkeq me emrin Shqipëri, ku ajo kishte kërcyer valcin e vdekjes për dyzetë e shtatë vjet me radhë. Prandaj nuk pajtohej dot me idenë që t'ia linte të paprekura ato prona popullit, qoftë edhe për të kaluar nga skena në prapaskenë të politikës shqiptare. Qindra ullinj anës rrugës automobilistike ishin prerë, shumë të tjerë kishin humbur degët kryesore. Të merrte malli të shikoje një ulli të pacenuar.

Kafenetë dhe restorantet në qendrat urbane që përshkonte autobusi i kishin mbyllur dyert të bezdisur e të trembur prej plaçkitjeve. Pasagjerët morën frymë të lehtësuar kur panë, më së fundi, një restorant me dyer të hapur vetëm në Ujë të Ftohtë të Tepelenës, ku mund të hanin drekë. Në hyrje të tij dy burra me kallash në dorë vigjëlonin, me qëllim që restoranti të mos ta pësonte si kalaja e Ali Pashait, së cilës i ishin hequr shumë gurë të qosheve.

*

Në të perënduar të diellit autobusi mbërriti në Gjirokastër. Me të zbritur, pasagjerët vrapuan drejt një kioske me xhama të thyer, ku shitej ujë i pishëm.

Edhe në këtë qytet gjurmët e anarshisë dukeshin gjithandej. Anët e rrugëve të kalldrëmta ishin dëmtuar në shumë vende. Institucionet në qendër të qytetit i kishin xhamet të thyer, ndërsa fasadat të tjetërsuara prej zhgarravinave të shumta. Çmimin më të lartë e kishte pagur ish-komiteti i Rinisë. Ai kishte humbur edhe një pjesë të dyerve e të dritareve, veç pajisjeve të brendshme. Urrejtja e verbër e turmave ishte hakmarrë me institucionin që persekutonte rininë në emër moralit të të pamoralshmëve.

Si edhe në qytetet e tjera të vendit, këto akte vandalizmi kishin ndodhur para syve të policisë, e cila në këtë periudhë ishte dyfishuar në numër. Por ata kishin qenë pjesë e kastës diktatoriale dhe rivendosja e rendit pas përmbysjes së monumentit të idolit të tyre ishte jo vetëm e papranueshme për ta, por edhe lënduese. Kur qytetarët ankoheshin tek autoritetet e policisë për shqetësimet që pësonin, ata e kishin në majë të gjuhës përgjigjen hakmarrëse :

— A deshët demokraci ? Shijojeni tani !

Pamja e dëshpëruar e Gjirokastrës – qyteti i lindjes së diktatorit – si edhe e

gjithë Shqipërisë së fundosur në anarshi ngjante si një pankartë e dishepujve të diktaturës, mbi të cilën lexohej:

E shikoni sa shtrenjtë po ju kushton mungesa e Atij ?

II

MIDIS SHTËPISË SË MELIT DHE ASAJ TË DIKTATORIT

« *Bota është e rrezikshme jo aq shumë nga faji i atyre që bëjnë të keqen, sesa nga ata që e shikojnë dhe e lënë të bëhet*. »

A. Ajnshtajn

Diksi e kuptoi që do të ishte e vështirë të gjente hotel në qytetin e rrëmujshëm, ku ritmi i jetës ishte ulur ndjeshëm. Ndoshta edhe ngaqë ishte një zonë kufitare, banorët e së cilës e kishin shijuar kurbetin më herët se të tjerët. Dy hotelet, ku shkoi ai për së pari, i kishin mbyllur përfundimisht dyert.

Duke pyetur kalimtarët e rastit, Diksi arriti të gjente një hotel në gjendje më të keqe nga ç'kishte parashikuar. Një erë mbytëse, e cila linte të kuptohej mungesën e ujit dhe të higjenës, ndihej në të gjitha dhomat përgjithësisht bosh. Disa mobilje të stivosura në korridor e ngushtonin kalimin. Megjithatë Diksi u ndie i lehtësuar që mundi të gjente një strehë për të kaluar natën, ndërkohë që mundësia e të zgjedhurit ishte avulluar prej rrëmujës së qytetit. Pasi i hodhi një sy dhomës së rëndomtë me tre shtretër, ai doli përsëri në qytet.

Instiktivisht u drejtua për në lagjen *Palorto*, ku kishin lindur diktatori Hoxha dhe detektivi Hamit Meli. Po errej. Një tufë qensh rrugaçë luanin ndanë të rrugës së ndriçuar dobët. Duke parë kalimtarin e vetmuar, ata filluan të lehin. Diksi gjeti nja dy gurë në kalldrëmin e prishur dhe vazhdoi rrugën i gatshëm për tu mbrojtur. Por qentë, duke e parë që ai po kalonte nga ana tjetër e rrugës, pushuan së lehuri dhe vazhduan të luanin me njëri-tjetrin.

Shtëpia e lindjes së diktatorit ishte më e ndriçuara e lagjes. Në hyrje të saj ishte shkruar me llampushka të kuqe : *Muze*. Tri llampa të baraslarguara ndriçonin fasadën. Një e katërt bënte dritë tek hyrja, ku Diksi lexoi një afishë befasuese : *Orari i vizitave*. Kureshtar, u afrua tek afisha. Çdo të enjte, të shtunë e të diel, nga ora 14 deri në 18, porta ishte e hapur për vizitorët. Por një shkresë e vendosur rishtas poshtë orarit i pezullonte përkohësisht vizitat :

Për arsye meremetimesh të brendshme, vizitat ndërpriten për një afat të pacaktuar.

Kur Diksi i ktheu krahët shtëpisë që kishte pjellë monstrën dhe u mat të largohej, një siluetë doli nga errësira e i foli :

— Ç'dëshiron, shok ?

Diksi ndaloi dhe u përgjigj :

— Doja të dija orarin e vizitave në muze, por qenkan pezulluar përkohësisht.

— Nga vjen ti ? e pyeti tjetri duke u afruar.

— Nga Vlora.

— Ah, tani e kuptova – i tha ai me një ton miqësor. – Në kohë të luftës, zona operative Vlorë-Gjirokastër ishte më e forta e gjithë vendit. Ndonjë kujtim i

ëmbël i së kaluarës të ka nxitur ta bëje këtë shëtitje nate deri këtu, apo jo ?

— Vetëkuptohet. Por pamja e dëshpëruar e qytetit të Gjirokastrës më trishtoi.

— Për këtë arsye erdhe ta lexoje natën orarin e vizitave ?

— Pikërisht. Zemërimi i turmave është i pakontrollueshëm në këtë periudhë ndryshimesh. Rrëmuja është burim të papriturash të këqija. Shenjat e vandalizmit shihen kudo.

— Kudo, me përjashtim të kësaj shtëpie, – tha i panjohuri duke shtrënguar dhëmbët. – Edhe sikur gjithë godinat e Gjirokastrës të rrafshohen, kjo shtëpi do të mbetet e paprekur.

— Megjithatë vizitat janë pezulluar – e cyti tërthorazi Diksi.

— Nga kujdesi, jo nga frika. Meqenëse janë liruar shumë të burgosur e të internuar këtë vit, ne e dimë që kjo shtëpi atyre u djeg sytë. Ata organizuan përmbysjen e monumentit të udhëheqësit të lavdishëm të partisë sonë. Për të evituar çdo të papritur, është vendosur që të ndërpriten përkohësisht vizitat, derisa gjithë personat e dyshimtë të jenë të survejuar.

— Po ndryshimi i emrit të partisë nuk do t'ia ulë asaj prestigjin në popull?

— Pak. Në të vërtet komunistët fanatikë nuk arrijnë ta kuptojnë dot domosdoshmërinë e transformimit në aparencë të partisë, që t'iu përshtatet reformave politike të Evropës Lindore. Por edhe hardhuca ka mësuar të sakrifikojë bishtin, për të shpëtuar kokën.

Ai i zgjati një cigare Diksit dhe i tha buzagaz:

— Megjithë bashkëbisedimin e përzemërt që po bëjmë, unë jam i detyruar të të kontrolloj pasaportën, para se të ndahemi.

Diksi nuk e mori cigaren dhe, po me të qeshur, e pyeti:

— Cili je ti në të vërtet, që paske të drejtë të më kërkosh pasaportën?

— Një oficer sigurimi – iu përgjigj tjetri, duke shpalosur dokumentin përkatës.

Diksi i zgjati pasaportën. Me të parë emrin e qytetit të lindjes së Diksit, ai e mbylli pasaportën dhe ia ktheu duke i thënë:

— Faleminderit për vizitën këtu, shok.

Ai futi pasaportën në xhep dhe vazhdoi shëtitjen e natës.

*

Diksi e dinte mirë vendndodhjen e shtëpisë së Melit, se, fill pas lirimit nga burgu, ai kishte plotësuar amanetin, që i kishte besuar ish-bashkëvuajtësi në kampin e Qafë-Barit natën e parë të rrëfimit rreth të kaluarës së tij. Si gjithë shtëpitë e tjera të Gjirokastrës, edhe ajo e Melajve ishte e mbuluar me pllaka guri. Dritat ishin ndezur vetëm në një dhomë. Ky fakt i kujtoi Diksit një episod familjar, për të cilin i kishte folur shoku i burgut.

Pas vdekjes së babait, Hamiti, i ri në moshë, ishte bërë agresiv kundrejt pjesëtarëve të familjes. Një ditë, duke bërë fjalë me nënën, i kishte dhënë liri gjuhës më tepër nga ç'duhej:

— Ti je grindavece; për shkakun tënd vdiq babai aq i ri.

Fjalët e pakontrolluara të të birit e kishin hidhëruar shumë nënën e veshur me të zeza. Qysh prej asaj dite, ajo tërhiqej në dhomën e saj pasdarke, pasi u kishte dhënë për të ngrënë fëmijëve. Mbasi fikte dritën, nëna e lënduar lotonte në heshtje. Vetëm mbasi të gjithë fëmijët e saj, përfshirë edhe Hamitin e përlotur, i ishin lutur nënës që ta falte djalin zevzek, ajo kishte qarë për herë të fundit, duke i përqafuar të gjithë një e nga një.

Diksi buzëqeshi, kur iu kujtua kjo ndodhí. Mandej ai i shkëputi sytë prej shtëpisë së Melajve dhe e endi shikimin në udhën e shkurtër gjysmë të ndriçuar deri tek shtëpia muze e diktatorit.

— Çfarë koiçidence! – tha me vete. – Misteret e bëjnë interesante jetën. Si mund ta imagjinonte Diktatori, se tradhëtia e tij e madhe ndaj kombit shqiptar do të bëhej publike pikërisht prej një djaloshi të lindur pranë shtëpisë së tij dhe të rritur në një familje puro komuniste?

III

I BURGOSURI QË S'PRANONTE TË LIROHEJ

"*Ndodh që realiteti të bëhet më fantastik nga fantastikja*."
F. Dostojevski

Duhej të kalonte një vit prej rënies së komunizmit në Evropën Lindore, që të fillonte farsa e demokratizimit në Shqipëri, i cili ishte destinuar të mbetej iluzion, për shkak të faktorëve të jashtëm e të brendshëm. Familja diktatoriale dhe policia e saj sekrete, që kishin sunduar vendin me hekur e zjarr për dyzetë e shtatë vjet, do të sistemoheshin në prapaskenat e politikës, për të kontrolluar me rreptësi *proceset demokratike*, sipas recetave që do të lëshonin vetë. Aktorët e pseudopluralizmit shqiptar do të ishin marionetat e tyre, që për çdo fjalë që do të thoshnin dhe për çdo hap që do të hidhnin, do të merrnin më parë aprovimin e prapaskenës politike. Natyrisht, gjithçka ishte përgatitur e miratuar paraprakisht prej *aleatëve* sekretë, në përshtatje me interesat e tyre afatgjata në rajonin e trazuar të Ballkanit.

Partia e Punës ndryshoi emrin në *socialiste*. Pasuesi i diktatorit ia lëshoi karrigen në krye të partisë një nxënësi të devotshëm të vejushes Hoxha në Institutin e studimeve marksiste-leniniste. Një komunisti fanatik – mik i familjes diktatoriale – iu dha liçenca e krijimit të partisë së parë *opozitare*. Natyrisht, mbasi ishte instruktuar më së miri për këtë rol destruktiv si pseudo i djathtë. E ardhshmja e konfirmoi efikasitetin e trainimit që i ishte bërë.

Megjithatë skenari i *demokratizimit* të Shqipërisë parashikonte edhe thirrjen e disa sloganeve *demokratike*, konform orientimit që kishte dhënë Gorbaçovi në Katovicë :

«…Partia *opozitare*, që do e marrë e para pushtetin, duhet ta shajë komunizmin me degë e me rrënjë. Ajo duhet të mbështesë me fjalë të persekutuarit e regjimit komunist, pa u ofruar atyre pushtet e mirëqenie. Nëpërmjet reformash të studjuara mirë, elita politike komuniste dhe mbështetësit e saj më të devotshëm do të bëhen kapitalistët e ardhshëm, duke ruajtur njëherësh edhe pushtetin në saje të kolegëve tanë *opozitarë*.»

Midis parullave demokratike, më *mallëngjyesja* ishte «Lironi vëllezërit tanë !». Kërkohej kështu lirimi i të burgosurve politikë shqiptarë, ndërkohë që në Evropën Lindore nuk kishte më burgje të tillë.

*

Një turmë e madhe njerëzish, të thinjur brenda telave me gjemba pa e ditur pse, po dilte prej andej pa e kuptuar dot arsyen e këtij fundi të papritur të kalvarit. Një pjesë e tyre nuk kishin më as familje dhe nuk e dinin ku do të shkonin kur liroheshin. Të moshuar, të lodhur, të sëmurë, të çorientuar, këta

ish-të burgosur i hidhnin me ndroje hapat drejt një lirie të pamaterializuar, e cila do të bëhej xhelati i tyre. Pa të afërm, pa strehë dhe ushqim, për ata *jeta e lirë* ishte një liri për të vdekur.

Megjithatë ata kishin fatin e rrallë të liroheshin para paparacëve të medias *së lirë*, që ilustronin arritjet e *tranzicionit demokratik* shqiptar. Ishin të njëjtët gazetarë që kishin vjellë vrer kundër armiqve të partisë dhe që kishin fotografuar poetin Havzi Nelaj në litar para një viti e gjysmë. Deri atëherë të burgosurit politikë i kishin shërbyer diktaturës si kavie njerëzore, për të frikësuar qytetarët *e lirë*, ndërsa tani po shërbenin si objekt show për diktaturën me grim demokratik. Por jo gjithçka rridhte sipas parashikimeve të regjisorëve të kësaj parodie demokratike.

Një ngjarje tragji-komike ndodhi në një rast të tillë para portës së kampit *Përparimi* në rrethin e Sarandës. Një i burgosur politik ish-gazetar, duke njohur midis gazetarëve të pranishëm në *ceremoni* një ish-kolegun e tij, që i kishte dalë dëshmitar në hetuesi e në gjyq, kishte thirrur :

— Nuk pranoj të lirohem në këtë klimë politiko-shoqërore thellësisht të korruptuar. Demokracia e vërtetë nuk është një azil perversësh.

Me këto fjalë, ai kishte hyrë përsëri në kamp.

Gardianët nuk e kishin imagjinuar dot kurrë, se një ditë do t'iu duhej të lironin me forcë një të burgosur. Të dëshpëruar nga humbja e vendeve të punës dhe të privuar nga mundësia e përdorimit të matrakëve në prani të paparacëve, ata u bënë ujë në djersë për t'i imponuar lirinë të burgosurit rebel që bërtiste :

— Burgu është më i sinqertë nga demokratizimi fallco i Shqipërisë. E kam zili Sami Dangllinë, që vdiq para pak kohësh në këtë kamp, pa e parë me sy fare Shqipërinë komuniste.

Dangllia kishte qenë arrestuar në tetor 1944 dhe i kishte mbyllur sytë përgjithmonë pesë muaj para kësaj maskarade demokratike.

— Ç'kohë të çuditshme që erdhën ! murmuriti shefi i gardianëve duke nxituar të mbyllte me shul portën e kampit, nga frika se mos kthehej përsëri i burgosuri i liruar forcërisht.

IV

I BURGOSURI I FUNDIT POLITIK SHQIPTAR

"*Lirimi nuk është çlirim.*"
V. Hygo

Mesnatë. Një veturë e DSJsë hyri në spitalin 2 të Tiranës dhe ndaloi afër pavijonit ku vazhdonin të kuroheshin të burgosur ordinerë. Për një kohë të gjatë ky pavijon kishte shërbyer edhe për kurimin e të burgosurve politikë. Mirëpo qysh prej tri javësh media trumbetonte me të madhe:

«Shqipëria – shtet pa të burgosur politikë.»

Dy persona zbritën nga vetura dhe u futën në zyrën e mjekut roje. Ky i telefonoi drejtorit të spitalit. Dy të sapoardhurit e falënderuan dhe shkuan e u ulën në sallën e pritjes.

Kur erdhi drejtori, njëri prej dy të ardhurve i dha një letër. Mandej u ngjitën të tre në kat të dytë dhe morën një korridor të gjatë. Para derës së parafundit në të majtë, drejtori i spitalit ndaloi. Duke nxjerrë një çelës nga xhepi, ai ia zgjati personit që i dha letrën duke i thënë:

— Në këtë dhomë është.

Tjetri e falënderoi dhe hapi me ngadalë derën. Të tre u futën në dhomë, ku drita ishte e ndezur. Pacienti i vetëm, i mbështetur në jastëk tek koka e krevatit, po lexonte.

— Nuk je shtrirë për të fjetur akoma, Hamit ? e pyeti drejtori i habitur.

— Qyshkur Shqipëria është shpallur vend pa të burgosur politikë, unë kam përshtypjen se nuk ekzistoj më dhe kjo ide e zymtë më vret gjumin. Prandaj doja t'i lodhja pak sytë nëpërmjet leximit, që të më mbylleshin më lehtë. Por vizita juaj në këtë orë nuk më ndihmon për të fjetur.

— Ke të drejtë. Por këta shokët kanë diçka për të të thënë.

Drejtori doli, duke e mbyllur derën pas tij.

Njëri prej vizitorëve i paraqiti distinktivin e DSJsë Melit e i tha :

— Hamit, duhet t'i heqësh rrobat e spitalit, se do vish me ne.

— Ku do shkojmë në këtë orë?

— Na pret shoku Ilir, drejtori i DSJsë.

— Nuk kam më punë me drejtorin e DSJsë unë – ia ktheu me një ton të prerë Meli. – Në e ka marrë malli për mua Ilirin, le të vijë këtu.

— Ai nuk do përtonte fare që të vinte të të takonte këtu. Por bëhet fjalë për një takim sekret dhe, po erdhi këtu, atë e njohin të gjithë.

— Unë kam mbaruar punë me takimet sekrete ; ai kapitull është mbyllur përgjithmonë.

— Shoku Ilir më ka autorizuar të të them se biseda do të jetë e dobishme për ty, jo për interesat e DSJsë. Kam përshtypjen se do të bëje gabim ta nënvleftësoje.

— Edhe ta vlerësoj është gjithashtu gabim. Një i burgosur politik i

sekuestruar mohon vetveten, në qoftë se respekton sekuestruesit e tij.

— Sipas rezultatit të analizave, ti kishte shumë nevojë për trajtim mjekësor. Nuk mendoj se shtrimi në spital, për arsye shëndetësore, duhet cilësuar sekuestrim.

— Ish-bashkëvuajtësit e mi janë liruar para tri javësh, ndërsa mua vazhdojnë të më mjekojnë kundër dëshirës në pavijonin e të burgosurve. Një dhunim i ligjit i bërë qëllimisht nga qeveria është më dashakeq se sekuestrimi.

— Autoritetet shqiptare kanë respektuar me rigorozitet kërkesat e mbrojtësve të tu, Hamit.

— Çfarë?

I turbulluar prej fjalëve të fundit të kuadrit të DSJsë, Meli kërceu nga krevati.

— Ti mund të më bësh njëqind pyetje mua tani, por të gjitha përgjigjet e tyre gjenden në zyrën e drejtorit të DSJsë. Prandaj ne nuk duhet të vonohemi më, por ndërrohu shpejt.

V

PËRSËRI TEK DYERT E DSJsë

"*Kurrë nuk duhet thënë*: kurrë!"
Proverb

Një çerek ore më vonë, vetura ndaloi para godinës së DSJsë. Nën një shi të imët, ish-detektivi qëndroi disa çaste duke kundruar fasadën e bukur të godinës së DSJsë, të cilën e kishte braktisur para katërmbëdhjetë vjetësh. Një fluks kujtimesh e trubulloi…

Ishte djalë simpatik e i hovshëm, kur Meli 19 vjeçar kishte hyrë për herë të parë në zyrat e bukura të DSJsë. Atëherë ai vazhdonte vitin e tretë të shkollës speciale të shërbimit sekret, në të cilën regjistroheshin studentë një herë në katër vjet. Për shkak të një programi shkollor të studjuar posaçërisht, vetëm në vitin e tretë studentët arrinin të kuptonin të fshehtat e profesionit. Pak nga pak, ata e penetronin më së fundi misterin: pas përfundimit të shkollës ata nuk do të ishin vetëm agjentë të shërbimit sekret, por edhe vrasës profesionistë jashtë shtetit për interesat e regjimit diktatorial. Pikërisht vitin e tretë të shkollës studentët ishin të ftuar të vizitonin zyrat e bukura të DSJsë, të tërhiqnin libra në bibliotekën e saj të pasur kryesisht me letërsi policore si edhe të bisedonin e të njiheshin me detektivë në aktivitet.

Kishin mjaftuar vetëm tre vjet veprimtarie në DSJ që Meli të shpallej unanimisht si detektivi më i mirë i shërbimit sekret shqiptar. Pas pesë vjetësh emri i tij do të regjistrohej në librin e artë të rekordeve botërore të detektivëve, që e kalonin shifrën 100 të misioneve të realizuar me sukses.

Mirëpo detektivi Meli kishte arritur ndërkohë ta njihte mirë botën e lirë dhe kjo i frymëzoi gradualisht neverinë për regjimin diktatorial. Pamja e freskët e djaloshit simpatik me shikim ledhatues ia kishte lëshuar gradualisht vendin detektivit të rreptë me shikim shqiponje. Barra e misioneve të kryer për interesat e diktaturës i rëndonte tashmë në ndërgjegje. Rekordet në shërbim të së keqes përbënin një famë lënduese për të. Bota e alkoolit dhe e femrave nuk mjaftonin për të harruar të kaluarën e tij. As shkarkimi i revoltës së brendshme nëpërmjet sharjesh ndaj regjimit, që i kishte shërbyer shumë. Pa i plotësuar të 28 vjetët – moshë në të cilën shumica e detektivëve të botës fillojnë karrierën e tyre – Meli hoqi dorë përfundimisht nga veprimtaria e detektivit.

Ditën që i kishte kthyer krahët portës së DSJsë, Meli ishte zotuar në vetvete, se nuk do të shkelte më aty. Por qysh atëherë kishte rrjedhur shumë ujë nën ura dhe Meli kishte njohur tashmë jo vetëm prapaskenat e shërbimit sekret, por edhe prapaskenat e politikës. Ai ishte i ndërgjegjshëm për brutalitetin që sundonte tej fasadës së qytetërimit bashkëkohor dhe hipokrizia e përgjithshme, që siguronte në aparencë ekuilibrin e botës, e bënte për të qeshur ish-detektivin e rrahur me vaj e me uthull.

Gjithçka kishte qenë anormale në karrierën e Melit: fillimi i hershëm, ritmi i

lartë i zhvillimit si detektiv cilësor, martesa e ndaluar nga ligji, përfituesit e fruteve të veprimtarisë së tij si detektiv [Inteligjencë Servisi britanik], pendesa e thellë e Melit, burgu dhe, sidomos, ofertat e refuzuara në kampin e Qafë-Barit për rifillimin e karrierës së ndërprerë befasisht. Mirëpo pikërisht ky anormalitet i kishte mundësuar Melit depërtimin në thellësitë e prapaskenave të politikës.

Në realitet ai po rikthehej në DSJ as si i mundur, as si fitimtar, por për të folur edhe një herë tjetër me *letra të hapura* me djalin e madh të diktatorit, i cili vazhdonte të drejtonte shërbimin sekret shqiptar. Me instiktin e profesionistit, Meli e parandiente rëndësinë e bisedës kokë më kokë, që do të zhvillonte në ato orë të pasmesnatës me *Dofenin*, i cili gjithsesi kishte humbur disa pendë nga pushteti absolut i dikurshëm. Megjithatë ai ishte i bindur se *Dofeni* i kishte kontrolluar dhe i kontrollonte *proceset demokratike* në Shqipëri jo vetëm me detektivët e DSJsë, por edhe me agjentët e shumtë të policisë sekrete të familjes diktatoriale.

Befas Melit i shkuan sytë tek bordura në oborrin e DSJsë, ku kishte pozuar i vëllai, Dariu, me pranga në duar e duke qeshur. Kjo kishte qenë fotografia që i kishte treguar ndërlidhësi sekret me DSJnë, ditën kur i kishte dhënë letrën që përmbante kushtet e propozimit për rifillimin e karrierës së detektivit.

— Duhet të hyjmë, Hamit, se shoku Ilir po na pret, – i tha njëri prej shoqëruesve.

Ish-detektivi e mblodhi veten dhe hyri bashkë me ta.

VI

NJË TJETËR *DOFEN*

«*Çasti kur ne mendojmë se kemi kuptuar gjithçka na huan pamjen e një vrasësi*.»
E. Cioran

Zyra e madhe e drejtorit të DSJsë, e pajisur me mobilie luksoze, ndodhej në katin e dytë. Dy persona shtatlartë qëndronin në të dy anët e derës. Shoqëruesit e Melit shkëmbyen disa fjalë me zë të ulët me njërin prej tyre. Ky shtypi një buton në anë të derës. Përgjigjja së brendshmi nuk vonoi : mbi derë u ndez një llampushkë jeshile.

Njëri prej rojeve hapi lehtë derën dhe i bëri shenjë Melit të hynte.

Dofeni e priti entuziast. Ai i zgjati dorën ish-detektivit duke e përshëndetur :

— Mirëmbrëma, Hamit ; gëzohem shumë që po të shikoj pas gjashtë vjetësh e gjysmë.

— Mirëmbrëma, megjithëse ka filluar ditë e re, – iu përgjigj Meli duke shtrënguar dorën e flashkêt të drejtorit.

— Vërejtjet e tua nuk kanë qenë gjithmonë pa vend, – i tha buzagaz *Dofeni*. – Por ulu njëherë, pastaj filozofo. Për muhabet të kam ftuar.

Ai shkeli një buton në anë të skrivanisë së lustruar.

— Dy kafe me konjak, – e urdhëroi personin që hapi derën.

Mandej vazhdoi bisedën me Melin :

— Kam pyetur gjithmonë për ty, Hamit. E di që këtë muaj je duke u kuruar në spitalin 2 të Tiranës. Je i kënaqur prej trajtimit mjekësor që po të bëjnë?

— Gjynah të mos jem, gjersa po më trajtojnë kundër dëshirës.

— E pamundur. Mua më kanë thënë që ti ke pranuar të kurohesh, mbasi të shqetësonte zemra dhe veshka, apo jo?

— Fillimisht jam shtruar me dashjen time. Por megjithëse ju e keni shpallur Shqipërinë “shtet pa të burgosur politikë”, mua vazhdojnë të më kurojnë në spitalin e të burgosurve. A është vërtet pa të burgosur politikë vendi ynë?

— Më se e vërtetë.

— Prania ime në pavijonin e të burgosurve dëshmon të kundërtën.

— Aspak. Qysh prej datës 16 maj 1984 ti figuron qytetar amerikan. Një nënshtetas i huaj nuk mund të burgoset politikisht në Shqipëri.

— Atëherë cili është statusi im aktual?

— I papërcaktuar. Praktikisht emri yt nuk figuron më si i burgosur politik shqiptar për qeverinë tonë. Mirëpo në bazë të marrëveshjes sonë me CIAn, është detyrim ligjor i DSJsë miratimi paraprak i amerikanëve për lirimin tënd. Ata të kanë marrë në mbrojtje në gjendjen e të burgosurit politik dhe, ndonëse e dinë mirë se tashmë në Shqipëri nuk ka më të burgosur të tillë, nuk na kanë orientuar si do të procedohet më tej lidhur me çështjen tënde, pas refuzimit për të shkuar në Amerikë. Ne i kemi njoftuar zyrtarisht disa herë për këtë problem dhe

përgjigjja e tyre ka qenë: *prisni udhëzimet tona*. Në këto kushte ne jemi të detyruar të të sigurojmë jetën, duke të mbrojtur njëkohësisht edhe prej ekspozimit publik, për ta pasur më të lehtë largimin nga Shqipëria, po qe se vendimi i CIAs do të jetë i tillë. Kryesisht për këtë çështje doja të takoheshim sonte.

— Sa mund të zgjasë kjo gjendje as mish, as peshk?

— Këtë e dinë mbrojtësit e tu, – u përgjigj i buzëqeshur drejtori i DSJsë.

Kuptohej që zhgënjimi i ish-detektivit prej mbrojtësve amerikanë i sillte kënaqësi *Dofenit*.

— Unë kam kohë që nuk i kam parë mbrojtësit e mi, – tha Meli, pa manifestuar asnjë ndjenjë në pamje.

— Kjo nuk do të thotë që edhe ata nuk të kanë parë ty. Ndoshta preferojnë të të shikojnë pa të folur.

Drejtori i DSJsë nxori një fotografi nga një dosje para tij dhe ia zgjati Melit, duke e pyetur :

— Të ka vizituar ndonjëherë ky mjek ?

— Po, javën e kaluar. Ai kryesonte një komision të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, i cili po vëzhgon gjendjen e spitaleve shqiptare, siç më tha drejtori i spitalit 2.

— Ai është një mjek i CIAs. Ndërsa komisioni i drejtuar prej tij po ushtron një kontroll në spitalet shqiptare, ai vetë kishte për mision të përpilonte një relacion të hollësishëm mjekësor rreth gjendjes tënde shëndetësore. Por ti duhet të tregohesh i duruar, Hamit, mbasi liria e mirëfilltë nuk ekziston për një person me të kaluarën tënde.

— Po për një person me të kaluarën tënde ?

— As për mua.Veçse e kaluara dhe e tanishmja ime janë vetëm një ; nuk ka thyerje midis tyre.

— Por pluralizmi politik u ligjërua dhe turmat vjellin vrer kundër ish-diktatorit.

— Turmat… Gjigantë pa tru në shërbim të të tjerëve. Ne dimë t’i kalërojmë mirë turmat, se jemi mësuar gjithë jetën me brohoritjet e tyre. Në qoftë se deri pardje brohorisnin direkt ne për gati një gjysmë shekulli, duke filluar nga dje turmat po brohorasin emisarët tanë besnikë e të bindur. Lojërat e politikës me turmat janë shumë më joshëse se peripecitë e shërbimit sekret, Hamit. Sikur të kishe pranuar ofertën tonë në vitin 1983, do ta gëzonim bashkë pushtetin edhe sot. Nuk dite të bëje zgjedhjen e duhur atëherë.

— Ti mendon se vetë ke bërë zgjedhje të mirë?

— Në qoftë se ka pasur diçka që më ka munguar në jetë ka qenë pikërisht e drejta e zgjedhjes. Dhe ti e kupton përse. Ky është takimi ynë i lamtumirës dhe unë dua të jem i sinqertë me ty sonte. Kemi të njëjtën moshë, u njohëm nga afër në rrethana të jashtëzakonshme dhe jemi të dy nga Gjirokastra. Koiçidenca të tilla më kanë bërë disi nostalgjik në trajtimin e çështjes tënde; besomë, Hamit. Jemi të dy bij familjesh komuniste.

— Familja e Shuaip Melit ka qenë vërtet komuniste, por ajo e Enver Hoxhës jo.

— Kush e krijoi partinë komuniste në Shqipëri? Pyeti duke qeshur *Dofeni*.

— Miladin Popoviçi.

— Dhe kush e drejtoi partinë e punës për më tepër se katër dekada?

— Një agjent i Inteligjencë Servisit.

— Në rast se nuk heq dorë nga kjo mënyrë të shprehuri, është më mirë të ndahemi qysh tani.

— Pse duhet të heq dorë nga e vërteta, gjersa ti më premtove, se do të më flasësh me zemër të hapur sonte? Çiltërsia është zëdhënëse e së vërtetës.

— Po ti ke folur goxha për këtë çështje; s'e paske shkarkuar akoma vrerin? Mos harro se këshillëtari më i afërt i Titos gjatë Luftës së Dytë Botërore ka qenë pikërisht djali i Çërçillit. Ti ke arritur ta mësosh tani, se prapaskenat e politikës janë shumë më të larmishme se skenat e saj.

— Pikërisht për këtë arsye unë dua të flas sa më shumë për këtë të vërtetë të hidhur.

— Meqenëse është hera e fundit që po bisedojmë bashkë, unë do të ta fal këtë maní tendencioze. Veç mos harro, se ti i ke shërbyer babait tim më shumë sesa unë vetë.

— Si diktator shqiptar, po. Por aspekti më i zymtë i veprimtarisë së tyt eti…

— Mjaft, e kuptova ç'do të thuash, – e ndërpreu *Dofeni*. – Të kam dhënë fjalën që do të flas hapur sonte dhe do ta mbaj. Bile do të të flas më hapur nga ç'mendon ti. Duhet ta mbash parasysh mirë, Hamit, se, në bashkëpunim me Guri Streton, ti ke organizuar një komplot të rrezikshëm, me pasoja të rënda si për ne edhe për ju vetë. Në qoftë se unë nuk do të kisha konstatuar asgjë të drejtë në përçapjet e tua kundër nesh, nuk do të dëshiroja kurrë të ta dëgjoja zërin e as të t'i shikoja më sytë. Por jam i ndërgjegjshëm se edhe unë, po të isha ndodhur në të njëjtat rrethana si ti, mund të kisha vepruar në të njëjtën mënyrë.

— Megjithatë ti nuk ke ngurruar të më gjykoje e të më dënoje katër me vdekje në mungesë, pikërisht për ato që do të kishe bërë edhe vetë, po të ndodheshe në vendin tim.

— Dhe gjithmonë kam hezituar ta zbatoja një vendim të tillë, përndryshe ata nuk do të ishin katër, por një, Hamit.

— Do të kishte qenë më mirë për mua të mos kishe hezituar fare, qysh herën e parë. Në vend që të kisha vuajtur duke luftuar për të pamundurën, do të kisha gjetur prehje në gjumin e përjetshëm qysh prej disa vitesh.

— Përkundrazi, unë jam i kënaqur dhe i lehtësuar në shpirt që të kurseva. Ky është një ngushëllim për mua sot. Ndryshe nga ç'ke menduar ti, unë nuk kam qenë krejt i pandjeshëm ndaj atyre ngjarjeve të trishtueshme. Fakti që ti dhe bashkëluftëtarët e tu kishit të njëjtën moshë me mua më ka impresionuar.

— Ndërsa mua më ka tronditur më shumë se gjithçka fakti që ne vriteshim me njëri–tjetrin për interesat e të huajve.

— Të thashë, Hamit, që mua më ka munguar e drejta e të zgjedhurit në jetë.

— Është e vështirë të jesh i lumtur, pa pasur të drejtën e të zgjedhurit në jetë…

— Të ka qëlluar të njohësh ndonjë njeri vërtet të lumtur në Shqipëri, Hamit?

— Kam njohur dy.

— Ku jetonin këta fatlumë?

— Në Gjirokastrën tonë. Kur isha në gjimnas, unë e kaloja gjithë verën në Virua. Atje kam njohur dy ciganë simpatikë, që peshkonin me grep çdo pasdite. Edhe vetë Viroi ishte bujar me ta: dy ciganët nuk dilnin asnjëherë bosh prej peshkimit. Po të shikonin ndonjë fëmijë të pikur, të veshur më keq se të tjerët, ata i dhuronin një peshk. Në mbrëmje dy ciganët i binin kitarës, gjithë duke shijuar peshkun e freskët të përgatitur në restorant. Ata hanin, pinin, këndonin e qeshnin, duke qirasur me peshk edhe ata që i shoqëronin në këngë. Këngët e tyre i dedikoheshin dashurisë, ëmbëlsisë së jetës, por jo partisë apo politikës. Kurrë nuk i kisha parë të trishtuar, apo të nevrikosur ata dy ciganë. Fytyrat e tyre reflektonin mirësi.

— Ja, pra, që edhe në kohën e diktaturës, të cilën po e shajnë e po e mallëkojnë sot, lumturia ka ekzistuar. Ky është një lajm i mirë për mua – buzëqeshi drejtori i DSJsë.

— Falë mënyrës së tyre të të jetuarit, ciganët dinë t'i bëjnë sfidë mjerimit më mirë se kushdo tjetër. Portretet e dy ciganëve të Viroit janë ngulitur thellë në kujtesën time, për arsye se ata i bënin sfidë mjerimit komunist në Shqipëri.

— Duke pasur parasysh nivelin kulturor të popullit tonë, diktatura nuk ka qenë aq e errët sa përpiqen ta trajtojnë sot kalemxhinjtë, që e ngrinin në qiell dje.

— Përkundrazi, ajo ka qenë e kuqe si gjaku, mbasi me gjak ishte e ngjyer. Veç pasojat e saj ishin shumë të errëta, përfshi edhe injorancën e popullit, për të cilën aludove.

— Atëherë pse i shërbeve ti besnikërisht për gjashtë vjet me radhë?

— Kur flas për diktaturën shqiptare, unë ndihem fajtor, jo një akuzues i thjeshtë i dalë nga radhët e popullit. Kjo është dhe arsyeja që më revolton më shumë.

— Për çfarë e akuzon ti më tepër *diktaturën tonë*?

— Ajo duhet akuzuar për gjithçka. Por veçanërisht vrazhdësia absurde e luftës shkatërrimtare të klasave, mjerimi ekonomik dhe moral që krijoi me formimin e *njeriut të ri* dhe sterilizimi ideologjik i trurit në një sistem arsimor, që prodhonte të shkolluar të pakulturuar, janë plagë me pasoja afatgjata, ndofta edhe fatale për popullin tonë. Hipokrizia po ia helmon gjakun shoqërisë shqiptare.

— Hipokrizia është lënda e parë e politikës kudo, Hamit. Kjo nuk është shpikje e sistemit tonë, por një trashëgimi e lashtë njerëzore. Veset e politikës e kanë katandisur Historinë botërore në gjendje të trishtuar. Sikur jeta njerëzore të zhvishej prej hipokrizisë, jetëgjatësia do të dyfishohej. Por kjo tashmë nuk varet nga vullnete individësh, Hamit. Sa për vrazhdësinë e diktaturës së proletariatit tek ne, jam i të njëjtit mendim me ty në këtë pikë: lufta e klasave në vendin tonë i tejkaloi limitet e normales. Por ti e di mirë që e keqja ecën në dishezë, ndërsa e

mira në malore.

*

— Do të qëndrosh gjatë në këtë post, Ilir? e ndryshoi temën e bisedës ish-detektivi.

— Derisa do të kem sistemuar në vend të sigurtë atë pjesë të dokumentacionit, që nuk duhet të njihet prej pasardhësit tim.

— Do ta përcjellësh në Londër? e pyeti duke qeshur Meli.

— Jo, Londra e disponon tashmë gjithë bazën informative të shërbimit tonë sekret. Unë do ta sistemoj dokumentacionin që të thashë në arkivat e DSJsë me siglën *top sekret*.

— Katër dënimet e mia me vdekje në mungesë përfshihen në to?

— Sonte pres pyetje më të mënçura nga ana jote, Hamit. Ti e kupton mirë që unë nuk kam tani asnjë arsye të jem hipokrit me ty. Përkundrazi, të kam ftuar që të të ndihmoj në ndonjë drejtim. Ti nuk duhet të jesh krejt indiferent për të ardhmen tënde.

— E ardhmja ime ka qenë gjithmonë e zymtë. Çdo mision që unë ndërmerrja si detektiv mund të ishte i fundit në jetën time. Gjatë hetuesisë speciale edhe mund të kisha vdekur. Në kamp, miniera mund të ishte bërë varri im. Gjithashtu ndonjëri prej katër dënimeve me vdekje edhe mund të ishte zbatuar një ditë. Sëmundja e intensifikuar e zemrës mund të më kishte sjellë një fund të papritur. Edhe ti personalisht nuk ke kontribuar pak për tronditjen e mëtejshme të shëndetit tim. Prandaj, për të mbijetuar, mua më ishte bërë natyrë e dytë të jetuarit në pasiguri të plotë. Para se të hyja këtu sonte, pashë bordurën ku ka qenë ulur Dariu, për të përgatitur fotografinë e tij me pranga në duar, të cilën ma tregoi ndërlidhësi në kampin e Qafë–Barit. Pesëmbëdhjetë metra larg derës së kësaj zyre ndodhet muri ku ka kryer tentativën e vetëvrasjes Afrimi. Ti ke qenë syri i këtij cikloni ndëshkues ndaj meje dhe bashkëluftëtarëve të mi, që luftonim kundër interesave të fshehta të të huajve ndaj vendit tonë. Pse sonte u interesoke për të ardhmen time, e cila pothuajse nuk më intereson më?

— I kam dhënë përgjigje pak më parë kësaj pyetjeje: sepse edhe unë mund të kisha vepruar si ti, po të isha ndodhur në të njëjtat rrethana. Mos u habit nga fjalët që do të them tani, Hamit: në pozicionin ku ndodhesha unë, isha i detyruar të bëja edhe diçka që nuk do të më pëlqente ta bëja. Por ta theksova qysh në fillim: e drejta e zgjedhjes më ka munguar në jetë. Meqenëse pranove të takoheshim bashkë sonte, dua të të bëj të ditur diçka të rëndësishme, para se të ndahemi përgjithmonë. Së shpejti ti do të dalësh nga spitali, por peripeci të tjera të presin. Si shqiptar, si gjirokastrit dhe si Ilir, po të them se ke vepruar shumë drejt kur refuzove ofertën e Inteligjencë Servisit në fillim të korrikut 1984, për të shkuar në Amerikë dhe të eliminoje *Kobrën*, kur të të sinjalizonte detektivi anglez, që do të shoqëronte përherë. Ai ishte një kurth anglo-amerikan për ty dhe për gjithë grupin tuaj. Mbasi ti ta eliminoje *Kobrën*, anglezët vetë do t’i

dorëzonin CIAs provat e fajësisë tënde për krimin me ngjyra tradhtie. Atëherë amerikanët do të të eliminonin ty për tradhti dhe nuk dihej sesi do të veprohej më tej me pjesëtarët e grupit tuaj që i tërhoqi CIA në Amerikë. Në këtë mënyrë amerikanët me një gur vrisnin dy zogj: eliminonin *Kobrën*, që iu mbeti si dopjogjashta në dorë, nëpërmjet një vrasësi shqiptar dhe mandej ndëshkonin për këtë *krim-tradhti* ty dhe grupin tuaj, që mori dijeni për bashkëpunimin anglo-amerikan, gjë që atyre jo vetëm nuk iu pëlqen fare, por edhe i shqetëson mjaft. Ishte kjo arsyeja e vërtetë për të cilën këmbëngulën aq shumë, si Inteligjencë Servisi edhe CIA, që ti të pranoje të bëje përsëri detektivin. Ata nuk u munduan të vinin shumë herë në kampin e Qafë-Barit se kishin nevojë për kontributin tënd në radhët e shërbimeve të tyre sekrete, por ti ishe një instrument shumë i përshtatshëm në atë periudhë për të realizuar synimet e tyre, për të cilët të fola. Gjithë propozimet e tyre, që ti të riaktivizoheshe, kanë qenë djallëzore. Kokëfortësia jote të shpëtoi. Kujdes në të ardhmen nga ndonjë lloj tjetër provokimi.

— Të faleminderit. Më së fundi po flasim një herë si shqiptarë e si gjirokastritë me njëri-tjetrin. Mbasi ta lësh këtë post, a do ta kesh të paktën të drejtën për të zgjedhur? e pyeti i buzëqeshur Meli.

— Nuk e di, Hamit. Po e pata, do të dëshiroja shumë të jetoja si njëri prej atyre dy ciganëve të Viroit tonë… Lamtumirë, Hamit!

— Lamtumirë!

VII

NË DHÉ TË HUAJ…

> “*Një komb që rrit fëmijë, të cilët largohen prej tij për të mos i bërë lëshime padrejtësisë, është më i madh në saje të atyre që ikin, sesa të atyre që mbeten aty*.”
>
> A. Ganivet

Pas lirimit të papritur, Meli ndenji vetëm dy ditë në Gjirokastër. Nëpërmjet një personi besnik, ai e vuri në dijeni Diksin, se do të largohej nga Shqipëria. Për disa arsye që nuk ia shpjegonte dot, ish-detektivi nuk e priste dot shokun e tij në Gjirokastër. Ndërkohë ai i rekomandonte Diksit që të dilte jashtë shtetit, ku Meli do ta takonte në rastin më të volitshëm.

Diksi kishte vendosur të shkonte në Athinë, për të parë varrin e babait. Kërkesa e Melit e detyroi ta shpejtonte nisjen. Për këtë qëllim ai bleu një vizë njëmujore për në Greqi tek një gazetar shqiptar. Diksi do ta kalonte për herë të parë kufirin shtetëror i nisur nga qyteti i lindjes së diktatorit Hoxha dhe Melit. Kjo koiçidencë i frymëzoi një ndjenjë të çuditshme.

*

Diksi u zgjua herët, për të marrë autobusin e parë që nisej nga qyteti i Gjirokastrës për në Kakavijë. Qindra persona me viza të rregullta apo të falsifikuara tentonin të kalonin kufirin shqiptar, i cili kishte qenë deri atëherë mollë e ndaluar. Trafiku i klandestinëve, i lëndëve narkotike, i fëmijëve dhe i veprave të artit po konsolidohej.

Me të zbritur prej autobusit në Kakavijë, Diksi e përqëndroi shikimin mbi klonin, që kishte mbajtur të burgosur një popull të tërë për disa dekada. Forma e posaçme e gardhit me tela gjembash mbi tri metra të lartë linte të kuptohej qartë, se diktatura e kishte ndërtuar atë për të penguar arratisjen e shqiptarëve, jo kalimin e të huajve në Shqipëri. Kjo *perde e hekurt* e kishte izoluar Shqipërinë nga bota për 47 vjet. Sa ëndrra shqiptarësh ishin grisur në ata gjemba telash, në tentativë për të fituar lirinë e mohuar! Sipas informacioneve të fundit të shtypit, rojet kufitare kishin vrarë 826 persona shkelës kufiri. Mijëra të tjerë ishin kapur, torturuar e dorëzuar Sigurimit. Dënimi i tyre shkonte nga 15 vjet burg deri në pushkatim për *tradhëti ndaj atdheut*. Tradhtari i vërtetë i atdheut – diktatori Hoxha – dënonte viktimat e tij për krimet që kryente vetë.

Pa i shkëputur sytë prej klonit (sa herë ishte lakuar ky emër në burg!), Diksi kaloi kufirin. Një polic grek i tregoi zyrën ku duhej të merrte vulën e doganës për hyrjen në tokën e huaj.

Një radhë e gjatë kamionësh, furgonësh dhe veturash prisnin kontrollin e

doganës greke, për të hyrë në Shqipëri. Ndonëse nuk kishte shkuar ora dhjetë, vapa të merrte frymën.

Dogana greke e kishte ndërprerë punën për shkak të një incidenti. Shoferi i një kamioni shqiptar kishte refuzuar të shkarkonte gjithë lavatriçet e ngarkuara, me qëllim që doganierët grekë t'i kontrollonin një për një. Ai kishte shkarkuar vetëm gjysmat dhe i ishte lutur policisë greke t'i kontrollonte në kamion pjesën tjetër të lavatriçeve. Një doganier grek kishte shtyrë prej karrocerisë së makinës direkt në xhade një lavatriçe, e cila ishte dëmtuar. I indinjuar prej këtij gjesti brutal, shoferi shqiptar kishte protestuar ashpër. Policët grekë e kishin arrestuar dhe izoluar në një dhomë të doganës, ku po i bënin hetuesinë. Lavatriçet e shkarkuara kishin bllokuar rrugën.

Shoferët e autobusave me destinacion qytete të ndryshme të Greqisë u bënin thirrje pasagjerëve për të blerë bileta. Diksi bleu një për në Athinë. Autobusi nisej në orën 11. Për të kaluar kohën në pritje të nisjes së autobusit, Diksi filloi të vëzhgonte rreshtin e gjatë të kamionëve e veturave. Ata e kishin zënë radhën qysh në mes të natës.

Të lodhur prej udhëtimit, nga pritja e gjatë dhe nxehtësia, shoferët dhe pasagjerët përpiqeshin të gjenin një vend me hije për të fjetur ndopak. Mirëpo territori ishte i zhveshur dhe ata detyroheshin të shtriheshin poshtë kamionëve. Nënat kujdeseshin për fëmijët e shqetësuar nga vapa, të cilët kërkonin ujë herë pas here.

Para një dyqani pijesh freskuese, ndanë të doganës, rreshti i njerëzve në pritje për të blerë diçka vinte duke u zgjatur. Një çift të moshuarish, të mposhtur nga lodhja dhe etja, dolën nga radha dhe u ulën përtokë. Plaku çehreverdhë u shtri dhe mbështeti kokën në prehrin e së shoqes, e cila e mbronte prej rrezeve të diellit me një gazetë. Ai po i bënte shenjë pareshtur, se nuk duronte dot pa e njomur buzën me pak ujë. Sytë e përlotur të gruas së moshuar u luteshin për ndihmë njerëzve që arrinin të blinin ndonjë shishe ujë. Por kujt mund t'i kërkonte ndihmë në mes të asaj rrëmuje, ku nuk njihte asnjeri dhe askush nuk ia hidhte sytë?

Diksi shkoi tek ajo, nxori një shishe ujë nga çante dhe e ndihmoi gruan që t'i jepte të shoqit për të pirë. Mandej ajo piu edhe për vete dhe, e emocionuar, i puthi duart Diksit për t'i shprehur mirënjohjen e thellë.

*

— Sazan, po ti nga mbive këtu, miku im? e përshëndeti papritur një burrë duke dalë nga radha para dyqanit të pijeve.

Diksi u kthye nga ai që i foli dhe njohu një ish-bashkëvuajtës të Spaçit të para 15 vjetësh. Nuk dihej pse të burgosurit atëherë e thërrisnin me emrin *Sobek*, megjithëse ai nuk quhej kështu.

— Në qoftë se nuk gabohem, ti je Sobeku, apo jo? e pyeti Diksi, duke u takuar me të.

— Nuk gabohesh kollaj ti, jo, – ia ktheu ish-bashkëvuajtësi, duke e shtrënguar në krahë. – Po shkon në Greqi, apo po kthehesh nga Greqia? – u interesua ai pastaj.

— Po nisem për në Athinë.

— E mbarë të të bëhet! Unë nga Athina vij. Jam në radhë qysh në orën tre të natës dhe kam akoma edhe tetëdhjetë kamiona e vetura para times.

— Paske blerë veturë? e pyeti Diksi duke qeshur.

— Po. A duhet t'i përshtatemi jetës perëndimore, apo jo?

— Patjetër. Kur ke ikur nga Shqipëria?

— Para nëntë muajsh. Kam qenë ndër të parët që kalova kufirin pas përmbysjes teatrale të komunizmit tek ne.

— Ke siguruar ndonjë vend pune të mirë në Greqi?

— Akoma jo; punoj me hope. Së afërmi shpresoj të siguroj një punë stabël. Po ti, Sazan, ke ndërmend të vendosesh përgjithmonë në Greqi?

— Është herët të mendoj për këtë çështje, Sobek. Unë sapo kam shkelur në tokën greke. Në orën njëmbëdhjetë nisem për në Athinë.

— Po ora është dymbëdhjetë pa njëzetë, – tha duke u shkrehur së qeshuri Sobeku.

— Do të tallesh ti? ia ktheu Diksi duke shikuar orën e tij.

— Jemi në Greqi, Sazan, jo në Shqipëri. Duhen shtyrë 60 minuta përpara akrepat e orës tënde.

— Por unë biletën e kam blerë për në orën njëmbëdhjetë…, tha i shqetësuar Diksi.

— Mos u bëj merak; gjë që rregullohet. Eja të vemi të takojmë shoferin e autobuzit që niset për në Athinë në orën dymbëdhjetë. Besoj se ai do të pranojë të udhëtosh me këtë biletë.

Falë ndërhyrjes energjike të Sobekut, i cili kishte mësuar të fliste greqisht, shoferi i autobusit të mesditës pranoi ta merrte Diksin me një kusht: në qoftë se të gjitha sedilet do të ishin të zëna, ai duhej të qëndronte në këmbë.

Për fat të mirë autobusi u nis me disa vende bosh. Sobeku i dha numrin e celularit të tij Diksit dhe i premtoi se do të interesohej ta takonte, kur të kthehej përsëri në Athinë.

Disa kilometra larg Kakavijës, në mes të një zone të pyllëzuar, katër të rinj dolën ndanë të rrugës dhe i bënë shenjë shoferit. Ky ndaloi autobusin dhe katër klandestinët shqiptarë, të cilët e kishin kaluar kufirin në një zonë malore larg doganës, u futën brenda. Secili prej tyre i dha një shumë lekësh fatorinos dhe u ulën në vendet bosh. Njëri prej tyre u ul pranë Diksit. Gjatë rrugës ai i shpjegoi se ishte hera e dytë që ata të katër udhëtonin në këtë mënyrë, duke i paguar dyfishin e vlerës së biletës fatorinos.

VIII

SURPRIZAT E SHESHIT *OMONIA*

« *Gjëja më e mirë në vend të huaj*
janë bashkatdhetarët që takon atje. »
P.–Zh. Tulé

Në orën dhjetë të darkës autobusi mbërriti në Athinë. Një grup shqiptarësh – midis tyre edhe Diksi – morën një autobus urban në kërkim të ndonjë hoteli të lirë. Pronari i hotel *Mesdheut* u tregua më i shkathët e më kurajoz se kolegët e tij: ai pranoi të strehonte gjashtë shqiptarë në një dhomë me tre krevate, me kusht që secili prej tyre të paguante çmimin e një krevati. Vetëkuptohej që tre vetë do të flinin në dysheme. Në këtë periudhë hotelet më të rëndomtë të Athinës ishin plot me refugjatë nga Evropa Lindore.

Të nesërmen Diksi mori rrugën për në sheshin *Omonia*, me shpresë se mos takonte ndonjë të njohur. Atje konstatoi se shqipja ishte gjuha e dytë më e folur në këtë shesh. Edhe stolat prej dërrase në formë gjashtëkëndëshi, që rrethonin palmat e reja, dominoheshin kryesisht prej shqiptarëve. Përballë këtyre stolave gjendej një bar që i kishin ngjitur nofkën *kafe Albania*, ngaqë shqiptarët përbënin pjesën kryesore të klientelës.

Kur ndonjë *efendiko* grek ndalonte veturën dhe u drejtohej këtyre stolave, shikimet e dhjetëra palë syve binin mbi të në mënyrë lutëse. Secili prej skllevërve modernë përpiqej t'i tërhiqte vëmendjen *efendikoit*, pa e ditur fare se çfarë zanatçiu i duhej atij. Lufta për mbijetesë të vështirë shkaktonte mosrespektimin e rregullave, që ata kishin vendosur fillimisht vetë. Konkurrenca amorale sillte si pasojë zhvleftësimin e ndjeshëm të krahut të punës.

Rivaliteti për të gjetur punë përfundonte jo rrallë në grindje – një spektakël i shumëdëshiruar për *efendikojtë* grekë. Disa punëdhënës të rremë vinin kastile për spektakle të tillë në sheshin *Omonia*. Ata shpreheshin se kishin nevojë për dy punëtorë gjatë një muaji, ose më shumë, dhe bënin sikur ishin të pavendosur për të zgjedhur personat e përshtatshëm. Të nxitur nga këto fjalë, kandidatët e shumtë rrethonin *efendikoin* e rremë, duke i përshkruar aftësitë e tyre për çdo punë. Natyrisht, më të fuqishmit fizikisht fillonin t'i shtynin rivalët e tyre. Kur pëlciste grindja, pseudoefendikoi bënte sikur revoltohej dhe largohej duke qeshur.

Por edhe shtetasit grekë bamirës nuk mungonin. Ata zgjidhnin persona të moshuar apo të vobekët, për t'i punësuar disa ditë në pastrime territori ose shërbime të tjera të jo të vështira. Kishte edhe nga ata – kryesisht gra – që u sillnin veshmbathje apo diçka për të ngrënë klandestinëve, që i ngrysnin ditët në stolat e drunjtë.

*

Në sheshin *Omonia* Diksi takoi disa ish-të burgosur politikë shqiptarë. Në përgjithësi ata bënin punë të rënda fizike dhe mendonin që ta braktisnin një ditë Greqinë, për të shkuar në ndonjë shtet tjetër evropian apo në Amerikë. Ata ndodheshin në Athinë prej disa muajsh. Diksi përfitoi prej bisedave me ta, për të njohur më mirë situatën.

Autoritetet greke nuk i shikonin me sy të mirë ish-të burgosurit politikë shqiptarë. Ndërkohë kishin më shumë shance për të fituar të drejtën e azilit shtetasit shqiptarë që aderonin në shoqatën *Omonia*, për të zgjeruar artificialisht radhët e minoritetit grek në Shqipëri. Një hartë e madhe e gadishullit të Ballkanit, mbi të cilën kufiri grek arrinte deri në lumin Shkumbin, ishte e ekspozuar në korridorin e zyrave të asaj shoqate helenike.

Një mbrëmje Diksi takoi në sheshin *Omonia* dy ish-të burgosur politikë, të cilët më parë kishin qenë dënuar si hajdutë xhepash. Meqenëse kishin qenë mjaft profesionistë për xhepat, diktatura u kishte shtuar edhe nenin e agjitacion-propagandës, për t'i hequr qafe për një kohë më të gjatë. Këta e kuptonin mirë që manteli i të burgosurit politik nuk u shkonte fare për shtat dhe qeshnin me të.

Në Greqi ata kishin rifilluar zanatin e vjetër të xhepave në shoqëri me dy vajza shqiptare të kategorisë së tyre. Ata i treguan Diksit se policia greke i kishte kapur dy herë duke vjedhur. Por jo vetëm që kishin dalë pa lagur, por në polici u kishin dhënë një dokument qëndrimi të përkohshëm, me anën e të cilit ata evitonin raprezaljet, që ushtroheshin herë pas here ndaj klandestinëve në sheshin *Omonia* dhe në pjesë të tjera të Athinës. Ndërsa qindra klandestinë shqiptarë riatdhesoheshin me forcë, ish-xhepistat *politikanë* nuk i trazonte kush. Çfarë funksioni luanin ata në dobi të policisë greke që i llastonte? Vetëm policia dhe ata e dinin…

Në përgjithësi media greke nuk tregohej miqësore ndaj refugjatëve shqiptarë. Këta të fundit ishin akuzuar padrejtësisht në disa raste për prapësi, që nuk i kishin bërë. Por edhe kur dilte në dritë e vërteta, askush nuk e merrte mundimin për t'i përgënjeshtruar akuzat e pabaza, pa le më të kërkohej falje për to.

Megjithatë në dhjetor të vitit 1991 shtypi grek i bëri jehonë pozitive vdekjes së një klandestini shqiptar nga Berati. Një nate të ftohtë 46 vjeçari kishte vdekur i shtrirë në një prej stolave të sheshit *Omonia*. Atë e gjetën punonjësit e pastrimit të qytetit. Pas autopsisë u konstatua se ai e kishte pasur stomakun bosh prej disa ditësh. *Pranoi të vdiste, por jo të vidhte*, titullohej kryeartikulli i një prej të përditshmeve greke më të mëdha, me fotografinë e të vdekurit të ngrirë në stol në faqen e parë të saj.

IX

ZEMËRIMI I AMBASADORIT GREK

« *Argëtimi më i preferuar i grekëve është ngritja e kurtheve*. »
Homeri

Këngët e kurbetit janë më melankoliket e folklorit të çdo populli, që e ka provuar këtë plagë të rëndë shoqërore. Ato u ngjajnë vajeve të kënduara. Ndarja për së gjalli e njerëzve është më dridhmuese se ajo e shkaktuar prej vdekjes. Vdekja është fund i natyrshëm i një jete, ndërsa emigrimi është një frakturë e saj. Emigrimi ilegal është dy herë më i trishtë: ai është një udhëtim drejt së panjohurës përmes ftohtësisë së huaj; një hedhje e zareve symbyllas.

Janë të rralla shikimet që ledhatojnë një klandestin; akoma më të rralla buzëqeshjet dashamirëse. Njeriu detyrohet ta braktisë symbyllas vendlindjen, kur atje ka vdekur shpresa dhe ai nuk ka më ç'të humbasë veç jetës, që i është bërë një barrë e padurueshme. E tanishmja e pasigurtë dhe e ardhmja e dyshimtë e errësojnë jetën e një klandestini. Ai endet si një hije midis të gjallëve, fajtor i pafajshëm.

Shoqëritë moderne bëjnë sikur harrojnë, se shkelja e ligjit nga ana e tyre është shumë më e rëndë nga ai i klandestinëve, që depërtojnë ilegalisht në to. Bota e qytetëruar pretendon se e ka varrosur skllavërinë dhe mbyll sytë përpara këtyre skllevërve modernë të thirrur *klandestinë*, që rropaten ta shesin me çdo çmim djersën e tyre, por nuk ua blen njeri kollaj. Pjesa më e madhe e këtyre klandestinëve vjen prej ish-kolonive, me shfrytëzimin e të cilave janë pasuruar shtetet më të fuqishëm të botës. Këta i presin krahëhapur edhe sot pasuritë e këtyre vendeve, por banorët e tyre të varfëruar i shikojnë vëngër, i quajnë klandestinë. Cilët janë fajtorët e vërtetë, matur me kutin e së drejtës e jo të forcës?

*

Një ditë në sheshin *Omonia* Diksi takoi një ish-të burgosur politik, i cili në mars 1990 kishte hyrë fshehurazi në ambasadën greke në Tiranë, ku kishte kërkuar strehim. Ai ishte ortodoks dhe e fliste mirë gjuhën greke. Megjithë përpjekjet e shumta të autoriteteve të Tiranës, për ta bindur ambasadorin ta dorëzonte qytetarin shqiptar, qeveria greke i njohu këtij statusin e azilantit politik.

Pas një sërë bisedimesh intensive, qeveria shqiptare kishte pranuar t'i jepte vizën të strehuarit në ambasadë, për të ikur në Greqi. Për këtë ai duhej të plotësonte një kusht: të largohej dy ditë nga selia e ambasadës, ku kishte hyrë ilegalisht. I shoqëruar prej dy punonjësve të personelit të ambasadës greke, ai duhej të shkonte në hotel *Dajti*, ku ishte vendosur provizorisht personeli i

reduktuar i ambasadës gjermanoperëndimore, në pritje të ndërtimit të selisë së tyre të re.

Sapo kishte nënshkruar këtë marrëveshje me përfaqësuesit e MP të Jashtme të Shqipërisë, ambasadori grek, shumë i kënaqur, i kishte dhënë një kopje të saj azilantit politik. Duke lexuar tekstin e marrëveshjes, ish-i burgosuri politik e kishte pyetur ambasadorin i tronditur:

— Në cilin hotel duhet të qëndroj unë gjatë dy ditëve të ardhshme?

— Në *Dajti*, pra, bashkë me personelin e ambasadës gjermanoperëndimore. Atje do të jenë edhe dy persona të ambasadës sonë.

— Por sipas tekstit të marrëveshjes, që keni nënshkruar ju, unë duhet të qëndroj në hotel *Tirana*, i cili është një hotel publik.

— E pamundur, – kishte thirrur ambasadori, duke ia rrëmbyer letrën nga dora.

Mbasi e kishte lexuar me vëmendje tekstin e nënshkruar në mirëbesim, ambasadori kishte kërcëllitur dhëmbët i revoltuar:

— Ç'mendojnë diplomatët shqiptarë, se mund të jenë më të djallëzuar nga një grek? Nuk e paskan lexuar mjeranët këtë thënie të Homerit tonë: *Argëtimi më i preferuar i grekëve është ngritja e kurtheve*. Mos u mërzit fare për këtë, djalosh. Tani do të shkoj urgjentisht ta gris marrëveshjen në sy të tyre dhe çështja jote do të zgjidhet, ashtu siç dimë t'i zgjidhim ne grekët mosmarrëveshjet me langaraqët e Tiranës.

Ambasadori kishte dalë duke folur me vete nga inati.

Në darkë, një avion i nisur posaçërisht nga Athina me një njësit të *Asfalisë*, ishte ulur në aeroportin e Rinasit. Ndërkohë pesë vetura të ambasadës greke – në krye ambasadori me mysafirin e tij – u nisën për në aeroportin e Rinasit. Regjimi diktatorial, i cili tallej me ligjin por respektonte shumë frikën, kishte qëndruar gojëkyçur përballë këtij provokimi flegrant të autoriteteve të Athinës.

X

PARA VARRIT TË BABAIT

“*Sytë nuk mund të fiksohen as mbi diellin, as mbi vdekjen*.”
La Roshëfukó

Diksi ishte interesuar me kohë për të mësuar adresën e varrit të babait : *Varrezat e Treta, Athinë*. Për ta gjetur më lehtë vendndodhjen e atyre varrezave, ai kërkoi ndihmën e ish-bashkëvuajtësit që ishte arratisur nëpërmjet ambasadës greke në Tiranë. Ky jetonte e punonte në Athinë dhe e njihte mirë qytetin.

— Mos u bëj merak fare për këtë punë, Sazan, do të çoj unë atje – i premtoi ai.

Në orën katër pasdite ata morën autobusin e linjës për në *Varrezat e Treta*.

*

Babai i Diksit ua kishte lënë amanet të njohurve të tij, që ta varrosnin sa më afër atdheut, kur të vinte dita për këtë punë. Me qëllim që të krijonte mundësi konkrete për një veprim të tillë, ai kishte blerë një copë tokë pranë kufirit grek me Shqipërinë. Mirëpo pronari grek i tokës e kishte zgjidhur menjëherë kontratën e shitjes, sapo mësoi qëllimin e blerësit. Atëherë babai i Diksit kishte qenë i detyruar ta blinte truallin e nevojshëm në *Varrezat e Treta* në Athinë.

Autobusi ndalonte përballë portës së varrezave të sistemuara në mënyrë mbresëlënëse. Diksi dhe shoku i tij blenë nga një tufë lule tek hyrja e varrezave dhe u interesuan në zyrën e informacionit, se në cilën pjesë të tyre duhej të drejtoheshin, nisur nga viti i vdekjes. *Varrezat e Treta* kishin shtrirje mjaft të gjerë, të ndara në blloqe shumë të mirëmbajtur e të pastër.

Shoqëruesi i tij e kuptoi se Diksi dëshironte ta përshkonte në heshtje udhën përmes varrezave, prandaj qëndroi dy-tre hapa pas, duke e shikuar me keqardhje ish-bashkëvuajtësin. Për mendimin e tij, Diksi atë mbrëmje, tek po përshkonte *Varrezat e Treta*, ishte më afër botës së të vdekurve sesa asaj të të gjallëve. Ai e dinte që Diksi nuk kishte arritur ta njihte babanë e tij.

Heshtja e sinqertë e varreve derdhte në ato çaste balsamin e saj në zemrën e Diksit, të plagosur nga hipokrizia e qytetërimit të zhurmshëm. Si një somnambul, ai ecte drejt banesës së përjetshme të babait, ndërsa një mori idesh e ndjenjash buisnin në trurin e zemrën e tij. *A ndodhen vërtet në këtë varr eshtrat e babait* ? ishte pyetja që e torturonte më shumë.

Emocionet i shtoheshin, sa më tepër që i afrohej varrit. Tri gra të reja greke, të veshura me të zeza, po vinin përballë tyre. Njëra nga ato e përshëndeti Diksin dhe i zgjati diçka të mbështjellë në letër të bardhë. I hutuar siç ishte, ai nuk e vuri ré fare veprimin e grekes dhe vazhdoi udhën pa e kthyer kokën anash. Shoqëruesi i Diksit nxitoi ta merrte dhuratën, duke e falënderuar e duke i

kërkuar ndjesë për veprimin e pavëmendshëm të mikut të tij.

Disa minuta më vonë Diksi u ndodh para varrit që mbante emrin e babait të tij. Një epitaf i shkruar në anglisht dhe greqisht zinte dy faqet e një libri të mermertë të hapur tek koka e varrit.

«A është i sinqertë ky epitaf ?» – ishte pyetja që i lindi në mendje në atë çast Diksit.

Nën efektin shpirtëror e psikologjik të misterit të atij varri, ai tha me vete:

«Njeriu është armiku më i madh i njeriut. E megjithatë njerëzimi është krenar për udhëtimin e tij të përgjakshëm në histori… E çuditshme!»

XI

HAKMARRJA E NJË TË PASURI ME INTELEKT TË VARFËR

“*Injoranca është gjithmonë e gatshme të adhurojë vetveten*.”
N. Bualó

Për të përballuar shpenzimet e qëndrimit të tij në Athinë, Diksi punonte në ndërtim. Rastësisht ishte njohur me disa refugjatë të minoritetit grek të ardhur nga Shqipëria. Së bashku me një grup muratorësh vendalinj, ata ndërtonin godinën e një shkolle të mesme.

Investitori – ai quhej Vasil, rreth 45 vjeç – ishte pronar i katër shkollave fillore private. Kjo ishte shkolla e mesme e parë që ai ndërtonte, prandaj vigjëlonte në mbarëvajtjen e punimeve. Vasili qëndronte gjithë ditën tek kantieri i ndërtimit. Ai vëzhgonte gjithë punëtorët dhe ishte i patolerueshëm për neglixhencën më të vogël. Në të vërtetë ajo ishte një punë me sipërmarrje dhe Vasili nuk kishte të drejtë të ndërhynte në organizimin e vogël të punës, por bashkatdhetarët e tij ia toleronin kapriçiot, për hir të investimit të rëndësishëm që kishte bërë. Punimet vazhdonin në katin e dytë, por kur binte shi, muratorët zbrisnin në katin përdhes për të bërë suvatime të brendshme.

Kohët e fundit e shoqja e Vasilit kishte përfituar mjaft nga një trashëgimi e paparashikuar. Kjo i kishte dhënë dorë të shoqit të investonte për ndërtimin e shkollës së re. Trualli ku po ngrihej godina e madhe ndodhej në një lagje periferike të Athinës. Vasili e kishte blerë atë para 23 vjetësh, me një çmim tri herë më të lirë nga sa kushtonte në vitin 1991.

Vasili liste pak frëngjisht dhe i ishte bërë zakon që në pushimin e drekës të shkëmbente dialogje me Diksin. Ai ndiente kënaqësi që ta dëgjonin punonjësit që fliste frëngjisht. Gjatë këtyre dialogjeve të përditshëm Diksi kishte mësuar hollësitë e mësipërme të veprimtarisë ekonomike të Vasilit.

*

Ishte mesi i tetorit 1991. Kishte rënë borë dhe bënte shumë ftohtë. Vasili, gjithmonë prezent në kantier, i nxiste punëtorët të vazhdonin punën. Një ditë dëbore një murator rrëshqiti dhe u vra keq në këmbën e djathtë. Meqenëse do vinte ambulanca për ta marrë, Vasili urdhëroi që të ndërpritej përkohësisht puna dhe i ftoi punëtorët në zyrën e tij të madhe pranë kantierit. Atje u dha të gjithëve nga një gotë konjak për tu nxehur.

Biblioteka personale e Vasilit zinte një faqe muri të zyrës. Dy rafte të saj përmbanin letërsi frënge. Kurioz, Diksi filloi të lexonte titujt e librave, midis të cilëve kishte edhe vepra autorësh të mirënjohur.

Vasili e konstatoi kureshtjen e Diksit dhe i tha me frëngjishten e tij të dobët :

— Po të bën përshtypje sasia e librave në frëngjisht që mbaj në bibliotekën

time ? Është e vërtetë që unë nuk e flas mirë frëngjishten, por lexoj libra në këtë gjuhë prej një kohe të gjatë.

Vasili nuk u drejtohej kurrë në shumës punëtorëve të tij, ndërsa kërkonte prej tyre të kundërtën. Diksi nuk ishte nënshtruar në këtë pikë, por deri atë ditë *efendikoi* e kishte kaluar në heshtje këtë. Punëtorët e tjerë po ndiqnin me kureshtje dialogun, megjithëse nuk kuptonin gjë prej tij.

— Të gjitha këto libra i ke lexuar ? e pyeti Diksi duke treguar me dorë raftet e letërsisë frënge.

— Sigurisht. Pse, ç'mendon ti, se unë i paskam ekspozuar për tu dukur këto libra ?

— Të ka pëlqyer ky ? u interesua Diksi, duke hequr nga rafti *Doktor Zhivagon.*

— Shumë. Të gjithë librat e Sholzenicinit më kanë impresionuar.

— Këtë libër e ka shkruar Boris Pastërnak, – i tha Diksi duke buzëqeshur.

Vasili u vrenjt në fytyrë dhe, duke folur me një ton përçmues, e ngriti zërin:

— Mos i prek me dorë librat e mi, shqiptar! Ato duar janë për lopatën, jo për librat. Madjé, as lopatën nuk do ta prekësh më me dorë në këtë kantier. Do të bëj likujdimin në çast dhe marsh prej këtej!

Shprehjen e fundit Vasili e përsëriti edhe në greqisht, për ta mësuar edhe punëtorët e tjerë vendimin e tij. Mandej nisi rrëmbimthi karrigen me rrota drejt Diksit, i dha shumën e dhrahmive që i detyrohej dhe e urdhëroi të dilte jashtë.

Kur Diksi doli, dëbora ishte dendësuar.

XII

TAKIM I SHUMËPRITUR

“*Miqësia e vërtetë mbetet e pavarur prej ndjenjave të tjera*.”
Shamfor

Pothuajse mesditë. Mbetur pa punë, Diksi u drejtua për tek stacioni i autobusit. U ul në stolin e mbrojtur nga era dhe nxori nga xhepi sanduiçin, që kishte blerë për drekë. Me gjysmën e tij në dorë, ai shkoi të shikonte orarin, se kur kalonte autobusi i radhës në atë stacion periferik të qytetit.

Ndërsa po kontrollonte orarin duke u përtypur, Diksi ndjeu një zhurmë të lehtë, që vinte nga stoli ku kishte qenë ulur. Ktheu kokën dhe pa një qen rrugaç që po hante gjysmën tjetër të sanduiçit. Qeni e rrëmbeu në gojë pjesën që i kishte mbetur pa ngrënë dhe vrapoi nga ana tjetër e rrugës e u zhduk.

— Vasil të quajnë edhe ty ? – thirri Diksi duke qeshur. – Po ai e mori vetë hakën e tij, nuk pati nevojë për ndihmën tënde.

Nuk vonoi shumë dhe autobusi erdhi. Ai pagoi një biletë për në sheshin *Omonia*, i cili ishte azili i të papunëve. Diksit i vinte keq që humbi një vend pune afatgjatë, por edhe t’i mohonte Pastërnakut autorësinë e një libri të mrekullueshëm, që i kishte krijuar aq shumë telashe, nuk e bënte dot.

Sheshi *Omonia* ishte i qetë si asnjëherë tjetër. Pas disa orësh, ai do të gumëzhinte. Grekë e të huaj, refugjatë me dokumente e klandestinë, të papunë e turistë të ngeshëm, të grupuar sipas kombësive, punës që bënin, apo veprimtarisë së përbashkët, e frekuentonin çdo mbrëmje sheshin më të populluar të Athinës.

Diksi bleu një gazetë shqiptare dhe u ul në një stol. Një shi i imët e i ftohtë e detyroi ta ndërpriste leximin. Ai vendosi të hynte në të ashtuquajturën *kafe Albania*. Me të hedhur hapin e parë brenda saj, atij i tërhoqi vëmendjen silueta e një klienti të ulur në një qoshe të pijetores. Diksi u drejtua për tek një tavolinë përballë asaj të personit, që i tërhoqi vëmendjen.

Ai nuk arriti të ulej, mbasi Meli lëshoi një thirrje gëzimi, u çua nga tavolina e tij dhe e shtrëngoi në krahë. Dy miqtë u takuan përmallshëm. Pastaj Meli e ftoi të uleshin në tavolinën e tij.

— Besoj se një gotë uzo e mirë [pija e preferuar e Diksit, sipas bisedave të burgut] i përshtatet shumë këtij çasti, – i tha Meli duke buzëqeshur. – Apo mos dëshiron të dalim prej këtej, Sazan?

— Ndarjen nga gota ti e quan mëkat. Prandaj nuk dua të të nxis në atë rrugë, – ia ktheu Diksi po me të qeshur.

— Mos e çaj kokën për atë punë. Zoti tregohet më i mëshirshëm ndaj mëkatarëve, sesa ndaj të pafajshmëve. Ja, shikomë mua: sot jam më i shëndetshëm nga ti, që qenke dobësuar goxhà. Më mirë dalim, të flasim lirisht. Pastaj kthehemi prapë pranë gotës, kemi kohë. Më prit jashtë, sa t’i paguaj

birrën kamerierit.

*

Kur Meli u bashkua jashtë me Diksin, ky po godiste lehtë, me një ritëm të rregullt, thembrën e këpucës së djathtë pas asaj të së majtës. Ish-detektivi qeshi e i tha:

— Unë jam, Sazan, unë: Hamit Meli, me mish e me kocka. Të përgëzoj për kujtesën e fortë!

Ditën që ishin ndarë në kampin e Qafë–Barit, ish-detektivi me përvojë e kishte këshilluar mikun e tij që, kurdo që të takoheshin bashkë në të ardhmen, ai duhej të bënte patjetër këtë gjest *të rastësishëm*, për tu siguruar se personi që kishte përballë ishte vërtet Meli dhe jo ndonjë sozi e tij. Të njëjtin rol luante ai gjest i thjeshtë edhe për ish-detektivin në adresë të mikut të tij.

— Eja të zbresim në metro, se bëka ftohtë – propozoi Meli.

— Kur ke ardhur në Greqi? e pyeti Diksi.

— Sot është dita e tretë. Erdha kastile të informohesha për ty. Takimi ynë më gëzon pa masë. Para se të vija këtu, isha në Turqi për të takuar një person. Mirëpo ai kishte shkuar në Amerikë. Lashë një numër telefoni atje, me qëllim që të më lajmërojë kur të kthehet. Po ti kur ke ardhur në Greqi?

— Para një muaji.

— Më kanë vënë në dijeni se, pas ngjarjeve të ambasadave në Tiranë, të është dorëzuar ditari special i veprimtarisë së grupit tonë. Ke hedhur diçka në letër?

— Pothuajse gjithçka.

— Një lajm i mirë ky për mua – buzëqeshi Meli i kënaqur. – Megjithëse ato ngjarje nuk mund të publikohen para korrikut 1999, duhet të interesohemi për përkthimin e dorëshkrimit. E ke marrë me vete?

— Po. E kam fshehur në dhomën ku fle.

— Në cilin hotel fle?

— Nuk kam *xhep* që të fle në hotel, – u përgjigj duke qeshur Diksi. – Ditët e para që erdha në Athinë, punova në pastrimin e një ndërtese shumëkatëshe të sapopërfunduar. Pronari më dha çelësin e një dhome qysh atëhere dhe ma ka lënë me kusht që t’i bëj falas punën e rojës natën.

— Ndodhet larg prej këtej godina?

— Nuk të durohet deri nesër?

— Jam kurioz ta di sa faqe mund të dalë afërsisht libri.

— Rreth 300.

— Ky do të jetë vëllimi i parë. Pas ndarjes sonë në kampin e Qafë-Barit, ka pasur ngjarje të tjera të rëndësishme, si në Tiranë edhe në Amerikë, të cilat e bëjnë të domosdoshëm shkrimin e një vëllimi të dytë.

— Unë nuk jam në dijeni të tyre. Fillimisht duhet të sigurojmë informacionet e domosdoshme, pastaj mund të mendojmë për të shkruar vëllimin e dytë.

— Unë i kam siguruar tashmë ato informacione dhe po të them se janë vërtet

interesante, – u përgjigj Meli duke i shkelur syrin. – Edhe personi që unë doja të takoja në Turqi është gjithashtu burim informacioni. Ke mjaft kohë në dispozicion për të shkruar vëllimin e dytë. Sa për përkthimin në anglisht të dorëshkrimit të përgatitur, ne duhet të mendojmë qysh tani. Atë duhet t'ia besojmë një personi besnik, i cili njeh mirë si anglishten letrare edhe shqipen. Por kemi kohë të flasim edhe për këtë çështje, nuk është urgjente. Punon gjëkundi, Sazan?

— Kam punuar deri sot në drekë, por nesër e tutje do të jem pa punë. Më pushoi pronari sot.

— Çdo e keqe ka të mirën e saj. Kështu do të kemi kohë të lirë të bisedojmë shtruar bashkë. Tani eja të shkojmë përsëri në pijetore, të marrim ndonjë gotë bashkë.

Duke shkuar për atje, ata takuan rastësisht dy ish-të burgosur politikë, me të cilët Diksi kishte ndenjur disa herë.

— Hamiti e Sazani përsëri bashkë edhe në Athinë!? tha duke qeshur njëri prej tyre. – Jo, sot nuk do t'ju lëmë vetëm në pjetore.

Të katër ish-bashkëvuajtësit u ulën në të njëjtën tavolinë.

XIII

DIKUR, KËTU…

“*Të kaluarën duhet t’ia lëmë harresës*
dhe të ardhmen Perëndisë.”

Bosyé

Kur dolën nga pijetorja, Meli i propozoi mikut të tij:

— Meqenëse është herët të ndahemi që tani, unë do të shoqëroj deri tek dhoma që fle. Me atë rast, marr edhe dorëshkrimin qysh sonte.

— Bëj pak durim. Shiu paska pushuar dhe ne mund të bëjmë shëtitje bashkë, para se të ndahemi.

— Edhe të udhëtojmë disa stacione me tramvaj shëtitje është, – insistoi Meli.

Pas njëzetë minutash, ata zbritën në një lagje të pastër dhe të qetë të Athinës. Duke biseduar, morën rrugën për tek ndërtesa, ku kishte dhomën Diksi. Ndërsa po i afroheshin asaj, Meli ndaloi hapin dhe me pamje të menduar i tha mikut të tij:

— Ruaj një kujtim të hidhur nga kjo lagje e bukur e Athinës. Dikur, këtu jam plagosur, duke i shpëtuar rastësisht vdekjes. Eja kalojmë nga ana tjetër e bulevardit dhe të marrim rugën e parë në të majtë. Dua të ta tregoj në vend atë ngjarje të trishtuar.

Dhjetë minuta më vonë ish-detektivi u drejtua tek një restorant luksoz, në mes të një kopshti të bukur. Uji i një shatërvani reflektonte ngjyrat e llampushkave, që formonin emrin e restorantit të mirënjohur. Me sytë mbi shatërvanin, ish-detektivi filloi të kujtonte:

— Një natë vjeshte para 17 vjetësh kisha ardhur për të ngrënë darkë në këtë restorant, bashkë me një shok të profesionit. Do të kryenim së bashku një mision. Kur veproja në shtetet fqinje me Shqipërinë, unë përdorja gjithmonë maskë. Për çudi, këtë herë e kisha nënvleftësuar këtë fakt. Kamerierja e kishte marrë porosinë dhe ne të dy po prisnim të na sillte pjatat, kur m’u kryqëzua shikimi me një person, që po më shikonte ngultas. Ai ishte ulur në një tavolinë disa metra më tej. Vetëm. Kuptohej që sapo kishte ngrënë darkë, se kamerierja nuk i kishte hequr akoma pjatat bosh para tij. Kur shikimet na u kryqëzuan për së dyti, e njoha. Ai ishte një banor i lagjes sime në Gjirokastër, i cili ishte arratisur para dy vjetësh nga Shqipëria. Me sa dukej edhe ai u bind se kush isha unë, sepse u çua nga tavolina dhe shkoi tek banaku. Ndofta donte t’i telefononte policisë.

«E vura në dijeni shokun për rrezikun që na kanosej, duke ia bërë të qartë se duhej të largoheshim menjëherë, përndryshe… U çuam dhe dolëm nga restoranti me hap normal. Ne ishim pikërisht këtu, kur bashkëqytetari im i arratisur doli tek dera e restorantit. E porosita shokun ta evitonim deri në pamundësi përdorimin e armëve pa zhurmë që kishim dhe t’iu fshiheshim përgjimeve të ndjekësit. Po vraponim në gjysmëerrësirë, duke ndryshuar shpesh drejtim.

Mirëpo edhe ai ishte i ri e i shkathët dhe e njihte më mirë nga ne vendin. Madjé, shtjellimi i mëtejshëm i ngjarjeve tregoi, se ai ishte bashkëpunëtor i *Asfalisë*, i përgatitur mirë. Arrestimi ynë do t'i shpërblehej me një gradim të rëndësishëm.

«Frynte erë e fortë dhe binte shi. Duke manovruar me shpejtësi, synimi ynë ishte që të arrinim në një park, i cili ndodhet 200 m prej këtej. Ja ku duken majat e pemëve të parkut. Në qoftë se ai do të guxonte të na ndiqte edhe në errësirën e parkut, ne nuk do ta kursenim më atje. Mirëpo ndjekësi e kishte nuhatur qëllimin tonë dhe po nxitonte të na priste rrugën. Për një çast u ndodhëm ballë për ballë me të, në një distancë rreth 15 m. Ai kishte pasur gjithashtu revole me silenciator dhe shtiu. Plumbi më kapi paksa mbi rrëzën e kofshës së djathtë. Shoku im nuk hezitoi më: me dy të shtëna të njëpasnjëshme, ai e rrëzoi përtokë agresorin. Nuk dinimin nëse ishte vrarë, apo plagosur rëndë. Synimi ynë i vetëm ishte të largoheshim sa më parë e sa më shumë prej andej. I mbështetur mbi supin e shokut, vazhdova të ecja edhe ca. Mandej këmba m'u mpi dhe nuk e ngulja dot më fare. Shoku ma lidhi fort tek gjuri këmbën e pantallonës dhe më mori në krahë. Ishim të detyruar të largoheshim sa më shumë, për të pasur një farë sigurie. Në qoftë se ndjekësi ynë ishte akoma gjallë dhe jepte alarmin, apo ndokush e gjente atë rastësisht të vrarë, policia do të ndodhej shpejt në vendin e ngjarjes.

«Pasi e përshkoi gjithë parkun me mua në krahë e i mbytur në djersë, shoku vazhdoi të ecte akoma, gjersa gjeti një vend për të më fshehur, i cili nuk dukej i përshtatshëm për një gjë të tillë në shikim të parë. Ai më pozicionoi mirë në mes të disa shkurreve jo të gjata, më dha në dorë revolen time dhe më porositi: *Mos e përdor armën, Hamit, po nuk të erdhi rreziku përpara këmbëve. Unë do të shkoj urgjentisht në ambasadë dhe shpresoj të kthehem shpejt për të të marrë. Mirë të gjetsha!*

«Shiu po shtohej, ndërkohë që vazhdonte erë e fortë. Nxora nga xhepi sekret një ampulë helmi me efekt të menjëhershëm dhe e vendosa tek jaka e këmishës. Selia e ambasadës sonë nuk ishte më tepër se një kilometër nga vendi ku qëndroja unë i fshehur. Kjo më bënte optimist për kthimin e shpejtë të shokut. Përveç hyrjes kryesore, ambasada kishte edhe një hyrje tjetër të vogël nga pas, sekrete. Çelësin e saj e mbante një kuadër i shërbimit sekret shqiptar, pjesëtar i personelit të ambasadës.

«Shiu, frika dhe shpresa po më ndihmonin të mos humbisja ndjenjat. Për fat, shoku u kthye në kohë. Pasi kishte vëzhguar me vëmendje përqark, ai erdhi me gjithë një person tjetër tek unë. Ata më ngritën në krahë dhe më çuan tek vetura, që priste rreth 100 m më tej. Pas disa minutash ishim në ambasadë, ku u morën urgjentisht masat për trajtimin tim mjekësor. Ndërkohë DSJ u informua për ç'kishte ndodhur. Të nesërmen në mëngjes mbërriti në ambasadë kirurgu ynë më i mirë, Petro Cani, i cili më operoi dhe më qëndroi tek koka dhjetë ditë. Mandej u ktheva në Shqipëri i shoqëruar prej tij.

*

Duke përfunduar tregimin e ngjarjes së trishtuar, e cila për pak do t'i kishte kushtuar jetën, ish-detektivi e endi shikimin për disa çaste mbi fasadën e restorantit, ku kishte porositur darkën pa pritur ta konsumonte, tek shkallët që i kishte zbritur me nxitim, nëpër kopsht ku kishte vrapuar për t'i shpëtuar ndjekjes së bashkatdhetarit të tij … Një rini e përgjakur në shërbim të diktaturës, që e flijoi detektivin e saj më të mirë në kampet e tmerrshëm të punës.

Pas disa çastesh, ai u dha zë ndjenjave që po e mundonin:

— Sa e tmerrshme është të bëhesh viktimë e një diktature, që i ke shërbyer verbërisht! Në këtë rast fundi i dhimbshëm i ngjan një vrasjeje të dyfishtë: morale dhe fizike. Nuk ke të drejtë të ankohesh dhe pendesa ta dyfishon brengën.

— Më vjen keq të të shikoj të trishtuar sot, ditën e takimit tonë pas shtatë vjet ndarjeje, – i tha Diksi.

— Mos u shqetëso për këtë, Sazan. Ti e di mirë që kriza të tilla periodike janë bërë tashmë të zakonshme për mua.

Pastaj, si për të kompensuar trishtimin, Meli buzëqeshi e shtoi:

— Megjithatë unë ruaj edhe një kujtim të ëmbël nga kjo lagje e Athinës. Më 1971 kam njohur një vajzë të bukur, e cila vazhdonte vitin e fundit të liceut. Ishte virgjëreshë.

— Ja, pra, edhe ti e paske *përgjakur* këtë lagje, – ia ktheu Diksi duke qeshur.

Meli gjithashtu qeshi dhe të dy morën rrugën për tek pallati ku kishte dhomën Diksi.

XIV

MË FAL… MIKU IM !

“*Mos e zgjuani brengën që flë* !”
Zh. Rënàr

— **N**ë cilin kat e ke dhomën? e pyeti Meli, kur arritën tek hyrja e pallatit.

— Në të nëntin. Do lodhesh pak, se nuk e kanë instaluar akoma ashensorin. Por djersitja i bën mirë mbipeshës tënde.

— Ashtu është. Kur ishim në Qafë-Bari, ti djersije gjithmonë, ndërsa unë rrallë.

— Tani ndodh e kundërta. Unë jam i freskët, ti, ja…

Diksi kaloi gishtin tregues mbi ballin e ish-detektivit, ku shquanin bula djerse.

— Të premtoj se për një muaj do të humbas tre-katër kilogramë.

— Është bast i humbur ky për ty.

— Pse? E paske humbur besimin tek vullneti im?

— Rakia ta dobëson vullnetin ty.

— Mirë, do të shikojmë pas një muaji.

— Do të shikojmë.

Kur mbërritën tek dera e dhomës, Diksi e hapi me çelës dhe ftoi mikun të hynte i pari. Ky nuk pranoi të ulej në karrigen e vetme dhe qëndroi në këmbë në mes të dhomës, duke shikuar me një buzëqeshje të zbehtë komoditetin modest. Pastaj iu afrua dritares dhe e shëtiti shikimin e tij të zymtë mbi vilat e asaj lagjeje të gjelbër të Athinës. Me një zë të thyer, iu drejtua Diksit :

— Gjatë kohës që bashkëpunonim në kampin e Qafë-Barit, si Guri edhe Afrimi më kishin thënë :

«Kur do të ulemi një herë pa maskë në tryezë bashkë me Sazanin, të flasim lirisht, të pimë e të qeshim, pa na përgjuar njeri.»

«Për fat të keq Afrimi nuk e mbijetoi dot luftën e ftohtë kundër Inteligjencë Servisit. Ndërkohë Guri me shumicën e anëtarëve të grupit tonë – përjashto tre të heshturit në DSJ – ndodhen nën komandën e CIAs. Ata sakrifikuan shumë, pa rezultat konkret. Megjithatë fati yt më trishton më tepër se gjithçka. Nuk e kisha imagjinuar dot kurrë, se do të të takoja një ditë në dhé të huaj në kushte të tilla. Më fal, miku im !

Zëri iu drodh dhe ish-detektivi nxitoi të hapte dritaren, për të evituar shikimin e Diksit. Këtij i erdhi keq për dëshpërimin e Melit dhe u përgjigj :

— Nuk je ti shkaktar i fatkeqësisë sime, Hamit, përkundrazi. Ti refuzove ofertën e CIAs, për të mos më braktisur në kampin e Qafë-Barit. Bashkëpunimi i amerikanëve me aleatët e tyre të përhershëm anglezë në dobi të diktatorit tonë, ishte një fataltet për ne të gjithë. Madjé, për gjithë popullin shqiptar. Megjithatë unë kam bindjen se është më e denjë të jetosh i zhgënjyer, sesa i gënjyer. Në qoftë se ne jemi të pafuqishëm për të mposhtur keqbërësit tanë, le të kemi kurajën t’i përbuzim si deri sot ofertat e tyre, që synojnë të na mbyllin gojën.

— Të faleminderit, Sazan. Paskemi pasur vërtet fat të keq shumë. Prej kësaj dritareje unë shikoj vendin ku kam qenë plagosur dikur dhe ku ndjekësi ynë humbi jetën. Dy bashkatdhetarë, dy bashkëqytetarë që vriteshim midis nesh për interesat e të huajve. Ai donte të luftonte diktaturën shqiptare, duke goditur mbi mua me armë greke ; unë mendoja se mbroja interesat dhe prestigjin e vendit tim, duke kryer gjithë ata misione në dobi të anglezëve ! Çfarë drame ! Më duket sikur dorëshkrimi yt do të na ngushëllojë disi për atë që ka ndodhur, prandaj doja ta shikoja qysh sot.

— Ja ku janë blloqet, – i tha Diksi, duke i nxjerrë nga një qeskë poshtë dyshekut.

Kureshtar, ish-detektivi filloi t'i shfletonte, duke përpirë me sy paragrafë të veçantë, që i tërhiqnin vëmendjen. Çehreja i ndryshoi dhe sytë po i ndrisnin tek po lexonte fragmente prej odisesë së tij.

— Do filloj ta lexoj qysh sonte, – i premtoi ai Diksit. – Nesër mos më prit para orës shtatë të darkës në sheshin *Omonia*. Deri atëherë shpresoj ta kem përfunduar së lexuari dhe mund të diskutojmë konkretisht për të.

Diksi deshi ta shoqëronte deri tek dera e pallatit, por Meli e kundërshtoi :

— Jo, jo, nuk është nevoja të zbresësh me mua. Unë tani nuk jam më vetëm. Përkundrazi, shoqërohem prej një truproje të zgjedhur : gjithë anëtarët e grupit tonë dhe kundërshtarët tanë gjithashtu.

XV

LYPSARI I VOGËL

> “*Zemra e rëndomtë e begatisë nuk i kupton dot ndjenjat delikate të lindura nga mungesa e fatit*.”
>
> Shatobrian

Ishte ora shtatë e gjysmë e darkës. Meli nuk po dukej akoma në sheshin *Omonia*. Diksi po shëtiste me vëmendjen për t’i evituar personat e njohur. Ai donte të ishte vetëm, kur të vinte ish-detektivi. Kjo ishte ora e *invazionit* të sheshit nga turmat e njerëzve të ngeshëm. Atje nuk e gjeje dot kollaj personin e dëshiruar, pa lënë orë e vend takimi fiks.

Një gazetar grek, i cili kishte mësuar të fliste shqip, e frekuentonte rregullisht sheshin *Omonia*. Atë ditë ai po vrojtonte kureshtar veprimet e një lypsari të vogël shqiptar. Ky ishte nga Peqini dhe po lypte në hyrje të metrosë. Ai u ndente dorën të gjithë atyre që hynin apo dilnin nga metroja. Kur mërzitej, ai i përqeshte nga pas krahëve ata që nuk ia vinin veshin, apo i shante në gjuhë të tij. Sjellja kurajoze e lypsarit të vogël e impresiononte gazetarin, i cili nuk e shikonte për herë të parë. I habitur, gazetari po i thoshte një të riu shqiptar:

— Qysh prej një jave, po e ndjek me vëmendje jetën e këtij çunaku, i cili e kalon natën i vetëm në metro. Megjithëse fëmijë, larg prindërve e vendit të tij, ai manifeston një guxim të admirueshëm. Fëmijët grekë të moshës së tij kanë frikë të ecin vetëm natën në lagjen e tyre. Parmbrëmë ai shau një qytetar shqiptar, pa e njohur. Bashkatdhetari iu kthye, e kapi për qafe dhe e kërcënoi. Veç ta shikoje sa lajkatar u bë lypsari i vogël në ato çaste! I buzëqeshte gjithë dashamirësi dhe i kërkoi ndjesë, duke i shpjeguar, se e kishte pandehur grek. Shqiptari i fali diçka dhe u largua duke qeshur.

Ndërsa gazetari po i thoshte këto fjalë djaloshit shqiptar, një i ri grek i dha lypsarit, për tu talluar, një dërrasë të vogël që mbante në dorë. Lypsari i vogël e falënderoi dhe i bëri nga pas krahëve një gjest, që shkaktoi të qeshurat e gjithë atyre që e panë. Gazetari përfitoi nga rasti, e thirri në emër lypsarin dhe i dha një çokollatë.

— Sa vjeç je? e pyeti.

— Dhjetë.

—Shkon në shkollë ?

— Shkolla ime është metroja.

— Po mësuesit e tu ?

— Kalimtarët.

— A ke prindër në Shqipëri ?

— Vetëm nënën; babai më ka vdekur.

— A e lajmërove nënën, kur u nise për në Greqi?

— Jo, ajo ishte e sëmurë; në spital.

— Me kë ke ardhur në Greqi?
— Polic je ti?
— Jo, gazetar.
— Të vërtetën po më thua?
— Po. Ti e thua të vërtetën?
— Kur s'kam frikë.
— Nga kush ke frikë?
— Edhe sikur të ta thosha, ti nuk do të më shpëtoje dot, përkundrazi. Por, pas gjithë këtyre pyetjeve, a mund të të bëj edhe unë një?
— Pse jo?
— Ti më thirre në emër; nga e ke mësuar?
— Ky djali me mua është shqiptar; ai ma tregoi. Por unë të jap fjalën si gazetar, se do të të shpëtoj, po ma tregove me cilin ke ardhur në Greqi.
— Bah ! Shqiptar është dhe ai që më ka sjellë mua këtu. Kjo copa e dërrasës, që mbaj unë në dorë, është më besnike për mua, sesa ky djaloshi hqiptar që rri me ty. Lamtumirë, i dashur gazetar ! thirri lypsari i vogël, duke u larguar me vrap.

*

Dy metra larg gazetarit dhe lypsarit, Diksi e kishte ndjekur me vëmendje dialogun e tyre, ndërkohë që shikonte nga ana tjetër. Papritur dikush ia bllokoi sytë nga prapa. E kush tjetër, veç ish-detektivit?
— E kishe humbur fare, Sazan. Çfarë shikoje andej me aq kureshtje?
— Asgjë, – u përgjigj ai me zë të ulët. – I mbaja sytë kot andej, por në të vërtet isha i përqëndruar në dëgjimin e bisedës së këtij gazetarit grek me dy shqiptarë.
— Ku e di ti që është gazetar ai ?
— E njohin shumica e shqiptarëve. Meqenëse flet shqip, shoqërohet vazhdimisht me ta. Është korrespondent i gazetës së madhe *New York Times*.
— Si duket ia paskan caktuar detyrë shtëpie njohjen nga afër të jetës së refugjatëve dhe klandestinëve shqiptarë në Greqi. I themi të na shkruaj një artikull për dorëshkrimin tonë në atë gazetë prestigjioze? e pyeti duke qeshur Meli.
— Le të flasim njëherë bashkë sot për dorëshkrimin, pastaj do ta kemi më të lehtë t'ia bëjmë një propozim të tillë dhe atij.
Ata shkuan në një park të vogël, ku kishte qetësi.

XVI

DY PROFESORËT SHQIPTRO – AMERIKANË

"*Gjysma e një miku është gjysma e një tradhtari*."

V. Hygo

U ulën në një stol. Meli ndezi një cigare dhe mori fjalën:

— E lexova i emocionuar dorëshkrimin. Nganjëherë më dukej sikur ato ngjarje ishin pjesë e jetës së dikujt tjetër, i cili m'i tregonte nëpërmjet atij dorëshkrimi. Herë tjetër kisha përshtypjen se ato ndodhí ishin zhvilluar vetëm disa ditë më parë. Kur lexoja ndonjë episod të harruar, e quaja mëkat harresën. Por intensiteti i lartë i atyre ngjarjeve dhe kushtet e kampit të punës e justifikojnë edhe harresën. Prandaj u kisha kërkuar shokëve të grupit, qysh në fillim, që të përgatisin ditarin e posaçëm. Dhe ja, sot ne disponojmë një dorëshkrim dhe duhet të mendojmë për përkthimin e tij në anglisht.

— Sikur e kishe një ide për zgjidhjen e këtij problemi ti, apo jo?

— Po. Kur isha në Turqi, një mik intelektual më lavdëroi punën cilësore të dy profesorëve shqiptaro-ameikanë, të cilët kanë shkruar libra të mirë në të dy gjuhët. Njëri prej tyre – profesor Bano – është historian i njohur. Miku im mbante marrëdhënie të rregullta me të dhe i dinte adresën dhe numrin e telefonit. Emri i dytë i cituar prej tij ishte ai i profesor Pepës, nënkryetar i shoqatës *Vatra*. Dikur, ai ka qenë i burgosur politik në Shqipëri. Pas lirimit nga burgu është arratisur. Miku im nuk i dinte as adresën, as numrin e telefonit profesor Pepës. Por mund t'ia gjente kollaj nëpërmjet profesor Banos. Si mendon, cilit prej këtyre dy profesorëve duhet t'ia besojmë dorëshkrimin ?

— Meqenëse profesor Pepa ka vuajtur në Shqipëri si i burgosur politik, shpresoj se ai do të pranojë ta përkthejë dorëshkrimin. Mendoj se është një detyrë morale dhe shpirtërore për një ish-të burgosur shqiptar të hedhë dritë mbi këtë të vërtetë dramatike të popullit të tij. Ndërsa profesor Bano ka qenë thjesht një spektator në largësi i zhvillimit të ngjarjeve në Shqipëri.

— Në shikim të parë ashtu është. Por kur isha në aktivitet si detektiv, kisha konstatuar se organizimi i emigracionit shqiptar linte shumë për të dëshiruar. Persona të arratisur prej vetë Sigurimit të Shtetit – jo rrallë me biografi të keqe – kanë penetruar lirisht në radhët e tij, duke mbjellë grindje e përçarje. Megjithëse detektivët e DSJsë godisnin për vite me radhë intelektualët më cilësorë e më aktivë, emigracioni politik shqiptar në Evropë nuk arriti kurrë të organizohej, për t'i bërë ballë situatës kërcënuese. Mendoj se edhe emigracioni shqiptar në Amerikë nuk ndryshon cilësisht.

— Meqenëse profesor Pepa është nënkryetar i shoqatës *Vatra*, ai ka mundësi të bashkëpunojë edhe me ndonjë koleg tjetër për përkthimin e dorëshkrimit tonë.

— Kjo shoqatë është një gjest simbolik patriotizmi, për të ngushëlluar brengat prej mërgimtarësh anëtarët e saj. Por të siguroj, se edhe në radhët e atyre ka të

arratisur prej Sigurimit shqiptar. Madjé, për shërbime të tilla përzgjidheshin intelektualë mjaft të përgatitur, të aftë për të realizuar synimet e caktuara nga Tirana. Shoqata *Vatra* ekziston prej një kohe shumë të gjatë, por sa e ka ndihmuar ajo konkretisht çështjen shqiptare ? Vetëm fjalë pa bereqet. Megjithatë ne nuk kemi zgjidhje tjetër më të mirë për përkthimin e dorëshkrimit. Veçse dua të të paralajmëroj që të mos befasohesh, po qe se profesor Pepa do të kthejë përgjigje negative. Mentaliteti i *Vatrës* është i amerikanizuar, ashtu si edhe ai i shumicës dërrmuese të shqiptarëve që jetojnë atje. Prandaj ata e kanë më të lehtë t'i kthejnë krahët vendit e popullit të tyre, sesa Amerikës që e vlerësojnë si atdheun e tyre shpirtëror.

XVII

ZHGËNJIM

« *Miqtë e rremë të së vërtetës janë dallëndyshe që duken në kohë të mirë e zhduken në kohë të keqe*. »
M. Safadi

Meqenëse nuk e dinin adresën e profesor Pepës, dy miqtë vendosën t'ia dërgonin dorëshkrimin profesor Banos me postë rekomande. Për këtë qëllim, ish-detektivi i kërkoi mikut të tij në Turqi të fliste paraprakisht me profesor Banon për dorëshkrimin e dy të burgosurve politikë shqiptarë. Mbasi profesori dha *ok*, Meli e Diksi përgatitën kolinë postale. Nëpërmjet një letre, Diksi informonte profesor Banon lidhur me preokupimin e përkthimit të dorëshkrimit në anglisht. Ndërkohë i lutej që ta vinte në dijeni profesor Pepën për ekzistencën e dorëshkrimit, duke ia postuar nëse ky do të tregohej i gatshëm për diçka të tillë. Në letër ish-detektivi shkruante një paragraf me dorë të tij :

Lidhur me ngjarjet kryesore të dorëshkrimit, unë disponoj prova materiale të pakundërshtueshme. Në qoftë se ju do të dëshironit t'i shikonit kur të përfundoni përkthimin e dorëshkrimit, jam i gatshëm t'ju a tregoj.

Pas dy javësh mbërriti përgjigjja inkurajuese e profesor Banos. Mbasi falënderonte Melin dhe Diksin për mirëbesimin e treguar ndaj tij, ai e vlerësonte dorëshkrimin me fjalët : *E lexova dorëshkrimin dhe e kam gjetur shumë interesant*. Ndërkohë i njoftonte se dorëshkrimin do t'ia postonte profesor Pepës në New York.

*

Pas dhjetë ditësh u përgjigj profesor Pepa. Sikur letrën e tij ta kishte shkruar ndonjë agjent i revoltuar i FBIsë, me siguri ajo nuk do të përmbante aq shumë mllef dhe nuk do të karakterizohej prej atij agresiviteti aq cinik. Gjithmonë shërbëtorët e nënshtruar e servilë janë shumë më hidhnakë, sesa padronët me pamje hipokrizisht të buzëqeshur e korrektë në dukje. Teksti i letrës ishte një himn kushtuar ndershmërisë së politikës amerikane dhe shprehte pakënaqësi ndaj ngjarjeve të dorëshkrimit. Ky fakt e shqetësoi ish-detektivin:

— Ky reagim i profesor Pepës manifeston hapur mospajtim me përmbajtjen e dorëshkrimit, megjithëse unë zotohesha se isha gati t'i paraqisja provat materiale përkatëse, nëse dëshironte. Por ai ka frikë t'i hyjë kësaj meseleje dhe gjen si zgjidhje pa telashe t'i bjerë shkurt. Ndoshta qëndrojnë të tjerë persona pas tij, që ia diktojnë një sjellje të tillë. Ai paragraf i letrës, që unë e shkrova me dorën time, përbën një provë të rrezikshme për mua në duart e profesorit të dyshimtë dhe të atyre që qëndrojnë pas tij. Edhe sikur ai të mos pajtohej në asnjë pikë me dorëshkrimin – pavarësisht se unë tregohesha i gatshëm t'i tregoja prova –

kishte të drejtë të refuzonte, por jo të akuzonte ne pa arsye e t'iu thurte lavde amerikanëve. Në këto rrethana unë jam i detyruar t'i zhduk sa më shpejt gjurmët e mia nga Athina. Do të shkoj në gadishullin e Peloponezit, ku kam një bazë të sigurtë. Më vonë do të rikthehem e do të gjej vetë. Mirupafshim, Sazan!

Kënaqësia e takimit të tyre të papritur ia la vendin ndarjes urgjente – dhuratë e profesorit të amerikanizuar në ekstrem.

*

E ardhmja e afërt vërtetoi dyshimet e ish-detektivit me përvojë. Nuk vonoi dhe profesor Pepa e njoftoi Diksin se dorëshkrimi i kishte humbur, gjë për të cilën i kërkonte ndjesë.

Diksi e kishte tashmë të qartë se për çfarë lloj *humbjeje* bëhej fjalë. Madjé kishte dyshuar për këtë qysh kur mori përgjigjen agresive prej tij. Diksi vendosi t'i ruante dy letrat e profesor Pepës dhe atë të profesor Banos.

Kur kohë më vonë mori vesh vdekjen e profesor Pepës, ai tha me vete :

«I shkreti, profesor, e quante veten të pavdekshëm ! Ndoshta ia ka shpërblyer dorëzimin e dorëshkrimit FBI-ja, duke i treguar parrullën e kalimit në Parajsë, të paktën.»

XVIII

PËRBUZJE NDAJ PAFAJËSISË SË MOHUAR

« *Kohë boshe, e dëshpëruar, prej së cilës fluturojnë vetëm disa minuta në ditë për jetën e saj të vërtetë*. »

A. M. Matute

I mbetur vetëm, Diksi e ndjeu sërish ftohtësinë e jetës së emigrantit. Ngandonjëherë në mbrëmje ai takonte bashkatdhetarë të tjerë të njohur. Gjatë bisedave me ta, ai mësonte episode prekëse të jetës gri të refugjatëve dhe klandestinëve shqiptarë.

Pas rënies së *perdes së hekurt*, ambasada amerikane në Athinë kishte intensifikuar veprimtarinë e saj, për t'iu përgjigjur kërkesave në rritje për azil politik, të cilat vinin nga qytetarë prej të gjithë Evropës Lindore. Sipas procedurës, kandidatët paraqisnin atje kërkesë me shkrim të arsyetuar dhe CV. Të njëjtën ditë ambasada u caktonte datën e dëgjimit të intervistës së tyre. Pas dhënies së intervistës, pretendentit për azil i bëhej e njohur data, kur duhej të paraqitej përsëri atje, për të marrë përgjigjen përfundimtare të kërkesës.

Në raport me popullsinë, azilkërkuesit shqiptarë ishin ndër më të shumtët që paraqiteshin në ambasadën amerikane. Fjalët kurbet dhe Amerikë ishin dy sinonime në kujtesën historike të popullit shqiptar. Ndërsa gjatë dekadave të diktaturës fjalët e para që u thoshin hetuesit barbarë të arrestuarve për tentativë arratisjeje ishin :

— E, armik i popullit, nuk ia dole dot mbanë të shkoje në Amerikë, ë? Gjynah !

Pastaj, për të treguar *keqardhjen*, hetuesi e bënte të arrestuarin të humbiste ndjenjat prej torturave.

Ndërsa nën diktaturë mijëra shtetas humbën jetën në tentativë arratisjeje, apo u burgosën me afate tepër të gjata, më 1991 e më pas ambasada amerikane në Athinë i shëmbëllente portës së Amerikës disa qindra kilometra nga Kakavija. Si rrjedhojë, dyndja drejt saj qe e lartë.

*

Një ditë qershori të vitit 1991 një familje shkodrane priste në një sallë të ambasadës amerikane, për të marrë përgjigjen e kërkesës së depozituar për azil. Ishte një familje e njohur në nivel kombëtar për persekutimin e pësuar nga lufta e klasave në dekada. Bile mbiemri i asaj familjeje ishte bërë simboli i *kulakut* shqiptar. Në dekadat e diktaturës si të thoshe *Tuç Maku* edhe *Kryekulak* ishte e njëjta gjë. Për mynxyrën e atij fisi kishte kontribuar së tepërmi edhe dramaturgu i partisë, Kol Jakova, me dramën *Toka Jonë*, ku pronari i ligjshëm i tokës, Tuç Maku, paraqitej si armiku tipik i klasës në një shoqëri të hallakatur e të

predispozuar për të ngrënë vetveten.

Trashëgimtarë të Tuçit ishin pjesëtarët e familjes Maku, që prisnin atë ditë qershori të vitit 1991 përgjigjen e kërkesës për azil politik. Atyre u kujtohej koha kur shkonin në shkollë dikur dhe sa herë që lexoheshin në klasë fragmente nga drama *Toka Jonë*, detyroheshin të ulnin kokën nën shikimin përbuzës të të tjerëve dhe qanin. Kur u rritën edhe ca i prisnin internimet, burgjet e më keq akoma. Shumë prej tyre lanë kockat andej. Por ja, fati deshi më së fundi që edhe ata të shikonin një ditë të kthjellët… Dhe do ta shikonin në qiellin e madh të Amerikës. Ç'ëndërr e bukur !

Në të njëjtën ditë me familjen Maku, po priste përgjigjen e kërkesës së tij edhe një 34 vjeçar nga Tirana me mbiemrin Malindi. I llastuar nga natyra e nga fati. Një djalë shtatlartë e i pashëm, babai i të cilit kishte qenë komandant i përgjithshëm i kufirit në kohën e diktaturës rreth dy dekada. I biri kishte paraqitur kërkesë për ta kaluar në mënyrë të kulturuar kufirin, që kishte mbrojtur i ati me hekur e zjarr.

Sigurisht pritja ishte më e ankthshme për djaloshin e llastuar të familjes komuniste, sesa për familjen që kishte hequr të zitë e ullirit për dyzetë e shtatë vjet. Për të përballuar shpenzimet e rrugës, ajo kishte qenë e detyruar të shiste ç'kishte pasur të vlefshme prej plaçkave të shtëpisë. Por tani ishin të qetë të paktën, se do të shkelnin më së fundi në tokën e premtuar…

Dera e sallës së pritjes u hap. Një vajzë e bukur, me ecje aktoreje, u afrua e buzëqeshur. Ajo mbante dy zarfa në dorë. Me një theks shqipjeje, që e bënte edhe më joshëse, ajo iu drejtua djaloshit të parit :

— Kërkesa juaj është aprovuar. Së shpejti do t'ju komunikojmë me shkrim ditën e nisjes për në SHBA në adresën që keni paraqitur. Urime ! i tha duke i zgjatur zarfin.

Pastaj iu drejtua familjes Maku :

— Kërkesa juaj është refuzuar. Është e vërtetë që ju keni vuajtur shumë në diktaturë, por ata që e kanë shqyrtuar kërkesën tuaj mendojnë se ju nuk duhet ta braktisni atdheun, i cili ka shumë nevojë sot për ju. Në këtë zarf do të gjeni motivimin e detajuar të refuzimit të kërkesës suaj. Komunistët janë internacionalistë dhe e braktisin vendin pa kokëçarje, për të shijuar jetën perëndimore, – shtoi ajo duke i shkelur syrin djaloshit.

Dyllë i verdhë prej fatkeqësisë së papritur – ata shtëpinë e tyre e kishin lënë pa plaçka – kryefamiljari pyeti të shoqen me zë të dredhur :

— Po më thuaj, o grua, ku jemi, në ambasadën amerikane në Athinë, apo në komitetin e Partisë në Shkodër ?

— Nuk paska ndonjë ndryshim, - u përgjigj ajo, duke u shkrehur në vaj.

XIX

PLAKU I MIRË I HOTEL *MINON*

"*Ne kemi të gjithë forcë të mjaftueshme*
për të duruar dhimbjet e të tjerëve."
La Roshëfukó

Pas ndarjes me Melin, shokët më të preferuar të Diksit ishin dy vëllezër nga Kolonja, ish-të burgosur politikë. Të dy ishin të qetë e të sjellshëm. Diksi njihte nga afër më të madhin prej tyre, me të cilin kishin qenë bashkë më se katër vjet në kampin e Spaçit. Megjithëse vuante mjaft nga zemra, ai kishte punuar vazhdimisht në minierë, ku kishte humbur disa herë ndjenjat. Mirëpo komanda e kampit nuk e përjashtonte nga puna e nëntokës si *armik i parehabilitueshëm*.

Babai i tyre ishte arratisur nga Shqipëria më 1945. Qysh atëhere familja kishte qenë internuar në rrethin e Lushnjës. Si pasojë e një batice të luftës së klasave, më 1976 të dy vëllezërit u arrestuan e u dënuan njëherësh.

Pas rënies së *perdes së hekurt*, ata të dy, me gjithë familjet e tyre, e lanë Shqipërinë dhe u vendosën përkohësisht në Athinë. Babai plak erdhi kastile nga Amerika që t'i takonte fëmijët në kryeqytetin grek pas 46 vjetësh. Ndërkohë ai kishte depozituar garancinë përkatëse për fëmijët e tij pranë ambasadës amerikane në Athinë. Të dy djemve familjarisht u ishte miratuar kërkesa për azil politik dhe ata ishin në pritje të ditës së nisjes për në Amerikë.

Babai i tyre, i moshuar e i lodhur, qëndronte në hotel *Minon*, pranë sheshit *Omonia*. Të dy djemtë dhe familjet e tyre rrinin me orar të shkurtër pranë tij, për të mos ta lodhur. Gjatë intervaleve që qëndronin me babanë plak, të bijtë kishin mësuar se edhe jeta e atij në Amerikë nuk kishte qenë për tu admiruar, përkundrazi. Meqenëse ai ishte larguar nga Shqipëria me të ardhur komunistët në pushtet, fillimisht kishte qenë angazhuar në radhët e *luftëtarëve të lirisë* – anëtarë të emigracionit politik shqiptar të vënë në dispozicion të CIAs dhe Inteligjencë Servisit "për të përmbysur regjimin e urryer të Tiranës." Tre vjet më vonë, ai kishte qenë përjashtuar prej radhëve të *luftëtarëve të lirisë* për arsye shëndetësore. Qysh atëherë ishte tërhequr në jetën private.

— Duhet t'i jem mirënjohës sëmundjes së zemrës, që më shpëtoi nga ajo veprimtari e rrezikshme dhe aspak frutdhënëse – u kishte thënë ai të bijve. – Me kalimin e viteve, shumë prej ish-shokëve të mi të armëve e humbën jetën në luftë kundër *mullinjve të erës*. Edhe ata kishin fëmijë kështu si unë, por nuk i panë më me sy. Unë të paktën ju pashë, para se t'i mbyll sytë përfundimisht. Ky nuk është manifestim egoizmi nga ana ime, por përshkrimi i një realiteti të tmerrshëm në kuadër të një loje cinike me jetë njerëzore. Shpresoj të jetoj edhe pak, për t'ju shpjeguar më mirë fundin e trishtueshëm të ish-shokëve të mi të armëve. Dhe atëherë ju do ta kuptoni, se drama gjysmëshekullore shqiptare nuk është luajtur vetëm në Shqipëri…

*

Kur ish-bashkëvuajtësi i foli Diksit për brengat e babait të tij në hotel *Minon*, ai i tregoi letër-përgjigjen e profesor Banos lidhur me dorëshkrimin. Megjithëse teksti ishte konçiz, letra i tërhoqi vëmendjen shokut të Diksit me titullin e dorëshkrimit dhe këto fjalë të profesorit:*… e gjeta shumë interesant*.

Pas disa çastesh hezitimi, ish-bashkëvuajtësi iu shpreh Diksit për diçka të veçantë në sjelljen e babait të tij, që i kishte tërhequr vëmendjen:

— Babai ruan në gji një libër të mbështjellë me lëkurë speciale. Unë ia pashë rastësisht një ditë dhe iu luta të ma tregonte. Atij iu mbushën sytë me lot e më tha: «Jo, bir, është kërkesë e parakohshme kjo që po më bën. Të të flas sot për këtë libër më krijon shumë dhimbje, mbasi ai është varreza e kolegëve të mi të zhdukur.»

«Titulli i dorëshkrimit tënd më impresionon, Sazan – i tha ish-bashkëvuajtësi. – Konsiderata e profesor Banos për të, gjithashtu. A mos vallë ekziston ndonjë lidhje e tërthortë midis subjektit me ngjarje të jetuara të dorëshkrimit tënd dhe misterit të librit tabu që ruan babai në gji? Meqenëse ne njihemi mirë bashkë dhe jemi në prag të një ndarjeje ndofta të përhershme, po i lejoj vetes të të bëj një kërkesë pak të bezdisshme: ke mundësi të më thuash dy fjalë lidhur me përmbajtjen e dorëshkrimit tënd, Sazan?

Në realitet Diksi kishte shumë më besim tek ky ish-bashkëvuajtës i ndershëm, sesa tek dy profesorët shqiptaro-amerikanë, në duart e të cilëve kishte përfunduar tashmë dorëshkrimi. Prandaj ai nuk hezitoi t’i fliste shkurt atij për subjektin e dorëshkrimit.

Pasi i dëgjoi me vëmendje shpjegimet e Diksit, ish-bashkëvuajtësi i tha:

— Unë do t’i flas qysh sonte babait për dorëshkrimin tënd, Sazan. Ai nuk pret vizitorë, veç ne të familjes me orar. Por jam i sigurtë që përmbajtja e dorëshkrimit do ta intrigojë. Keqardhja për fatin e bashkatdhetarëve të flijuar prej CIAs dhe Inteligjencë Servisit, në kuadër të desantimeve të emigracionit politik shqiptar, është pika më e dobët shpirtërore e tij. Ndofta ngacmimi prej subjektit të dorëshkrimit tënd, do ta nxisë babanë të dalë nga ajo heshtje lënguese, që e torturon.

*

Të nesërmen ish-bashkëvuajtësi e njoftoi Diksin, se babai i tij dëshironte ta takonte në orën gjashtë të mbrëmjes.

Pesë minuta para orarit të caktuar, ata e lanë sheshin *Omonia*, për të hyrë në hotel *Minon*. Ishte një plak me shtat mesatar, pak i kërrusur, që u hapi derën e dhomës. Balli i tij lehtësisht i rrudhosur lartësohej për shkak të rënies së pjesës së përparme të flokëve të thinjur. Zbehtësia e fytyrës së hequr theksohej prej bardhësisë së dhëmbëve të mbjellë. Një buzëqeshje e ëmbël e hijeshoi ftesën e tij:

— Hyni, bijt e mi; po ju prisja.

Pas përshëndetjeve të rastit, ata u ulën rreth një tavoline ovale.

— Cila është pija juaj e preferuar? e pyeti plaku Diksin.

— Uzoja, – u përgjigj ky.

— Faleminderit për kërkesën ekonomike – i tha plaku buzagaz. – Një shishe *Uzo 12* është pija më e lirë që ndodhet në minibarin e dhomës sime.

Pastaj ai iu drejtua të birit:

— Shërbeji mikut me një gotë uzo, sillëm mua një whisky në akull dhe merr për vete ç'të të pëlqejë.

Të tre i takuan gotat me njëri-tjetrin.

XX

MISTERI I NJË LIBRI VRASTAR

"*Mos i besoni kollaj askujt dhe, veçanërisht, të plotfuqishmit*."
La Robersí

— **E** kam njohur babanë tuaj në Çikago më 1954, – e nisi bisedën plaku, duke iu drejtuar Diksit me një zë të shtruar e pamje të menduar. – Festonim ditën e Pavarësisë së Shqipërisë në dhé të huaj, ndërkohë që regjimi komunist i Tiranës kremtonte dhjetëvjetorin e ardhjes në pushtet. Kjo ishte një shenjë e keqe, sepse në vitin 1945 amerikanët na thoshnin se ditët e regjimit komunist në Shqipëri ishin të numëruara. Megjithatë ne ishim të rinj e entuziastë në atë kohë. Nuk na shkonte kurrë ndërmend, se komunizmi do të na shoqëronte deri në varr. Por nuk kemi të drejtë të ankohemi. Duke qenë të pazotë që ta luftonim siç duhej komunizmin në vatrën tonë, e lamë Shqipërinë u kërkonim të huajve të bënin detyrën tonë, të cilën e lamë përgjysmë. Mirëpo harruam këtë parim të madh të jetës: është më i forti që e vë në shërbim të tij më të dobëtin, jo e kundërta.

Plaku pushoi një çast së foluri, mori një hape prej një kutie mbi tavolinë dhe e piu të shoqëruar me pak ujë. Mandej vazhdoi të shikonte në heshtje një kornizë me fotografinë e të dy djemve, të cilën e kishte vendosur përbri krevatit. Një hije buzëqeshjeje e soforcuar u duk në fytyrën e tij të zbehtë, para se të riniste fjalën:

— Djali më tha se ju dispononi një dorëshkrim ngjarjesh të jetuara, që kanë të bëjnë me çështjen shqiptare. Do të dëshiroja të më thoshit diçka nga ana juaj.

Diksi e kishte vendosur të fliste pa rezerva me veteranin e atyre ngjarjeve. Në këtë mënyrë ai shpresonte ta nxiste më tepër plakun të dilte prej ngujimit në heshtje. Gjersa dorëshkrimi tashmë ndodhej në duar krejt të pasigurta, ç'kuptim kishte heshtja me njerëz të ndershëm e të rreshtuar me viktimat e asaj prapësie?

*

I mallëngjyer, plaku kishte vendosur duart mbi gjunjë dhe po e përpinte ligjëruesin me sy. Nganjëherë i mbyllte sytë, për «të parë» ngjarjet e dhimbshme që dëgjonte. Imagjinata e tij funksionone më mirë me sy të mbyllur. Duart e mbështetura mbi gjunjë filluan t'i dridheshin.

Kur ekspozeja e Diksit arriti tek kontakti i detektivit të burgosur me të dërguarit e Inteligjencë Servisit në kampin e Qaf-Barit, plaku u turbullua krejt. Ai filloi të rrihte gjoksin e tij me shuplaka dhe, duke gulçuar, thirri me sy të përlotur :

— Mjaft, ju lutem ! Mos i zgjuani fatkeqët që flenë këtu ! Rrëfimi juaj i plagosi dhe unë i ndiej që ata po lëvizin.

Me duar të dridhura plaku nxori nga gjoksi një libër format mesatar të mbështjellë me lëkurë kafe. E puthi dhe e vuri mbi tavolinë. Duke e ledhatuar

sikur ta kishte ndonjë fëmijë, nisi të fliste me zë të mbytur prej emocionit :

— Ky është kujtimi më i çmuar dhe më lëndues i jetës sime. I kam porositur djemtë, që këtë libër ta varrosin bashkë me mua ditën që do të vdes. Ky ishte amaneti i një miku të çmuar, në prag të lamtumirës nga jeta para tridhjetë e një vjetësh, dhe unë do ta respektoj dëshirën e tij me rigorozitet. Ai ishte njëri prej shqiptarëve të arratisur pjesëmarrës në *Operacionin e Maltës*, të organizuar nga CIA dhe Inteligjencë Servisi, gjoja për të përmbysur regjimin komunist të Hoxhës. Megjithëse ky qe misioni zbarkues më i rëndësishëm i organizuar prej anglo-amerikanëve, pas dështimesh të pajustifikueshme u anulua kinse për shkak sabotimi. Në mbyllje të *Operacionit të Maltës,* organizatorët e tij i dhanë secilit prej të mbijetuarve një kopje të librit *Të Tradhtuarit*, duke ua bërë të qartë se ai ishte *top sekret*. Prandaj duke marrë në dorëzim kopjen e librit, secili prej tyre firmoste një deklaratë për ruajtje konspiracioni deri në fund të jetës, përndryshe ata do ta paguanin pabesinë me kokë. Por nuk vonoi shumë dhe fatkeqët pjesëmarrës në *Operacionin e Maltës* e kuptuan se libri *Të Tradhtuarit* ishte vetëm një kurth. Njëri pas tjetrit, gjithë shqiptarët që e mbijetuan *Operacionin e Maltës* u zhdukën në heshtje. Miku që ma fali mua kopjen e tij të *librit vrastar*– siç kishin filluar ta quanin ata mes tyre librin *Të Tradhtuarit* – ishte i mbijetuari më i ri në moshë : vetëm 21 vjeç kur ia kishin dhënë librin. Edhe sot më plagos shpirtin jehona e fjalëve të tij ditën që më dhuroi librin :

«Jam i vetmi person i mbetur ende gjallë prej të mbijetuarve të operacionit të Maltës. Ndoshta ma kanë bërë këtë *privilegj* ngaqë isha më i riu prej të gjithëve. Tani është radha ime. Duhet të bashkohem edhe unë me të tjerët, që kështu të jetë i mbyllur përfundimisht kapitulli i trishtuar i *Operacionit të Maltës*. Ruaje si kujtim të hidhur këtë libër vrastar, në emër të të cilit u zhdukën të gjitha ata që ëndërronin të luftonin e të vriteshin për çlirimin e Shqipërisë nga komunizmi. Por bëj shumë kujdes, se po e morën vesh që ti e disponon këtë libër, të pret vdekja. Do të përpiqem të hyj fshehtas në Australi, por e di që kjo është thjeshtë një tentativë e dështuar. Po more vesh se në Australi organizohet nga ndokush një ceremoni mortore për mua, përpiqu të asistosh në të dhe kujtohu që unë e prisja vdekjen. Në qoftë se do të kesh fatin të kthehesh gjallë në Shqipëri, shqite faqen 119 të këtij libri, vendose në mes të një tufe lulesh dhe çoje mbi varrin e nënës sime. Lamtumirë, miku im!»

«Pas 17 muajsh i ndodhi fatkeqësia që e priste. Unë nuk e mora dot vesh në kohë vdekjen e tij. Më vonë shkova kastile tek varri, për t'i çuar një buqetë me lule. Libri që më kishte lënë më dukej sikur ishte shpirti i tij. Edhe sot sikur ta tregosh në publik këtë libër përbën rrezik të madh. Prandaj ai do të varroset bashkë me mua, me qëllim që edhe miku im të prehet i qetë, se libri që më la amanet nuk i bëri keq askujt. Libri *Të Tradhtuarit* dhe përmbajtja e dorëshkrimit tuaj të bëjnë të thërrasësh deri në kupë të qiellit: ku i ke rrënjët, o komunizëm?

I mallëngjyer në ekstrem, plaku me sy të përlotur e puthi Diksin në ballë. Këtij iu kujtuan fjalët që i kishte thënë Meli ditën që diskutonin së bashku rreth dorëshkrimit:

«Akti i parë i dramës shqiptare me regji të CIAs dhe të Inteligjencë Servisit lidhet me sabotimin e veprimtarisë së emigracionit politik shqiptar të pasluftës së Dytë Botërore, të cilit i përkiste edhe babai yt. Akti i dytë lidhet me sabotimin e veprimtarisë së grupit tonë. Lajmet që kanë ardhur prej andej lënë shumë për të dëshiruar, lidhur me trajtimin e rezervuar nga CIA për anëtarët e grupit tonë, që ndodhen atje.»

*

Ç’kishte ndodhur pas tërheqjes së detektivëve të dekoruar shqiptarë në SHBA ?

XXI

VIKTIMA E PARË E DORËSHKRIMIT TË TRADHTUAR

« *Trishtimi që na shkaktojnë gabimet tona e ka emrin pendesë.* »
Bosyé

Përkthyesi me origjinë korçare, i cili kishte shoqëruar disa herë të dërguarit e CIAs në takimet me detektivin e burgosur në kampin e Qafë–Barit, i festonte Krishtlindjet prej disa vjetësh radhazi në Zvicër. Një ditë shefi i CIAs për Evropën e kishte pyetur kureshtar :

— Çfarë të tërheq kaq shumë në atë vend të bukur, që e frekuenton rregullisht ?

— Pasioni për skinë alpine dhe bukuria natyrore, – ishte përgjigjur buzagaz përkthyesi.

Ai e kaloi në heshtje arsyen e tretë, më të rëndësishmen, që e bënte Zvicrën vendin e zemrës së tij.

Përkthyesi kishte qenë adoleshent, kur i ati e kishte ftuar për herë të parë t'i kalonin bashkë festat e fundvitit në Zvicër. Ai e kishte pritur me kënaqësi ftesën. Megjithëse adoleshent, ai kishte mësuar t'i përdorte mirë skitë dhe dëshironte t'ia kalonte të atit në shpejtësi.

Në Zvicër kishin zhvilluar shumë gara bashkë, por djaloshi vetëm dy kishte fituar. Atje babai i kishte folur me pasion për dobinë shëndetësore të skive :

— Skitë janë sporti më i shëndetshëm për njeriun. Të gjitha pjesët e trupit janë në lëvizje dhe të gjitha organet në veprimtari të plotë në mes të një ajri të pastër e të freskët. Kjo është gostia më e mirë që njeriu mund t'i bëjë falas organizmit.

Një ditë ai e kishte çuar të birin përballë një fshati të bukur alpin. Atje i kishte thënë:

— Unë dua të prehem pak; ti mund të vazhdosh të bësh ski vetëm.

Djaloshi kishte bërë edhe disa xhiro me ski, pastaj kishte shkuar e ishte ulur pranë të atit. I fundosur në një heshtje të thellë, ky po e endte shikimin mbi çatitë e pjerrëta të fshatit përballë. Për të mos ta shqetësuar, i biri nuk e theu heshtjen. Por, pas disa minutash, këtë e bëri vetë babai:

— Ti nuk e gjen dot me mend, bir, pse është burim emocionesh për mua soditja e këtij fshati. Nuk ke faj, se ishe fare i vogël, kur ne u arratisëm nga Shqipëria. Me përjashtim të komoditetit, pamja e këtij fshati është pothuajse identike me atë të fshatit tonë në Korçë. Kur e kam parë për herë të parë, më ka rrahur zemra, sikur donte të dilte nga kraharori. Padashur më shkuan lot. Përpiqesha të imagjinoja pozicionin e shtëpisë sonë… Shtëpia jonë! Sigurimi do ta ketë rrafshuar, për të nxjerrë inatin e arratisjes sonë. Megjithatë, sikur të më jepej rasti ta ledhatoja myshkun e themeleve të asaj shtëpie, do të ripërtërihesha. Në qoftë se nuk do të kem fat të kthehem i gjallë në vendin tim, dëshira ime do

të ishte ta dorëzoja shpirtin përballë këtij fshati. Kur të jem nisur për udhën pa kthim, sillëm këtu. Vdekja në dhé të huaj do të jetë më pak e siklmetshme për mua, duke m'u fikur shikimi me këtë pamje në sy.

Vdekja e babait qe e papritur. Djali ndodhej larg dhe nuk e respektoi dot amanetin. Por qysh atëherë ai vendosi t'i festonte Krishtlindjet në atë fshat të Zvicrës. Çdo 24 dhjetor, ai rrinte një orë tek vendi ku kishte qenë ulur për herë të parë me babanë, përballë fshatit të adhuruar, duke dëgjuar këngë e melodi korçare të regjistruara në magnetofonin e të atit. I dukej se ato i dëgjonte dhe babai. Atje linte gjithmonë një buqetë lulesh. Kujtimet e turbullonin, por festa bëhej më kuptimplote për përkthyesin, veçanërisht pasi kishte shkelur sërish tokën amtare.

*

Ai shkoi në Zvicër edhe për Krishtlindjet e vitit 1991. Kur u kthye në SHBA, përkthyesi kishte edhe katër ditë pushim akoma. Mirëpo të pasnesërmen shefi i seksionit evropian të CIAs e thirri në zyrë.

«Do të ketë lindur nevoja e ndonjë përkthimi», mendoi me vete, duke shtuar shpejtësinë e veturës.

Eprori që e kishte thirrur shoqërohej prej sekretares. Shef i seksionit evropian të CIAs i ra drejt problemit :

— Duke filluar nga 1 janari 1992, ju jeni i përjashtuar nga radhët e CIAs. Vendimi është marrë prej Drejtorisë Qendrore.

E buzëqeshur, sekretarja i zgjati zarfin e likujdimit financiar me Agjensinë.

Ai mori zarfin, falënderoi dhe doli prej territorit të supervëzhguar, për të mos hyrë më kurrë atje.

*

Përjashtimi i përkthyesit me origjinë korçare prej radhëve të CIAs e dëshpëroi Streton. Ai e vlerësonte veten shqiptar dhe kishte qenë një person shumë i dobishëm për Streton. Vizitat e tyre të përbashkëta pranë Melit në kampin e Qafë-Barit e kishin forcuar miqësinë midis tyre. Megjithëse edhe Streto e njihte mirë anglishten, ata të dy kishin folur gjithmonë shqip, kur ishin vetëm. Prandaj edhe bisedat midis tyre ishin zhvilluar më liberale, nga sa parashikonin normat e shërbimit sekret. Për shembull, Streto ishte i bindur se diskutimi i përkthyesit me origjinë korçare rreth *qindshes shqiptare*, kishte qenë një dekonspirim sekreti në mirëbesim midis shqiptarësh. Të tre bashkëbiseduesit ishin profesionistë me përvojë dhe e dinin se këto biseda konfidenciale do të mbeteshin sekrete midis tyre përgjithmonë.

Përgjithmonë…, në qoftë se nuk do të ekzistonte tradhtia, por ajo është njerëzore dhe njeriu tradhtohet përherë nga të tijtë. Dorëshkrimi i Diksit tashmë ndodhej në duart e ekspertëve të CIAs dhe atje ata kishin ç'të qëmtonin.

XXII

ANKTH

“*Më ngjitëse se murtaja, frika*
komunikohet me një të shkelur syri.”
N. Gogol

Pasi hëngri me një oreks zogu, ai u çua nga trapeza. E shoqja u vrenjt në fytyrë dhe i bëri vërejtjen e zakonshme të ditëve të fundit :

— Ç’është kjo punë kështu me ty, more burrë ? Pse nuk ha, por bën sikur ha? Një mjek i mirë kujdeset për shëndetin e tij në radhë të parë, pastaj për atë të klientëve.

— Ndryshoje një herë avazin, – ia ktheu ai, me një buzëqeshje të sforcuar.

— Kjo mungesë oreksi e papritur nuk është shenjë e mirë për shëndetin tënd, – insistoi ajo. – Ti këshillon pacientët të kujdesen për shëndetin e tyre, ndërkohë që neglixhon tëndin.

— Kush jep këshilla shpesh, harron që t’i zbatojë vetë; ky është një fakt i njohur. Pastaj unë festoj 64 vjetorin e ditëlindjes së afërmi. Helbete, pakësimi i oresksit është edhe pasojë e moshës. Kjo është e natyrshme.

— Nuk është e thënë që duhet të jesh doemos mjek, për të kuptuar se një rënie e menjëhershme e oreksit nuk është dukuri natyrore e moshës.

— Më ka marrë malli për fëmijët, – tentoi të justifikohej ai.

— Atëherë do t’iu telefonoj të vijnë menjëherë. As ata nuk janë dakord që ti të kalosh krizë shëndetësore, për shkak të mungesës së tyre të gjatë.

— Leri të qetë, gjersa i ndihmoi fati. Një dozë durimi është domosdoshmëri në jetë. Sot fola në telefon me vajzën. Ajo më tha se edhe i vëllai është shumë mirë ; komunikojnë rregullisht me njëri-tjetrin. Kjo më ka qetësuar.

— Tregues i qetësimit tënd është stabilizimi i oreksit.

— Të premtoj se qysh prej ditëlindjes së afërt, do të filloj të ushqehem përsëri si më parë – i dha fjalën ai duke e përqafuar.

*

Gruaja buzëqeshi kur iu kujtua ky dialog, tek po përgatiste darkën e kremtimit të ditëlindjes së bashkëshortit. Duke pasur parasysh faktin që ditët e punës së mjekut ishin të ngarkuara, ata kishin vendosur ta organizonin në mbrëmje ceremoninë e ngushtë familjare.

«Fëmijët do t’i telefonojnë përsëri sot, me rastin e ditëlindjes, dhe ai do të qetësohet edhe më mirë», mendoi gruaja duke gatuar.

Kishin dy fëmijë: vajzë e djalë. Të dy në emigracion. Vajza kishte ikur me të shoqin në Amerikë, ndërsa djali vazhdonte studimet për mjekësi në Itali. Kur ky ishte regjistruar në universitetin *La Sapienza* të Romës, i ati i kishte thënë me krenari në prani të mamasë:

— Ti do të përfaqësosh brezin e tretë të mjekëve të dalë nga gjiri i familjes sonë.

Prindërit jetonin në një shtëpi private të trashëguar. Në saje të biografisë së mirë politike, ata kishin kaluar një jetë të qetë e cilësore nën diktaturë, krahasuar me të tjerët. Për më tepër, regjimi diktatorial i kishte krijuar mundësinë kardiologut pasionant që të specializohej jashtë shtetit. Më vonë, atë e kishin punësuar në DSJ, si një specialist të përgatitur dhe me biografi të shëndetshme për kohën. Si rrjedhojë, ata familjarisht nuk kishin njohur fare shqetësime në diktaturë, përkundrazi. Ishte kjo arsyeja që gruaja u shqetësua aq shumë nga mungesa e oreksit të bashkëshortit.

Në të vërtet burimi i stresit të theksuar, që po përjetonte mjeku, ishte krejt i panjohur për gruan e tij. Kishte mjaftuar vetëm një pyetje e thjeshtë e një pacienti të rëndësishëm, për t'i vrarë qetësinë kardiologut:

— Doktor, ke pasur rastin ta njohësh Hamit Melin, detektivin më të shquar të DSJsë?

I befasur nga kjo pyetje, kardiologu ishte zverdhur, para se të përgjigjej me zë të dobët:

— Kur unë kam filluar punë në DSJ, Hamit Meli ishte larguar prej andej. Megjithatë kam pasur rastin ta mjekoja një herë në kampin e Qafë-Barit, kur ishte i burgosur.

Me një buzëqeshje skërmitëse, tjetri i kishte shkelur syrin duke i thënë:

— Më duket se e ke vizituar dy herë në Qafë-Bar, jo një herë.

Dhe kishte dalë nga dera pa e përshëndetur.

Mjeku me përvojë, i llastuar nga fati, nuk e kishte imagjinuar dot kurrë më parë, se një pyetje e thjeshtë mund të çekuilibronte një jetë.

XXIII

VRASJE

« *Është më mirë të shpëtosh një fajtor,*
sesa të vrasësh një të pafajshëm. »
Volter

Ajo i kishte blerë si dhuratë një krevatë të bukur burrit, e cila i pëlqeu mjaft doktorit. Sapo i takuan gotat për fillimin e ceremonisë së ditëlindjes, tingëlloi telefoni. Djali i uronte përvjetorin babait, duke i kërkuar ndjesë që nuk kishte mundur të vinte, për të festuar së bashku.

Vera ishte e cilësisë së mirë. U pëlqeu të dyve. Mjeku i mbushi përsëri gotat dhe iu drejtua së shoqes:

— Ta ngremë një dolli për shëndetin tënd, e dashur !

— Uroj që të jetosh njëqind vjet! – ia ktheu ajo shend e verë.

Megjithë mungesën e fëmijëve, ata po e shijonin mirë festën. Ndryshe nga ditët e kaluara, mjeku po hante e po pinte normalisht. Të paktën atë natë të shënuar, ai donte ta harronte shqetësimin që po i nxinte ditët. Duke e parë burrin të kënaqur, bashkëshortja fluturonte nga gëzimi. I shoqi i mbante gjithmonë premtimet dhe ky ishte një virtyt që ajo e çmonte së tepërmi. E bërë paksa çakërrqejf prej efektit të verës së zgjedhur, ajo i kujtoi me pasion burrit muajin e mjaltit, lindjet e fëmijëve, studimet e tyre…

Ishte ora tetë e gjysmë e mbrëmjes, kur telefoni tingëlloi përsëri.

— Vë bast që do të të dalë vajza në telefon, – hamendësoi gruaja.

Mjeku ngriti receptorin. Pasi dëgjoi atë që po i fliste nga ana tjetër, ai i tha me përtesë:

— Mirë, po vij.

Gruaja u trishtua, mbasi e mori vesh që mjeku do të dilte.

— Më presin, se paska ardhur një urgjencë në spital, – e sqaroi ai pa qejf.

— Ç’do të thotë kjo? Nuk gjejnë dot një mjek tjetër ata sonte ?

— Kur vdekja luftohet me sukses, i sëmuri ka mundësi ta festojë edhe ditëlindjen e ardhshme, e dashur, – i tha ai duke qeshur, për ta qetësuar. – Jeta e një pacienti është në rrezik, prandaj më duhet të shkoj në spital. Premtimin e mbajta : sonte kam ngrënë e kam pirë mjaft. Shpresoj se ke mbetur e kënaqur. Faleminderit për gatimet e shijshme, që kishe përgatitur.

— Unë doja të kënaqeshim akoma, se po e kalonim shumë mirë. Por të paktën vur kravatën e re, për të shkuar në spital.

— Me kënaqësi; ajo është simbol i përvjetorit sonte.

— Me biçikletë do shkosh?

— Jo, do nisem në këmbë. Pas pak, do dërgojnë ambulancën që është duke u kthyer nga një shërbim, siç më thanë. Por meqenëse pacienti është rëndë, dua të fitoj sadopak kohë.

Mjeku u përqafua me të shoqen, e cila i uroi edhe një herë tjetër ditëlindjen.

Pastaj doli.

Qejfmbetur prej të papriturës së pakëndshme, gruaja nuk u ul vetëm në tryezë. Ajo mori një album fotografish dhe zuri vend në kolltuk. Ishte albumi i festave familjare, të cilin ajo e kishte pagëzuar *koleksioni i gëzimeve tona*. Midis tyre, fotografitë e dasmës së vajzës i sillnin një hare të veçantë. Ajo kishte qenë fëmija e parë dhe prindërit e rinj e kishin dashur shumë. Madjé kishin menduar të mos lindnin fëmijë tjetër. Djali ishte zënë si pasojë e një pakujdesie të mjekut. Por ata as nuk e kishin shkuar ndërmend ta ndërprisnin shtatzëninë. Më pas i kishin dashur njësoj të dy fëmijët. Vetëm babagjyshi donte pak më shumë nipin se mbesën.

Vajza ishte martuar në vitin 1976, një vit që kishte njohur një baticë të luftës së klasave. Familja e dhëndërrit kishte pozita të forta në pushtetin diktatorial. Kjo e forcoi edhe më tepër biografinë politike të mjekut, i cili pas një viti filloi punë kardiolog në DSJ – një privilegj i madh për kohën. Ky ishte kujtimi më i mirë, që ruanin prej martesës së vajzës.

Duke puthur fotografinë e së bijës me fustanin e bardhë të martesës, gruaja pëshpëriti e gëzuar:

«Sa mbarësi që na solli martesa jote, o engjëll i mamit !»

Ajo po e puthte për herë të dytë fotografinë, kur zilja e telefonit ia ndërpreu monologun e lumturisë. Një ide joshëse i ngrohu zemrën, para se të ngrinte receptorin :

«Si duket kanë gjetur ndonjë mjek tjetër për urgjencën ; ne do ulemi përsëri në trapezë.»

Zëri i shoferit të ambulancës, të cilin ajo e njihte mirë se kishte qenë shumë herë aty për të marrë mjekun, ia ushqeu fillimisht shpresën që i kishte lindur :

— Mirëmbrëma. Po vij tek ju. Pastaj do të kthehemi së bashku në spital, tek yt shoq.

— Po ti eja më mirë bashkë me tim shoq këtu ; pse duhet ta bëjmë dy herë rrugën.

— Ju do të rrini fare pak në spital; pastaj do të ktheheni në shtëpi bashkë me burrin.

Ai e uli receptorin, ndërkohë që gruaja e mjekut nuk u sqarua siç dëshironte. Pak e hutuar, ajo e priti shoferin e ambulancës tek pragu i portës.

— Ejani, zonjë, që të shkojmë e të kthehemi shpejt, – i tha ai sapo mbërriti.

— Unë do të ndërrohem; ndërkohë ju merrni diçka me rastin e ditëlindjes së burrit.

— Faleminderit, po marr një bonbonë, – ia ktheu ai duke hyrë brenda.

E zonja e shtëpisë kaloi në dhomën tjetër dhe nuk ia vuri veshin urimit me gjysmë zëri.

Sapo zbriti në oborrin e spitalit, gruan e doktorit e shoqëruan dy infermiere deri në sallën e pritjes. Atje nuk erdhi ta takonte i shoqi, por drejtori i spitalit, i cili u shpreh me zë të ulët:

— Më vjen shumë keq, zonjë, por bashkëshortit tuaj të dashur dhe

kardiologut tonë të dalluar i ka ndodhur një aksident gjatë rrugës, duke ardhur në spital. Ndodhet në reanimacion.

Ajo shpërtheu në të qara me dënesë dhe mezi arriti të pyeste me një fije zëri:

— Po si është e mundur?

Dy infermieret përpiqeshin ta qetësonin, ndërkohë që drejtori po i sqaronte rrethanat e dramës :

— Kur ne ju telefonuam, nuk kishim ambulancë këtu. Të parën që erdhi e nisëm menjëherë për tek shtëpia juaj. Për fat të keq, ajo e kishte gjetur mjekun të aksidentuar rëndë në anë të rrugës. Për më tepër, kamioni që e ka aksidentuar, nuk ka ndaluar fare tek vendi i ngjarjes, por është larguar në drejtim të panjohur. Policia është vënë në ndjekje të tij.

— Dua ta shikoj burrin, – rënkoi ajo midis dënesave.

— Mblidhni veten njëherë, pastaj do të shkojmë bashkë tek salla e reanimacionit, – i sugjeroi drejtori.

Mandej ai shkoi të takonte përgjegjësin e sallës së reanimacionit.

— Ajo do që të shikojë burrin, si do t'ia bëjmë ? u këshillua drejtori me përgjegjësin.

— E ç'ka për të parë aty ? Ai ka mbaruar me kohë. Duhet çuar kadavra në morg.

— Porosit infermieret ta rregullojnë pak tek krevati ku ndodhet, që të kuptohet nga veshja cili është. Unë do ta lejoj gruan ta shikojë nga larg, që nga xhamat. Të mos hyjë fare në sallën e reanimacionit.

— Kjo është zgjidhja më e mirë, – e aprovoi përgjegjësi.

Drejtori shkoi përsëri tek salla e pritjes.

— Ejani, zonjë, se do t'ju shoqëroj vetë deri tek salla e reanimacionit, – i tha ai gruas së hidhëruar. – Por rregullorja e spitalit na ndalon kategorikisht për të hyrë brenda. Prandaj do ta shikojmë burrin përmes xhamave.

Ai e mori për krahu gruan, që mezi qëndronte në këmbë. Sapo ajo pa kravatën e re të zhubravitur, i ra të fikët.

XXIV

NOSTALGJI…

« *Njeriu është një hyjni i lidhur me zinxhira nga pushteti i rrethanave*.»
M. Preda

Në fillim të marsit 1992 shefi i tij në hierarkinë e CIAs i bëri të ditur Stretos:

— Pas dy javësh do niseni me shërbim në Shqipëri, i shoqëruar nga një koleg amerikan. Atje do të qëndroni pesë ditë.

Ky qe një lajm i mirë për Streton. Ai kishte qenë në Shqipëri qyshkur qeveria e Tiranës kishte legalizuar pluralizmin politik. Ishte kurioz të konstatonte emancipimin politik të bashkatdhetarëve, pas pakësimit të dozës së frikës. Meqenëse kishte vepruar pranë kulmit të pushtetit diktatorial, Streto i njihte mirë bubullimat jupiteriane dhe efektin e tyre mbi turmat.

Qysh atë natë që Hoxha kishte hequr maskën e marksistit në sy të tij e të Fatmir Merdarit, në prag të nisjes së *Dofenit* për në takimin e Londrës, Streto ndiente një neveri të thellë ndaj klanit të paskrupull diktatorial. Megjithëse e dinte mirë që demokratizimi i Shqipërisë ishte një ëndërr me sy hapur, Stretos i vinte mirë që klani Hoxha ishte mënjanuar të paktën nga skena politike.

I zhgënjyer prej rezultateve të veprimtarisë së grupit komplotist, Streto ndiente mall për vendlindjen dhe dëshironte shumë të ndodhej në mes të popullit të tij fatkeq. Atje ai vepronte i maskuar dhe kishte mundësi t'i vëzhgonte me ngé bashkatdhetarët, të njohur e të panjohur, pa u ndruajtur se mos e pikaste ndonjëri prej tyre. Në këtë mënyrë ai evitonte si miqtë dhe armiqtë. Por kujtimet njeriu nuk i eviton dot. Ata janë përherë të pranishëm në shpirtin e gjithsecilit dhe ngrenë krye në çdo çast të volitshëm për ta. Tani ai ishte i detyruar të shkonte i maskuar në Tiranë, ku para disa vjetësh bënte tërthorazi ligjin.

Për herë të fundit në Shqipëri Streto kishte qenë në janar 1991. I maskuar, sigurisht. Një ditë ai ndodhej në barin e hotel *Dajtit*, të frekuentuar kryesisht prej të huajve. Pas dhjetë minutash atje kishin hyrë *Dofeni*, e shoqja dhe e kunata – motra e gruas. Kjo e fundit kishte qenë përkohësisht bashkëshorte e Stretos, duke krijuar urën miqësore të drejtpërdrejtë me baxhanakun – *Dofenin*.

Ata të tre kishin zënë vend në një tavolinë disa metra larg asaj të Stretos. Klientët ishin të pakët dhe në bar zotëronte një heshtje e plotë. Kurioz, Streto po i shikonte me bisht të syrit ata të tre, të cilët para disa vjetësh përbënin rrethin e tij të ngushtë. *Dofeni* kishte shtuar peshë dhe rënia e flokëve ia kishte zgjeruar ballin. E shoqja pothuajse nuk kishte ndryshuar. Në kundërshtim me të motrën, ish-nusja e Stretos ishte dobësuar mjaft; çehreja e saj reflektonte trishtim e lodhje.

Streto ndjeu instiktivisht keqardhje për rënien e dukshme fizike të ish-bashkëshortes, e cila kishte qenë viktimë e koniukturave politike të diktaturës në krizë të thellë. Bëhej fjalë për një martesë spontane, të kalkuluar

politikisht, ku ndjenjat e partnerëve i përkisnin planit të dytë. Megjithatë Streto e kishte kuptuar shpejt, se nusja e dashuronte marrëzisht. Një ditë ajo ia kishte pohuar me gojë të saj:

«Duke qenë pesimiste nga natyra, unë nuk e kisha shpresuar kurrë një martesë kaq të lumtur në jetë, Guri.»

Natyrisht, Streto nuk e dashuronte me të njëjtin pasion, por nuk kishte arsye që t'i qëndronte ftohtë. Mbi të gjitha, në atë periudhë të nxehtë atij i duhej të drejtonte në prapaskenë një grup komplotues antidiktatorial të rëndësishëm, gjithë duke qenë në lartësinë e detyrës zyrtare – si krahu i djathtë i baxhanakut, që drejtonte shërbimin sekret shqiptar dhe kontrollonte pushtetin e brendshëm, ndërkohë që i ati mbetej figurant prej sëmundjes.

Streto nuk ndiente urrejtje ndaj ish-nuses as në ato çaste që ajo ishte ulur pranë *Dofenit* – armikut të tij kryesor. Dy herë shikimet e tyre ishin kryqëzuar rastësisht. E nga ta dinte ajo e shkreta, se kujtimi i atyre syve (momentalisht të panjohur) i vriste gjumin?

Të dy motrat po pinin lëng qershie. *Dofeni*, krahas filxhanit të kafesë, kishte edhe një dopjokonjak. Streto hamendësoi se biseda e tyre duhej të ishte e rëndësishme, sepse *Dofeni* përkulej herë pas here nga ana e kunatës dhe i fliste duke tundur shuplakën e dorës së djathtë. Kjo shenjë ishte tregues i preokupimit të tij maksimal për temën që diskutohej.

Efekti i konjakut dhe angazhimi serioz në diskutim bënë që *Dofeni* ta ngrinte pak zërin. Për një çast Streto pati përshtypjen se dëgjoi të përmendej emrin e tij. Kureshtar, ai vuri në funksionim aparatin e vogël të regjistrimit të zërave në distancë, që e kishte në xhep.

Pas një çerek ore ata të tre u çuan dhe dolën nga bari. Ndërsa Streto u ngjit në dhomën e tij në hotel, për të dëgjuar bisedën e regjistruar.

*

Dialogu fillonte në mes të një fraze të *Dofenit* :

— … kjo s'është, veçse një marrëzi. Paske vendosur të mbash zi për dashurinë e humbur të Gurit ? Prandaj nuk pranon të martohesh më ? Humbja e një dashurie nuk duhet të bëhet kurrë fatale.

— Të lutem, Ilir, mos më fol me këtë gjuhë për dashurinë time ndaj Gurit, sepse je ti personalisht, që e ke mbjellë atë dashuri në zemrën time. Apo i ke harruar ato që më thoshe për të ? «Guri është sa i pashëm edhe inteligjent, sa guximtar edhe i aftë, sa i kompletuar edhe i komunikueshëm.» Ky ka qenë opinioni yt për baxhanakun e ardhshëm.

— Nuk e mohoj; ai i ka të gjitha këto cilësi. Por unë nuk kisha arritur t'ia zbuloja defektin e tij kryesor: pabesinë. Guri ishte një profesionist me përvojë në fushën e shërbimeve sekrete dhe dinte t'i kamuflonte mirë ndjenjat dhe prapamendimet e tij. Ai tradhtoi shtetin shqiptar dhe ty si nuse e re. Dhe mos harro këtë fakt të rëndësishëm : me tradhtinë e tij Guri i ka shkaktuar një dëm

shumë më të madh shtetit, sesa ty si bashkëshorte.

— As ti mos harro, se unë humbjen e Gurit e peshoj me zemrën time e jo me kandar të qeverisë. Ai ishte njeriu që unë kam dashuruar me të vërtet dhe muajt e jetesës sonë bashkëshortore do të mbeten përgjithmonë kujtimet më të ëmbla për mua. Unë ëndërroj çdo natë për të; buzëqeshja e hijshme e Gurit dhe zëri i tij më magjepsin. Ti nuk e imagjinon dot trishtimin që përjetoj unë, kur zgjuhem nga ëndrra dhe e shikoj që jam vetëm në krevat. E njëjta zbrazëti më krijohet edhe në zemër. Kujtimi i Gurit m'i lëndon ndjenjat, por ai më mban gjallë. Ti i bën llogaritë sipas logjikës së ftohtë të shtetit, Ilir, por ajo është e huaj për mua. Unë e kuptoj që ti sipas së njëjtës logjikë ke vepruar edhe kur më propozove martesën me Gurin. Dashuria e gjeti shtegun për të hyrë në zemrën time, por atje është verbuar dhe nuk del dot më.

— A mos je verbuar gjë edhe ti vetë dhe nuk e shikon humbjen e së ardhmes tënde ? T'i qëndrosh besnike dashurisë së një tradhtari është një veprim që sfidon logjikën.

— E vërtetë. Por një dashuri që nuk sfidon logjikën, s'është e sinqertë.

— Po të them për herë të fundit: mendohu mirë. Sot e tutje unë nuk do ta përmend më këtë çështje.

— Ky është nderi më i madh që mund të më bësh.

— Kokëfortësia nuk ka asgjë të përbashkët me vendosmërinë.

— As logjika me dashurinë e vërtetë.

XXV

DIMËR…

“*Arsyeja e më të fortit imponohet*. »
Zh. Dë La Fonten

Një ditë të bukur marsi të vitit 1992, në prag të nisjes së tij për në Shqipëri, Streto po dëgjonte edhe një herë dialogun e ish-nuses së tij me *Dofenin*. Ndodhej në një lulishte të kuartierit të përgjithshëm të CIAs, Langley, në Washington. Megjithë përvojën e tij të madhe për të mos u bërë pré e ndjenjave, Streto po ndiente një shtrëngim në zemër duke dëgjuar zërin dridhërues të asaj me të cilën kishte vënë kurorë dhe që vazhdonte ta deklaronte pa mëdyshje dashurinë e fuqishme ndaj tij. Sikur të mos kishte qenë vetë autori i atij incizimi në rrethana të jashtëzakonshme, Streto nuk do ta kishte besuar, se ai s’ishte i parapërgatitur qëllimisht për të.

Kushtet në të cilat ishte realizuar ajo martesë me recetë do ta përligjnin plotësisht edhe një dashuri fasadë të nuses së re ndaj bashkëshortit të rekomanduar nga kupola e pushtetit diktatorial. Por realiteti konfirmonte të kundërtën. Megjithëse ish-bashkëshortja e kishte humbur përfundimisht Streton, ajo jetonte në saje të kujtimeve të tij.

Kur dialogu i incizuar mbaroi, Streto vendosi në vetvete :

«Kur të shkoj në Tiranë, do të bëj ç’është e mundur ta shikoj patjetër nga afër.»

Nën efektin e shprehjes së ndjenjave të ngrohta ndaj tij prej nuses së dikurshme, Streto buzëqeshi. U çua në këmbë dhe filloi të bënte shëtije të shkurtra me duar pas shpine. Pas pak i tingëlloi celulari. Shefi i seksionit ballkanik të CIAs e thërriste në zyrë.

«Si duket, do të më japë instruksionet e fundit, para se të nisem për në Shqipëri», mendoi Streto.

Shefi ishte vetëm në zyrë. Me të hyrë Streto, ai i tha buzagaz :

— Misioni juaj në Tiranë është anulluar; do t’ju zëvendësojë një koleg tjetër. Së shpejti, ju do të niseni gjetkë.

Megjithëse u befasua, Streto e priti i qetë në pamje e i buzëqeshur komunikimin e vendimit prej shefit. Në brendësi ajo i kujtoi pushimin e befasishëm nga puna të mikut të tij – përkthyesit me origjinë korçare. Ai e falënderoi eprorin dhe doli.

«Të shikojmë ç’do bëhet më tej», tha me vete.

*

Streton e zëvendësoi në atë mision njëri prej dy detektivëve shqiptarë, që u arratisën nga Shqipëria bashkë me robin amerikan më 1984. Kjo e lehtësoi disi shpirtërisht.

«Gjithsesi një bashkëluftëtar i grupit tonë do të shkojë në Shqipëri, të paktën», ngushëlloi veten Streto.

Grupi i tyre … A ekzistonte më në realitet ai?

CIA e kishte shpërbërë atë, duke i aktivizuar në fronte të ndryshme të shërbimit sekret pjesëtarët e *Komplotit të Tiranës*, siç figuronte në dokumentacionin e saj. Duke punuar e jetuar përgjithësisht të ndarë prej njëri-tjetrit, ata nuk përbënin më një grup. Dhe ç'ishte më e dhimbshme, ata nuk kishin më të drejtë as ta përmendnin ekzistencën e dikurshme të grupit.

Në maj të vitit 1984 CIA i kishte dekoruar pjesëtarët e grupit të Stretos, për një veprimtari që aktualisht binte ndesh me projektet amerikane për të ardhmen e Shqipërisë dhe të shqiptarëve. E kaluara e tyre e afërt ishte e papajtueshme me të sotmen. Prandaj ata duhej ta harronin atë të kaluar, për të mos i krijuar probleme vetes…

Qysh gjatë muajit të parë të qëndrimit të tyre në Amerikë, të dekoruarit e ish-grupit e kishin kuptuar, se kontaktet e tyre me *Kobrën* nuk i pëlqenin CIAs. Ndërsa në fillim të viteve nëntëdhjetë Streto dhe të tjerët po suportonin një ftohtësi të pashpjegueshme të CIAs. Dorëshkrimi i tradhtuar, i cili në realitet nuk duhej të publikohej pa kaluar të 15 vjetët, ishte shkaku kryesor i kësaj ftohtësie të përzier me dyshim. Edhe dy ish-robërit amerikanë të DSJsë, të cilët u detyroheshin me jetën shokëve të Stretos, tani u flisnin me maja të buzëve kur takoheshin në ambientet e CIAs.

Diksi u dëshpërua kur mësoi pasojat e dekonspirimit të përmbajtjes së dorëshkrimit të tij.

«Ju kërkoj ndjesë për telashet serioze që ju krijoi tradhtia e dorëshkrimit, por edhe kjo është pjesë e luftës sonë», qe mesazhi që u adresoi autori i dorëshkrimit miqve të tij.

XXVI

NËN SHIKIMET E ZYMTA TË CIAs

“*Urrejtja është më dinamike se miqësia, por më pak se lavdia*. »

Vovënarg

Megjithëse anëtarët e grupit të Stretos nuk gëzonin më dashamirësinë e eprorëve të shërbimeve sekrete amerikane, ata nuk ndodheshin në gjendjen e dëshpëruar të *Kobrës*. Ky ishte vërtet një *persona non grata* për CIAn. Në fillim *Kobra* kishte qenë i dobishëm në duart e CIAs, për të luftuar *kobrat* e tjerë. Por pas takimit tripalësh të Londrës (15 – 21 mars 1984), kur Inteligjencë Servisi dhe CIA e gjetën fjalën mes tyre, *Kobra* ishte i padëshirueshëm për amerikanët, u digjte sytë, mbasi ai kishte dëgjuar shumë prapësira në ato bisedime ultrasekrete lidhur me të ardhmen e Shqipërisë. Një dëshmitar i padëshirueshëm…

Dy shqiptarët e vetëm që morën pjesë në ato bisedime ishin Ilir E. Hoxha dhe *Kobra*. Të dy punonin për të huajt, në dëm të interesave të popullit e të vendit të tyre ! I pari firmoste në emër të babait çfarë i diktonin anglezët, ndërsa i dyti bënte gjithçka të mundur, nëpërmjet informacioneve që zotëronte, për ta detyruar Inteligjencë Servisin që t’i lëshonte sa më shumë terren CIAs. Kështu ai mendonte të siguronte një azil politik të përhershëm në Amerikë, ndërkohë që diktatori e kishte dënuar me vdekje në mungesë, megjithëse i kishte shërbyer si kryepolic i vendit për më se një çerek shekulli. Mirëpo ai dinte shumë dhe mësoi akoma më shumë gjatë bisedimeve supersekrete të Londrës.

*

Që *Kobra* ishte një dëshmitar i padëshirueshëm për diplomacinë e fshehtë të Washingtonit dhe mund t’i krijonte probleme të paparashikuara asaj, këtë e tregon qartë lordi anglez, Nicholas Bethell, në librin e tij *Mision i tradhtuar* – Si e *sabotoi Kim Filbi pushtimin e Shqipërisë*. Ndonëse qëllimi i autorit në këtë libër është përforcimi i tezës dalëboje të «tradhtisë» së Kim Filbit, ai detyrohet të sakrifikojë një pjesë të së vërtetës, për tu bërë disi i besueshëm.

Në faqen 15 të librit të tij, Bethell shkruan:

«SHBA këmbëngulin në mbështetjen e një “versioni përgënjeshtrimi të qëndrueshëm” lidhur me çështjen shqiptare, megjithëse sot ky përgënjeshtrim nuk duket më i qëndrueshëm. Qeveria e Washingtonit i ka urdhëruar, me kërcënim ndëshkimesh ligjore, të gjithë personat e angazhuar në ato ngjarje [në Shqipëri – A.H.] që të mos shprehen për pjesëmarrjen e tyre në operacion dhe po ashtu të mohojnë faktin se një operacion i tillë ka ndodhur.» [*La misione tradita – Come Kim Philby sabotó l’invasione dell’Albania*. LE SCIE, Arnoldo Mondadori Editore, Milano, 1986.]

Kobra u arratis nga Shqipëria në fund të gushtit 1982. Pas mbërritjes së tij në

Washington, ai paraqiti prova të pakundërshtueshme, se edhe dy grupe diversioniste që penetruan në Shqipëri pas arratisjes së Filbit në Moskë më 1963, ishin spiunuar tek Sigurimi, si ata të mëparshmit. Kush i kishte bërë këto dekonspirime të periudhës pasfilbiane?

Kjo pyetje–akuzë mbolli konfuzion në relacionet midis drejtuesve të CIAs dhe organit vëzhgues të saj – FOA (Freedom Of Information Akt – Ligji mbi Lirinë e Informacionit). Paragrafi i fundit i faqes 15 të librit të sipërcituar të lordit Bethell jep një tablo të qartë të konfuzionit, që u krijua pas përplasjes në këtë rast midis drejtuesve të CIAs dhe përfaqësuesve të FOAs:

«Në shtator 1982, Louis J. Dube, funksionar i ngarkuar me revizionimin e informacioneve për Drejtorinë Operacionale të CIAs, deklaroi nën betim: *Kërkesa e aplikimit të Freedom Of Information Act bërë nga i interesuari mbi tentativat e pretenduara opercionale të Agjensisë* [CIAs, A.H.] *në Shqipëri nuk mund as të pranohet, as të refuzohet, sepse një përgjigje pozitive ose negative ka gjasa t'i sjellë cenime të rënda sigurisë kombëtare.*»

Nicholas Bethell e mbyll introduksionin e librit të tij me një pyetje mjaft domethënëse:

«Atëherë, pse kaq këmbëngulje? Pse, edhe pas kaq vjetësh nga ato ngjarje, mungon vullneti që publiku të dijë çfarë kanë bërë ata dhe çfarë mësimesh kanë nxjerrë nga gabimet e tyre?» [*La misione tradita – Come Kim Philby sabotó l'invasione dell'Albania*, faqe 16. LE SCIE, Arnoldo Mondadori Editore, Milano, 1986.]

Pra, *Kobra* ndodhej në një vend të gabuar e në një moment të gabuar…

XXVII

VETMI RRËQETHËSE

“*Shpirtligësia e pi vetë pjesën më të madhe të helmit të saj*.”
Zh.–Zh. Rusó

CIA filloi ta izolonte *Kobrën*, duke e detyruar ta kalonte pjesën më të madhe të kohës në apartamentin e tij. Ai duhej të paraqitej në qendër dy herë në javë. Dy djemtë, që studionin në shkolla amerikane, i bënin telefonata të rralla. Ndërkohë shokëve të grupit të Stretos nuk iu ndalohej ta takonin *Kobrën*, por kush e bënte një veprim të tillë, transferohej larg me shërbim pas disa ditësh.

Në realitet nuk ishte e vështirë për CIAn ta izolonte prej shqiptarëve të tjerë një person me të kaluarën e *Kobrës*. Ky ishte bërë i urryer për bindjen e tij të verbër ndaj diktatorit edhe në ato raste kur përmasat e krimit ishin të përbindshme. Melit i kujtohej një akt i tillë marrëzie nga ana e *Kobrës* në nëntor të vitit 1972. Me rastin e 60-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, emigrantët politikë shqiptarë, përkrahës të monarkisë, do të organizonin një festë madhështore në Bruksel, ku do të merrte pjesë edhe pretendenti për fron, Leka I.

Regjimi diktatorial i Tiranës planifikoi të hakmerrej ndaj pjesëmarrësve në këtë festë. *Kobra* vetë e kishte thirrur në zyrë detektivin më të mirë të DSJ, Hamit Melin. Pasi ia kishte përshkruar si një sfidë ndaj qeverisë së Tiranës festën e parashikuar prej monarkistëve në Bruksel, *Kobra* i kishte thënë:

— Partia jonë ka vendosur t’iu japë përgjigjen e merituar atyre tradhtarëve të kombit. Kryeqyteti i Shqipërisë është Tirana, jo Brukseli. Ne tani jemi informuar se në cilën sallë do të zhvillohet mbledhja ceremoniale. I vetëquajturi Leka I do të jetë i pranishëm. Me këtë rast ai e meriton një *dhuratë* nga «mbretëria» e tij dhe do t’ia dërgojmë. Këtë mision po ta besojmë ty, si detektivi ynë më i mirë. Një bombë e fuqishme me sahat duhet ta « përshëndesë » mbretucin dhe të ftuarit e tij në kulmin e festës.

I tronditur prej këtij plani makabër, detektivi Meli ishte shprehur :

— Por, zakonisht, në festa të tilla marrin pjesë edhe shumë gra e fëmijë.

— E ç’rëndësi ka; a nuk janë familje armiqsh të pushtetit popullor edhe ata?

— Numri i viktimave do të jetë jashtëzakonisht i lartë.

— Rreth 250.

— Ky nuk është një mision, por një masakër. Unë nuk e marr përsipër.

— Detyra nuk është fakultative.

— Detektivi nuk është një kriminel ordiner.

— Kjo është fjala jote e fundit?

— Po.

— Partia do ta gjykojë sjelljen tënde dhe do të marrë masat e duhura. Ky kundërshtim mund të të kushtojë shtrenjtë, – kishin qenë fjalët e fundit të *Kobrës*.

Këtë masakër nuk e kishin marrë përsipër as dy detektivë të tjerë, që kishte thirrur *Kobra* pas Melit. Për shkak se refuzimi për kryerjen e këtij krimi qe në bllok prej detektivëve të DSJsë, partia u tregua *zemërgjerë* dhe hoqi dorë prej kryerjes së tij.

Mirëpo Streto dhe gjithë shokët e tij ishin në dijeni të kësaj tentative të përbindshme të *Kobrës*, me sugjerim të diktatorit, dhe nuk ia harronin lehtë, prandaj ata nuk kishin dëshirë as të komunikonin me të në Amerikë. Kjo e favorizonte planin e CIAs për izolimin e *Kobrës*.

Nga ana tjetër, Streto dhe shokët e tij e dinin mirë, se *Kobra* nuk kishte pasur ndërmend kurrë ta tradhtonte diktatorin Hoxha. Ai kishte qenë i detyruar ta bënte këtë vetëm, kur e kuptoi se e priste arrestimi në kuadër të fushatës së klanit Hoxha për eliminimin e rivalëve të mundshëm për pushtet, pas vdekjes së diktatorit mjaft të sëmurë. Edhe në këtë rast kishte nxjerrë krye egoizmi ekstrem i kriminelit *Kobra*. Duke u arratisur i shoqëruar prej katër oficerëve të zgjedhur, ai kishte marrë me vete edhe të dy djemtë e tij. Por sa djem e vajza të pafajshëm kishte zhdukur ai vetë gjatë 27 vjetësh karrierë gjaksore si kryepolici më i bindur i diktatorit Hoxha ?

Këta fakte të pakundërshtueshëm e transformonin *Kobrën* në një të arratisur ordiner për të shpëtuar lëkurën, gjë që lehtësonte planin e CIAs për izolimin e tij.

*

I vetëm në apartamentin e tij, i cili po i kthehej në burg, *Kobra* përpiqej ta justifikonte në ndërgjegje të kaluarën gjakatare:

«Unë isha vetëm një ingranazh i makinës diktatoriale. Ajo do të funksiononte edhe pa mua. Për fat të mirë, kundërshtarët tanë tradicionalë – nacionalistët – janë treguar tolerantë me ne. Edhe ata që aktualisht punojnë në CIA janë sjellë korrekt me mua, megjithëse ua kam persektuar familjet në Shqipëri. Bile ata sillen edhe më mirë se Streto me shokë, të cilëve e kuptoj që u krijoj alergji. Në realitet ne kemi ditur ta shfrytëzojmë për interesin tonë tolerancën e kundërshtarëve.»

Ky monolog i kujtoi *Kobrës* një ngjarje të vitit 1953.

Një mbrëmje vere të atij viti, ai udhëtonte për në Tiranë, i parashoqëruar prej një xhipsi ushtarak. Në një zonë të shkretë midis Lushnjës dhe Rrogozhinës, i kishte sulmuar një bandë e armatosur. Pas një shkëmbimi zjarri të dendur, *Kobra* ishte plagosur në këmbën e djathtë. Megjithatë ai kishte mundur të tërhiqej në një vend të sigurtë, ku kishte luftuar derisa i ishin mbaruar fishekët. Dritat e një kamioni që po afrohej e kishin detyruar bandën të tërhiqej.

Një anëtar i bandës kishte kaluar disa metra larg prej vendit, ku ishte pozicionuar *Kobra*. Nën dritat e kamionit, ata e kishin parë njëri-tjetrin. *Kobra* kishte drejtuar automatikun mbi armikun, por meqenëse nuk kishte fishekë, nuk kishte shtirë mbi të. Ai tjetri kishte menduar se *Kobra* ia kishte falur me dëshirë

jetën dhe kishte thirrur :

— Ja, edhe unë gati e kisha granatën, por po e flak nga ana tjetër.

Granata kishte shpërthyer tutje, ndërsa pjesëtari i bandës ishte zhdukur në errësirë.

Duke kujtuar këtë ndodhi të largët, *Kobra* u skërmit me cinizëm dhe pati kurajon t'ia pohonte vetes të vërtetën:

«Të kisha pasur qoftë edhe një fishek në gojë të automatikut, do t'ia kisha treguar mirë mëshirën unë atij!»

XXVIII

KOBRA NË LETARGJI

"*Çfarë të mbjellësh, do të korrësh*."
Populllore

Një dhimbje koke ia kishte turbulluar gjumin *Kobrës*. Atë mëngjes ai ndihej shumë i lodhur dhe nuk u çua prej krevatit. Duke endur shikimin e rënduar mbi muret e dhomës së gjumit, ai i fiksoi sytë mbi kalendarin: duhej hequr fleta me datën 13.

«Sot jemi më 14 mars», – tha me vete dhe vazhdoi: «Kur ishim fëmijë kjo datë na lajmëronte fillimin e pranverës. Ajo ishte një festë e bukur popullore, sidomos në fshat. Mblidhnim lule në fushë dhe bënim vizita tek bashkëfshatarët, të cilët na qirasnin bujarisht. Në drekë hanim mish qengji të shijshëm me kos të freskët. Jetë primitive, por e gëzuar, pranë natyrës e larg zhurmave. Por kur morëm ne pushtetin, i ndaluam me ligj festat tradicionale. Nuk e bëmë kot këtë. Duhej vrarë gëzimi i jetës, me qëllim që njerëzit të bëheshin robotë të Revolucionit Proletar. Çfarë pasojash të dëshpëruara pati kjo ! Tani data 14 mars nuk më kujton asgjë, është memece… Jo, jo, ajo më kujton diçka të rëndësishme, por në një drejtim tjetër : si sot një vit më parë ndodhesha në selinë e ambasadës amerikane në Londër. Të nesërmen fillonin negociatat tripalëshe midis CIAs, Inteligjencë Servisit dhe… Ilir Enver Hoxhës. Atëherë unë isha i rëndësishëm për amerikanët, se më përdornin si instrument për t'i detyruar anglezët të bënin lëshime në favor të tyre. Por tani jam i bezdisshëm për të dy palët, e kuptoj… Bile jam shumë më i bezdisshëm akoma për palën e tretë, që në të vërtetë është klan, jo palë : klani i diktatorit Hoxha. Këta janë gati t'iu plotësojnë çdo dëshirë amerikanëve, me kusht që të më heqin mua qafe, ngaqë kanë gënjyer popullin se më kanë pushkatuar ! Anglezët gjithashtu nuk më shikojnë dot me sy dhe nga këndvështimi i tyre kanë të drejtë. Po amerikanët, ç'më duan më ? Vetëm të më kenë bezdi nëpër këmbë. Me siguri do ta shesin shtrenjtë lëkurën time tek anglezët e tek klani i Hoxhës. Në fund të fundit çdo limon i shtrydhur në kosh përfundon. Kambanat bien për mua.»

*

Atë ditë *Kobra* duhej të paraqitej në Agjensi. Ngaqë ndihej shumë i lodhur, i telefonoi shefit të tij, duke e informuar për gjendjen jo të mirë shëndetësore. Eprori e miratoi kërkesën e tij për të bërë pushim.

Kobra u mbulua me çarçaf dhe mbylli sytë. Ditën ai ishte gjithmonë më i qetë. «Nata është strehë e të papriturave të këqija», mendonte. Ky ishte mësim i së kaluarës së tij keqbërëse, në shërbim të dikaturës së fandaksur.

Në orën dhjetë *Kobrën* e kishte zënë një gjumë i thellë. Mirëpo iu bë në ëndërr, sikur po i shqyenin portën ta agresonin. I tronditur, ai u ngrit ndenjur në

krevat, duke shtrënguar jastëkun në gjoks. Flokët e gjatë e të thinjur i mbulonin pjesërisht fytyrën e përflakur të mbuluar me bula djerse.

— Kush jeni ju e ç'doni nga unë ? klithi duke marrë frymë me zor.

— Qetësohuni, zotëri, unë jam mjeku juaj, – i tha njëri prej dy burrave që qëndronin në këmbë ndanë të krevatit. – Meqenëse jeni i sëmurë, më dërguan që t'ju vizitoj. I rashë disa herë ziles së apartamentit tuaj, por ju ishit në gjumë e nuk më dëgjuat. U detyrova t'i telefonoja Agjensisë, e cila dërgoi këtë kolegun psikolog me çelësin rezervë të apartamentit tuaj. Ne do të kujdesemi tani për ju, prandaj qetësohuni.

— Unë nuk jam i sëmurë, që të kem nevojë për ndihmë mjekësore. Meqenëse ndihesha i lodhur, i telefonova Agjensisë të pushoja sot. Kjo është e gjitha.

— Janë eprorët tanë që vendosin për gjithçka. Ju dhe ne e kemi për detyrë t'iu bindemi urdhërave të tyre. Tani shtrihuni në shpinë, se dua t'ju vizitoj.

Mjeku e kishte ndryshuar tonin. I habitur nga prania e vizitorëve të papritur, *Kobra* bëri si i thanë.

Pas një vizite të vëmendshme, mjeku i tha kolegut të tij:

— Nuk po konstatoj gjë. Temperatura dhe tensioni i gjakut janë normalë. Ndoshta ka më tepër nevojë për ndihmën tuaj, se për timen.

— Ja, të shikojmë, – ia ktheu psikologu. – Pse nuk u çuat nga krevati sot në mëngjes? e pyeti ai *Kobrën*.

— Nuk kisha fjetur mirë gjatë natës dhe në mëngjes ndihesha i lodhur.

— Përse nuk keni bërë gjumë të qetë natën?

I ulur ndenjur mbi krevat, *Kobra* ia nguli sytë personit që kishte bërë pyetjen e bezdisshme.

— Nuk është e lehtë të jesh i qetë në moshën time e në gjendjen time. Mendja nuk disiplinohet kollaj dhe ngacmon kujtimet, të cilat nuk janë gjithmonë të ëmbla.

— Po tani do të çoheni?

— Është e domosdoshme?

— Normalja është e domosdoshme. Agjensia kërkon nga ana jonë një relacion të përpiktë lidhur me gjendjen tuaj shëndetësore. Ju duhet të bëni një dush të zgjatur me ujë të vakët, se ju bën mirë. Pasi të keni ngrënë, merrni një hape nga kjo kutia që do t'ju lë mbi tavolinë. Ne do të kthehemi pas një ore.

*

I mbetur përsëri vetëm në dhomë, *Kobra* u ngrit dhe nxori një fotografi prej sirtarit të komodinës tek koka e krevatit. Pastaj mbushi përgjysmë vaskën me ujë të vakët dhe shtiu në të nga shampoja e tij e preferuar. U ul ndenjur në vaskë me fotografinë në duar. Me shikimin mbi fytyrat e djemve, nisi një monolog të trishtë:

«Historia ime po mbyllet, por kam merak për ju. Shpresoj që ju të mos përfundoni në plaçkë pazarllëqesh politike, si puna ime. Jeta juaj larg meje dhe

studimet më bëjnë pak optimist. Megjithatë nuk do ta keni aq të lehtë mbijetesën. Për opinionin publik shqiptar, unë nuk jam më në mes të të gjallëve. Mirëpo dëshmia juaj një ditë do ta bënte qesharake këtë lojë banale, që për interesa koniukturale po e mbështesin edhe amerikanët. Po u treguat të zgjuar dhe t'i respektoni rigorozisht udhëzimet e tyre, ndofta do t'ju kursejnë, sepse bota është e madhe dhe identiteti juaj mund të mbetet kollaj i panjohur. Sidoqoftë, nuk mundja të bëja dot më tepër as për të ardhmen tuaj, as për veten time. Kështu qe thënë. Lamtumirë, bijt e mi!»

Ai e grisi imët fotografinë dhe e shkarkoi vaskën me kujdes, për të mos mbetur asnjë copëz letre në të. Mandej shkoi të hante mëngjes, se po afronte ora e ardhjes së mjekëve. Duke parë fytyrën e tij të zverdhur e me rrudha në pasqyrë, *Kobrës* iu kujtuan fjalët që i kishte thënë *Dofeni* një ditë gjatë zhvillimit të negociatave sekrete të Londrës : *Qesh mirë, ai që qesh i fundit*.

Patologu dhe kolegu i tij psikolog e vizituan tri herë atë 14 mars pacientin e tyre të veçantë. Për herë të tretë i shkuan në orën tetë të mbrëmjes. Patologu i drejtoi një pyetje që e bëri të buzëqeshte për herë të parë atë ditë *Kobrën* :

— E keni pirë salepin në Shqipëri ?

— Po. Gjatë dimrit ai ishte një pije popullore në Tiranë.

— Bukur. Po ju përgatis një gotë salep me qetësues brenda, për të mos vuajtur nga pagjumësia sonte, siç ju ndodhi mbrëmë.

— Meqenëse jam i lodhur, shpresoj që të më zërë gjumi edhe pa qetësues sonte, – iu përgjigj *Kobra*.

— *Shpresoj* do të thotë *ndofta*. Armiku kundër të cilit luftojnë mjekët është vdekja, prandaj ne nuk bëjmë kurrë armëpushim me të. Por meqenëse nuk e paske qejf sonte salepin, po të përgatis vetëm një gjysmë gote.

— Faleminderit, – i tha *Kobra* me maja të buzëve, kur mjeku i dha gotën.

— Shëndet! – ia ktheu patologu.

Pas disa minutash *Kobra* filloi të gërhinte. Patologu i shkeli syrin kolegut dhe të dy dolën prej apartamentit.

— Mbrëmë ia turbulluam pak gjumin, por sonte e rehatuam mirë, – i tha psikologu në ashensor shokut. – Prandaj ai nuk ka të drejtë të jetë i pakënaqur prej nesh.

XXIX

NATA E ERRËT E ISHUJVE MALVINE

«*Shumë mendojnë se pabesia*
nuk është paqëndrushmëri karakteri.»
Sh. dë Lakló

Në orën tetë e gjysmë të darkës, një veturë e ndjekur nga një ambulancë dolën prej qendrës Langley të CIAs në Washington. Pas tre çerek ore rrugë, ato u futën në një aeroport ushtarak dhe ndaluan përbri një avioni të gatshëm për fluturim. Dy persona nxorën nga ambulanca një të sëmurë të mbuluar dhe e futën krevatin me rrota në avion. Ata vetë u kthyen përsëri në ambulancë.

Dy vetë zbritën nga vetura dhe u ngjitën në aeroplan. Ndërsa ambulanca po dilte nga aeroporti, avioni u shkëput prej andej. Fluturimi i tij kishte drejtim juglindor. Destinacioni i aeroplanit ishin ishujt Malvine.

Tre vjet më parë, për ata ishuj ishte zhvilluar një konflikt i armatosur midis Argjentinës, që donte t'i zotëronte meqë ndodheshin jo larg brigjeve të saj, dhe Anglisë, që i kontrollonte qysh prej vitit 1832. Mjaftuan dy muaj luftë për ta bindur Argjentinën, se nuk është e lehtë ta shpronësosh Anglinë nga llokmat e rruzullit që zotëron prej shekujsh. Pas këtij konflikti të armatosur, anglezët e transformuan këtë arqipelag të Atlantikut me tre mijë banorë në një bazë ushtarake të sofistikuar.

Sa më shumë që aeroplani ushtrak përparonte drejt jugut, aq më e errët bëhej nata. Valët e oqeanit ishin të trazuara. Kur po i afrohej destinacionit, avioni e uli shpejtësinë. Një shi me rrebesh e vështirësonte zbritjen. Aeroplani u end një copë herë të mirë mbi qiellin e arqipelagut. Ishte ora tre e mëngjesit, kur ai u ul në aeroport.

Dy persona zbritën prej tij dhe shkuan e takuan tre kolegë, që po i prisnin pak më tej. Pas një bisede të shkurtër në këmbë, njëri prej mikpritësve foli në radio. Një ambulancë mbërriti shpejt. Të sëmurin e kaluan nga avioni në ambulancë. Dy personat, që ishin kujdesur për të në aeroplan, zunë vend në ambulancë. Tre të tjerët u futën në një veturë, që po i priste disa metra tej tyre.

Një orë më vonë, dy shoqëruesit e të sëmurit u kthyen përsëri në aeroport. Ata hipën në avion, i cili nuk vonoi të niste itinerarin e kthimit në SHBA.

*

Më 15 mars 1984 *Kobra* asistonte përkrah delegacionit të CIAs në çeljen e negociatave sekrete të Londrës. Më 15 mars 1985 CIA ua dorëzoi *Kobrën* anglezëve në bazën ushtarake të arqipelagut të Malvineve.

XXX

SUKSES I *ALEANCËS* LONDËR–TIRANË

“*Historia është më inatçore se njerëzit*.»
N. Karamzin

Një ditë e kthjellët dhe e ftohtë e pasoi natën e errët të Malvineve. Bluja e thellë zëvendësoi bardhësinë e shkumës së valëve të trazuara të Atlantikut. Gumëzhima e tyre ia la vendin një qetësie të përgjithshme. Errësira e natës i kishte marrë me vete anomalitë natyrore e njerëzore. Dita po mbillte ëmbëlsisht paqen.

Në orën dhjetë e gjysmë një veturë e zezë ndaloi pranë një observatori. Tre persona zbritën prej saj. Me sytë mbi oqean, ata qëndruan disa minuta në këmbë, para se të ngjiteshin në kullën e vëzhgimit. I lajmëruar për mbërritjen e vizitorëve të rëndësishëm, personi që shërbente atje i priti gjithë respekt.

— Do të të zëvendësojmë një copë herë në shërbim, – i tha me të qeshur njëri prej mysafirëve. – Meqenëse sot dita është shumë e kthjellët, duam të soditim pak oqeanin.

— Kjo është kënaqësia ime, – u përgjigj punonjësi me një përkulje të lehtë.

Ai doli prej kabinës së vëzhgimit me pajisje moderne dhe u ul në një karrige nën rrezet e diellit, ku nuk e kapte era.

Tre vizitorët filluan të soditnin hapësirën oqeanike. Përveç kaltërsisë së ujit e të qiellit, në objektiv parakalonin pulëbardha, kara-kara e shpendë të tjerë detarë. Mandej ata vëzhguan qendrat urbane të arqipelagut dhe instalimet ushtarake. Këto të fundit i bënin sfidë paqes natyrore të atij vendi të begatë.

— Ç’mendim keni për këtë peizazh të Atlantikut, z. Hoxha? e pyeti njëri prej shoqëruesve, duke i shqiptuar ngadalë fjalët.

— Vërtet i mrekullueshëm, – u përgjigj *Dofeni* me një theks anglishteje që linte për të dëshiruar. – Ju anglezët keni ditur të zgjidhni gjithmonë. Megjithatë sytë e mi sot janë të etur për një pamje tjetër, – shtoi ai duke shikuar ngultas bashkëbiseduesin.

— E di; prandaj ndodhemi këtu. Por *mysafiri*, që ju prisni të shikoni me padurim, është endé në *gjumë*. Sapo të zgjuhet, do të shkojmë atje. E rëndësishme është që ai ndodhet përfundimisht në duart tona. Do t’ju ngopen sytë duke e parë siç dëshironit prej kohësh.

— Kam përshtypjen se sytë e mi nuk do të ngopen kurrë duke e parë *Kobrën* në pranga e të poshtëruar. Kam ëndërruar gjatë ta shikoja në agoni tek këmbët e mia. Ju falënderoj përzemërsisht për përpjekjet tuaja, që u kurorëzuan me këtë sukses të përbashkët.

— Miqtë e vjetër nuk kanë pse ta falënderojnë njëri-tjetrin, se, siç thatë ju vetë, sukseset i kemi të përbashkëta. Ju duhet t’i jeni mirënjohës babait tuaj, atij burri shteti largpamës, emri i të cilit do të mbetet simbol jetëgjatësie i bashkëpunimit me Inteligjencë Servisin.

— Vetëm diçka do të më mbetet merak. Siç e dini, babai është i sëmurë aktualisht dhe nuk do ta shijojë siç duhet këtë arritje historike të bashkëpunimit tonë. Kur DSJ po organizonte *Misionin e Madh*, babai më thoshte herë pas here: «Ilir, bëj çmos që të ma sjellësh *Kobrën* të gjallë në Shqipëri, se ikja e tij më ka shqetësuar shumë. I kam mbushur dhëmbët me të gjithë shqiptarët; ai më shpëtoi paq. Dua t'ia shkul me duart e mia, pa anestezi, dy dhëmbët e sipërm të qenit, që më ngjajnë vërtet si dhëmbë kobre. Unë e di që ai i ka ditët të numëruara prej anglezëve, por po nuk e arrita për së gjalli këtë, ata dy dhëmbë të *Kobrës* do m'i çoni në arkivol. Vetëm ashtu mund të prehem i qetë.»

— Në qoftë se babai juaj i nderuar nuk do të ishte i sëmurë, sot do ta festonim së bashku fitoren këtu. Sa për amanetin që ju ka lënë, mos u bëni merak fare: ai do të plotësohet pas disa orësh. Me ndihmën tonë, ju do t'ia shkulni sot me dorën tuaj dy dhëmbët e sipërm të qenit *Kobrës*, për t'ia çuar ata babait të sëmurë. Ai njeri i madh e meriton t'i plotësohet çdo amanet. *Kobra* do t'i nënshtrohet këtu një hetuesie të rreptë e të gjatë, para se t'i mbyllë sytë përgjithmonë. Të gjitha seancat hetimore do të filmohen e do t'ju dorëzohen juve. Kështu ju do të keni mundësinë t'i transmetoni ato në televizionin tuaj, për të bindur opinionin e brendshëm, se atij i është bërë hetuesia në Shqipëri dhe po atje është *pushkatuar*, konform me njoftimin zyrtar që keni bërë. Por marrëveshja që arritëm me amerikanët nuk na lejon që ta riatdhesojmë *Kobrën* e as ta nxjerrim të gjallë prej arqipelagut Folklend. Pra, kufoma e tij do të përfundojë në thellësi të oqeanit.

— Orët e pritjes do më duken të gjata, – i tha buzagaz *Dofeni*. – Në ç'drejtim ndodhet dhoma e tij e izolimit?

— Nga ana tjetër e këtij ishulli. Jo larg prej atij farit, që duket në horizont. Atje ndodhet një spital ushtarak i nëndheshëm. Rreth njëzet metra matanë tij kemi disa dhoma izolimi sekrete. Në njërën prej tyre *Kobra* është duke fjetur për herë të fundit i qetë në këtë jetë. Sapo të përmendet, do ta kuptojë se çfarë i ka ndodhur, mbasi i ka duart dhe këmbët në pranga dhe është me kaskë plastike në kokë, që të mos ketë mundësi të bëjë vetëvrasje. Ai do dëgjojë vetëm rënkimin e oqeanit, pa e kuptuar dot se ku ndodhet. Ne do të bëjmë një shëtitje bashkë deri afër farit, për ta parë nga afër vendin ku është i varrosur për së gjalli *mysafiri* yt. Në orën gjashtë të darkës, do të jetë gjithçka gati për spektaklin historik.

XXXI

DOFENI PËRBALLË *KOBRËS*

“*Duhet pritur gjithçka në politikë, ku gjithçka është e lejuar, përveç befasimit prej saj*. »

Sh. Morra

Sa më tepër afrohej ora e ballafaqimit të madh, aq më shumë i shtoheshin emocionet *Dofenit*. Ky fakt po e nervozonte dhe po e shpërqendronte më tepër. Megjithëse *Kobra* kishte qenë njëri prej shërbëtorëve më besnikë të diktatorit, ai i kishte frymëzuar gjithmonë një antipati të thellë *Dofenit*.

«Servilizmi nuk është shenjë besnikërie, përkundrazi. Kërcënimi më i madh për një autokrat është shërbëtori servil që ia njeh pikat e dobëta», – mendonte *Dofeni*.

Pikërisht për këtë arsye ai e urrente shumë *Kobrën*. Bile këtë ndjenjë alergjie ndaj kryepolicit servil *Dofeni* kishte arritur t’ia transmetonte edhe nënës..

*

Tingëllimi i ziles së telefonit e bëri t’i kalonin mornica *Dofenit* të emocionur prej takimit të afërt me *Kobrën*. Ai psherëtiu dhe ngriti receptorin.

— Është ora të nisemi për atje, z. Hoxha; *Kobra* po na pret, – i tha me tone humori zëri nga ana tjetër e telefonit.

Dofeni u përpoq të fliste me zë të qetë:

— Faleminderit ; po vij.

Ai i hodhi një sy të shpejtë orës : 17 e 50 minuta.

Dofeni shkoi para pasqyrës të krihej. Zbehtësia e fytyrës së tij e bëri të kërcëllinte dhëmbët nga inati. Personat që po e prisnin jashtë do të habiteshin nga ngjyra e zbehtë e fytyrës së drejtorit të DSJsë, i cili nuk arrinte ta zotëronte veten as në atë çast triumfi për të. Ai e lyeu fytyrën me krem dhe doli. Zyrtarët e Inteligjencë Servisit, që po e prisnin, u përshëndetën me të dhe u futën bashkë në veturë.

Pas një çerek ore rrugë, ata zbritën dhe hynë në një postë policie. Një person i veshur civil u buzëqeshi miqësisht, u takua me ta dhe i ftoi të merrnin kafe bashkë.

— Jo tani. Pas vizitës që do bëjmë, me gjithë qejf. *Miku ynë i dashur* po na pret, – i tha njëri prej shoqëruesve të *Dofenit*.

— Atë punë do të ketë *miku* juaj tani, të presë mysafirë të padëshiruar sa të jetë i gjallë. Orën e vizitave e caktojmë ne, jo ai.

— Sigurisht, por mezi presim t’ia shikojmë sytë.

— Si të dëshironi.

Tre të ardhurit dhe ai që i priti u ngjitën në katin e dytë të godinës dhe morën

një korridor të gjatë. Në fund të korridorit ishte një ashensor, tek hyrja e të cilit shërbente një polic. Ky i buzëqeshi shefit, i cili i tregoi një letër. Të katër u futën në ashensor. Zbritja zgjati shumë. Kuptohej që ata do të vizitonin një ambient të nëndheshëm.

Pasi dolën nga ashensori, ecën nëpër një korridor të ndriçuar mirë. Dy policë shërbenin përpara një porte të hekurt. Ata u përshëndetën me të sapoardhurit dhe filluan të lexonin së bashku autorizimin që u paraqiti eprori i tyre. Mandej hapën portën dhe njëri prej policëve i shoqëroi deri tek një tjetër portë e hekurt, të cilën ai e hapi me një çelës që e kishte të lidhur tek kyçi i dorës.

— Këtu përfundon detyra ime, – u tha ai mysafirëve.

— E imja gjithashtu, – shtoi buzagaz shefi i tij.

Të dy këta u tërhoqën tek porta e parë.

Njëri prej shoqëruesve të *Dofenit* shtyu portën e rëndë prej hekuri dhe të tre kaluan matanë. Ata u gjendën në një dhomë izolimi rreth tri metra të gjerë. Gjatësia e saj mbetej e panjohur për ta, sepse një perde e rëndë blu dypjesëshe fshihte anën tjetër të dhomës.

— Matanë kësaj perdeje shfaqet pamja për të cilën ju keni ëndërrar gjatë, z. Hoxha, – i pëshpëriti më i pushtetshmi prej dy shoqëruesve të tij.

Dofeni buzëqeshi në heshtje, pa e evituar dot zbehjen në fytyrë. Dy anglezët u pozicionuan në të dy anët e perdes. Me një lëvizje të shpejtë, ata i tërhoqën në të njëjtën kohë dy pjesët e perdes, duke lënë ballë për ballë *Dofenin* me *Kobrën*. Ata vetë nuk dukeshin.

Kobra gjendej në një kolltuk të posaçëm, me trupin të anuar pak prapa. Duart i kishte të lidhura në të dy anët e mbështetëses së kolltukut, ndërsa këmbët të lidhura pas fundit të kolltukut të fiksuar në dysheme. Ai duhej të kishte qenë në gjendje dremie sepse, sapo u hap perdja me rrëmbim, bëri një lëvizje të beftë i lidhur siç ishte. Kaska speciale që i kishin çuar në kokë i linte të zbuluar jo vetëm fytyrën por edhe ballin. *Kobra* shqeu sytë nga tmerri duke parë *Dofenin* aq afër. Tani ishte gjithçka e qartë për të dhe kjo e çoroditi përfundimisht.

Duke parë armikun e tij të kahershëm të përpëlitej si një bishë në lak, drejtori i DSJsë qeshi me të madhe, duke mbajtur ijët me dorë. Në ato çaste ai po përjetonte realizimin e një ëndrre.

Kobra nuk ishte shurdh, siç janë kobrat në natyrë. Për veshët e tij, të mësuar me gumëzhimën e valëve të oqeanit qyshkur ishte përmendur, kjo qeshje me gurmaz të shpalosur e djalit të diktatorit ishte nekrologjia e tij morale. I terrorizuar, ai tentoi të shkarkonte një pjesë të vrerit:

— Tradhtar e bir tradhtari, mendon se kjo është një fitore për ty?

— Më tepër sesa një fitore e zakonshme. Është një triumf për mua të shikoj kryepolicin dezertor, të kapur si miu në çark. Ti e mbaje veten si një specialist i regjur i çështjeve policore, si të gjeti kaq bosh kjo hatà dhe përfundove si lepur në lak? Tani nuk je, veçse një kobër në agoni; mjerë ti! Për të shpëtuar lëkurën tënde të ndyrë, mendove të bëheshe spiun i amerikanëve, ë? Ishe shumë i vonuar, *Kobër* e mjerë! Pasi i kishe shërbyer me fanatizëm për 37 vjet babait

tim, shpresoje ta mbijetoje regjimin e tij duke e tradhtuar, ë? Çfarë perversiteti! Në saje të meritave të babait tim, ti dhe të tjerët bëtë një karrierë shumë të gjatë, të pamerituar. Por ti nuk je i vetmi, që e tradhtove bamirësin tënd. Kur babai im i flakte shërbëtorët e tij të neveritshëm në koshin e historisë, ata kujtoheshin ta akuzonin për krimet që kishin kryer vetë. Përse nuk guxonit ju ta kundërshtonit atë, kur gëzonit privilegjet e pushtetit? Edhe sikur shefi i tyre ta kishte gabim, shërbëtorët e tij të nënshtruar nuk kishin të drejtë ta akuzonin për veprën e tyre të përbashkët, se kjo është poshtërsi. Shërbëtorët e verbër nuk mund të bëhen gjykatësit e krimeve të tyre. Mos harro, *Kobër* e mjerë, se babai im ka qenë më i aftë se bashkëpunëtorët e tij. Fundi yt i tmerrshëm është një provë për këtë. Ti mjeran nuk di se ku gjendesh sot në pritje të vdekjes së sigurtë, ndërsa im atë sundon krenar popullin e vendin e tij.

— I shkalluar nga trutë prej fantazmave të viktimave, që i dalin në gjumë, – klithi me dëshpërim *Kobra*.

— Babai im nuk ka vrarë njeri me duart e tij, mbasi ai kishte në dispozicion një mori kriminelësh si puna jote, të gatshëm për të kryer çdo lloj krimi për t'i bërë qejfin atij. Si çdo njeri, edhe babai im do vdesë një ditë, por vetëm mbasi të ketë zhdukur ty, që doje ta shpëtoje lëkurën nëpërmjet tradhtisë. Ndërkohë unë i kam dhënë fjalën se do t'i çoj dy dhëmbët e helmit të *Kobrës*, të shkulur pa anestezi, si shpagim për tradhtinë tënde.

Në çast *Dofeni* dhe dy shoqëruesit e tij shkuan pranë *Kobrës* së lidhur. Njëri prej anglezëve i hoqi kaskën, e kapi për flokësh dhe ia ngjiti kokën pas mbështetëses së kolltukut. Pastaj e goditi në gurmaz me presën e pëllëmbës së dorës së djathtë. *Kobra* ia bëri *oh!*, ndërsa anglezi tjetër i futi menjëherë në gojën e hapur një objekt të posaçëm, që nuk e lejonte më t'i bashkonte nofullat. Ai i bëri shenjë *Dofenit.* Ky, me sy të përflakur e i buzëqeshur, nxori një darë dentisti nga xhepi dhe mbërtheu me të njërin prej dhëmbëve të sipërm të qenit të *Kobrës*, i cili po zgurdullonte sytë, pa qenë në gjendje të shqiptaonte asnjë tingull.

Duke hapur një kuti të vogël të bukur, anglezi që po i mbante gojën hapur *Kobrës*, i tha *Dofenit*:

— Bëj kujdes që të mos ia thyesh, z. Hoxha.

Pasi e çoi në kuti dhëmbin e parë, *Dofeni* iu përkushtua të dytit.

Si i futën të dy dhëmbët në kuti, ata u kujdesën për të kufizuar hemorragjinë e *Kobrës*, i rivendosën kaskën dhe dolën, duke e mbyllur derën.

— Misioni ynë mbaroi tani, z. Hoxha, – i tha kryesori prej shoqëruesve të tij, duke i shkelur syrin. – Tani ka kush merret me *Kobrën* pa dhëmbët e helmit.

Dofeni e falënderoi i entuziazmuar dhe shtrëngoi kutinë e vogël pas zemrës. Para se ta fuste në xhep, e ledhatoi një herë me sy. Mbi kapakun e kutisë ishte skalitur portreti i Hudson Llout me dylbitë të drejtuara mbi rezidencën e të burgosurit legjendar të ishullit të Shën-Helenës.

XXXII

KOPSHTARI BESNIK

« *Hipokrizia është thjesht një homazh për interesin*. »

Multatuli

Diktatori Hoxha po shëtiste përqark vilës së tij të madhe. Kopshtari po sodiste me kënaqësinë e profesionistit të pasionuar lulet shumëngjyrëshe, i ulur në bisht. Papritur zëri që rrëqethte gjithë një popull e bëri t'i kalonin mornica :

— Si e ka emrin ajo lulja e purpurtë, që lëshoka këtë aromë të këndshme, mo kopshtar ?

Ky u çua me vërtik në këmbë dhe u përgjigj buzagaz :

— Ne i thërrasim *persola*.

— Nuk qenka e zhvilluar mirë.

— Ashtu është, shoku Enver. Ka katër vjet që e kemi sjellë nga Franca, por megjithë kujdesin tonë të veçantë, ka mbetur e pazhvilluar si duhet, krahasuar me gjithë lulet e tjera. Është mjaft delikate.

— Sot e tutje duhet ta thërrisni *Delikatja*. Ky emër do ma shtojë akoma më tepër dashurinë për këtë lule të përflakur e kaq aromatike. Me këtë emër e thërrisnin gruan time të ardhshme, kur e kam njohur në rininë tonë. Gjërat e bukura janë edhe delikate, apo jo, mo kopshtar ?

— Siurdhëron, shoku Enver. Konstatimet tuaja janë përherë mësimdhënëse për ne.

— Ashtu de. Buqetat e përditshme në tavolinën time të punës duhet ta kenë *Delikaten* brenda.

— Dëshira juaj është detyra jonë, shoku Sekretar i Parë.

— Bravo. Tash unë do vazhdoj shëtitjen.

Premtimi që i bëri udhëheqësit lidhur me buqetën e përditshme e vuri në vështirësi serioze kopshtarin. Ky u detyrua ta dhjetëfishonte kultivimin e *Delikates*, për të siguruar sasinë e mjaftueshme të saj. Sa herë që e shikonte diktatori pas kësaj bisede nuk harronte që ta pyeste :

— E, mo, kopshtar, si duket *Delikatja ?*

— Gjithmonë e më mirë, shoku Enver, – i përgjigjej ai duke qeshur.

*

Kujtimi i kësaj bisede të ngrohtë me udhëheqësin e bëri të buzëqeshte kopshtarin me përvojë një mbrëmje të ngrohtë prilli të vitit 1985. Atë pranverë lulet ishin harlisur, si asnjëherë tjetër. Edhe *Delikatja*. Duke soditur lulet e preferuara të udhëheqësit, kopshtarit iu mbushën sytë me lot: diktatori në agoni nuk i shikonte e as nuk i nuhaste dot *Delikatet* në zhvillim të plotë.

«Sikur e bënë kastile sivjet këto të uruara», – tha me vete kopshtari, duke

hequr në zemër.

Qysh prej një kohe të gjatë, ai kujdesej për gjelbërimin e vilës së udhëheqësit. Pas ndërtimit të vilës së re, që mbante numrin e shancit 31, parcelat e luleve ishin shtuar mjaft. Atje punonte një skuadër e posaçme e shërbimeve qeveritare, por teknikisht përgjigjej gjithmonë ai specialist gjelbërimi, që familja e madhe e thërriste *kopshtari*. Ai ishte një ndër personat e pakët që kishte kontakt pothuajse të përditshëm me anëtarët e familjes së parë shqiptare. I qetë nga natyra e fjalëpakët, sjellja e kopshtarit në punë linte të kuptohej se ai nuk kishte as sy e as vesh për çfarë ndodhte rrotull tij. Asnjë prej anëtarëve të familjes së tij nuk guxonte t'i drejtonte qoftë edhe një pyetje të thjeshtë kopshtarit, përsa i përkiste vendit të tij të punës.

Me kalimin e kohës, kjo sjellje korrekte e bëri kopshtarin person të preferuar të familjes së madhe. Veçanërisht bashkëshortja e udhëheqësit e admironte heshtjen e tij të përhershme dhe i kishte ngjitur me simpati nofkën *Padre*. Gjithmonë i përkushtuar në punë, serioz e i heshtur, kopshtari e kishte bindur se ishte njeri i denjë për mirëbesim. Pas një dekade, ajo diskutonte edhe çështje familjare të dorës së dytë me *Padren*.

Në mbrëmjen e 10 prillit 1985 kopshtari ndodhej në ambientet përqark vilës me rekomandim të zonjës së parë. Qysh prej një jave diktatiori ishte i sëmurë rëndë. Bashkëshortja e tij, e cila rrezikonte të mbetej e ve, i kishte kërkuar *Padres* të mos largohej për në shtëpi të tij para mesnatës. Për këtë qëllim, ajo i kishte vënë në dispozicion një dhomë në vilën e vjetër. Ai mund të nisej për në shtëpi të tij vetëm kur vetë zonja e parë do t'i thoshte *natën e mirë*!

Për të vrarë kohën, kopshtari po u hidhte një sy luleve të harlisura atë mbrëmje të 10 prillit. Ai ishte duke i ledhatur si fëmijë një lehe lulesh nga të preferuarat e udhëheqësit, kur dëgjoi një zë gruaje shumë të njohur:

— Po bisedon me lulet, *Padre*?

Ai drejtoi trupin dhe u përgjigj me sy të përlotur :

— Po ledhatoja lulet më të dashura të udhëheqësit tonë.

Zonja e Parë i rrahu miqësisht shpatullat dhe qëndroi disa çaste në heshtje.

— Si quhet ajo lule, *Padre* ? e pyeti pas pak.

Megjithëse i përlotur, kopshtari buzëqeshi para se t'i përgjigjej :

— Shoku Enver e ka pagëzuar *Delikatja*.

Ishte radha e asaj të buzëqeshte, duke i drejtuar pyetjen tjetër :

— Cila është origjina e këtij emri ?

I inkurajuar nga buzëqeshja e zonjës së parë, kopshtari u përgjigj :

— Shoku Enver më tregoi se ai ju ka njohur me këtë nofkë të bukur për herë të parë në rininë tuaj. Një kujtim i ëmbël, – shtoi ai me zë të ulët.

— Ashtu është, *Padre*, – tha ajo me një pamje të menduar. – Ishim të rinj atëherë dhe nuk na shkonte kurrë ndërmend, se e ardhmja jonë do të ishte kaq e lavdishme. Por, fatkeqësiht, çdo gjë ka një fund në këtë botën tonë. Pas një karriere të shkëlqyer dyzetë e një vjeçare në shërbim të popullit e të atdheut, udhëheqësi ynë i lavdishëm sot është në agoni. Ti punon prej një kohe të gjatë

këtu, *Padre*, dhe ne të konsiderojmë tashmë si një pjesëtar të familjes sonë. Ti e ke merituar këtë me përkushtimin në punë dhe me sjelljen shembullore. Në këto çaste të vështira për familjen tonë, unë kam nevojë për këshillën tënde të sinqertë, *Padre*. Qysh prej 48 orësh im shoq ndodhet në agoni dhe po e vuan njëmijë herë vdekjen, pa e dorëzuar shpirtin. Grahmat e tij po terrorizojnë fëmijët e mi dhe mua vetë. Shoku Enver nuk e meriton një fund kaq të tmerrshëm dhe ne, familja e tij, një ndarje prej tij kaq të dëshpëruar. Sipas komisionit mjeko-ligjor, që po e ndjek nga afër gjendjen e tij, nuk ka më asnjë shpresë shpëtimi. Në këto kushte, duhet menduar për një fund më të lehtë të tij, *Padre*. Në këtë çështje delikate kam nevojë për ndihmën tënde.

«Kur isha vajzë e re në Dibër, një herë kisha dëgjuar të flitej shumë për agoninë e zgjatur e të mundimshme të një njeriu që kishte qenë vrasës me pagesë. Për t'iu dhënë fund vuajtjeve të tij, u thirr një person që njihte një metodë origjinale për ta shpejtuar fundin e njeriut në agoni, pa përdorim ilaçesh. Brenda disa minutash, ai ia kishte arritur qëllimit, në prani të të afërmve të atij që hiqte shpirt.

«Vetëkuptohet që gjatë karrierës së tij politike disadekadëshe, shoku Enver ka qenë i detyruar të urdhërojë vrasjen e shumë armiqve të popullit. Si njeri me përvojë në jetë, a mund të më ndihmosh, *Padre*, t'ia lehtësojmë fundin udhëheqësit tonë të dashur?

I befasuar nga kërkesa e zonjës së parë, kopshtari uli kokën. Atij po i kërkohej t'i shpejtonte fundin atij që deri para pak ditësh vlerësohej si i pavdekshëm. Dhe një kërkesë të tillë ia bënte bash e shoqja e udhëheqësit! Ëndërr apo realitet?

Prania e zonjës së parë në pritje të përgjigjes së tij e detyroi *Padren* të mblidhte veten. Ai u përgjigj me një zë si të ngjirrur:

— Edhe unë kam dijeni për diçka të tillë. Bile një rast kam asistuar në një ritual të tillë, që më ka impresionuar shumë. Më vonë e kam kontaktuar kastile personin që e aplikoi atë, i cili kishte lindur me një dhunti të tillë. Ai ishte plak atëherë dhe me këmbënguljen time pranoi të më shpjegonte disa veçori të aftësisë së tij. Para gjashtë vjetësh edhe unë vetë e kam provuar me sukses këtë tek një person që kishte vrarë dikur vëllanë e tij. Por në gjithë këta raste bëhet fjalë për njerëz të thjeshtë mëkatarë, ndërsa bashkëshorti juaj është një burrë shteti i madh. Nuk mund të vihet shenja e barazimit midis të gjithë njerëzve.

— Vdekja është e barabartë për të gjithë njerëzit, *Padre*, jetët ndryshojnë. Është natyra që ka vendosur shenjën e barazimit midis gjithë krijesave të saj. Unë të bëj thirje të më ndihmosh për të zgjidhur problemin tim delikat, në qoftë se je njeriu besnik që kam respektuar prej kohësh.

— Gjersa pranë të sëmurit gjendet komisioni mjeko-ligjor, unë nuk bëj dot asgjë.

— Të kuptoj. Atë çështje e rregulloj unë. Në momentin e duhur, nuk do të ketë njeri tjetër në dhomë përveç fëmijëve dhe mua.

— Normalisht, është më mirë që të veprojmë pas mesnate.

— Gjë që rregullohet. Do të presim deri në orën një pasmesnate. Në rast se

situata do të jetë e njëjtë, unë do të dërgoj njeri kastile në dhomën tënde, për të të lajmëruar që të vish. Të faleminderit për gatishmërinë.

— Është pjesë e detyrës sime. Më vjen keq që nuk bëj dot më tepër për atë njeri të madh, – tha duke psherëtirë kopshtari.

XXXIII

LAMTUMIRË !

“*Lavdia e diktatorëve është turpi*.”
M. Orest

Në orën dhjetë të darkës kopshtari shkoi në dhomën e tij. Ai vendosi të mos flinte atë natë që udhëheqësi mund të nisej në udhën pa kthim. Personi, që mund të vinte ta thërriste, nuk duhej ta gjente kopshtarin në gjumë. Nga ana tjetër, në qoftë se ai do ta dorëzonte shpirtin pa qenë nevoja për ndihmën e *Padres*, ky do ta kuptonte këtë prej intensifikimit të lëvizjeve në vilën e madhe.

Kopshtari nxori një shishe verë nga minibari, përgatiti sallatë dhe hapi dy konserva sardelesh. Kështu do ta kalonte kohën më mirë.

Ai nxori një album fotografish nga komodina e natës dhe filloi ta shfletonte. Faqen e parë e zinte një fotografi e zmadhuar, ku kopshtari kishte pozuar përkrah udhëheqësit më 16 tetor 1983, me rastin e 75-vjetorit të ditëlindjes së atij. Ideja se udhëheqësi ndodhej në agoni vetëm një vit e gjysmë pas asaj dite e trishtoi kopshtarin. Para se të pozonin bashkë atë ditë, *Padria* e kishte uruar me gjithë zemër idolin e tij :

— Ju uroj të jetoni njëqind vjet, shoku Enver !

— Unë do të jetoj 125 vjet, – ia kishte pritur ai. – Për mua pleqëria fillon në moshën 90 vjeç.

I tronditur ngaqë i kishte shkurtuar një çerek shekulli jetë udhëheqësit të dashur, kopshtari ishte përpjekur ta korrigjonte gabimin :

— Unë e kisha fjalën për jetën tuaj aktive në krye të partisë e të popullit, shoku Enver. Si pensionist, ju do të jetoni 150 vjet.

— Ashtu po, – kishte rënë dakord udhëheqësi.

*

Kur zonja e parë dërgoi dikë për të thirrur *Padren*, ky po flinte. Efekti i verës dhe dëshpërimi e kishin fundosur në gjumë. Pasi kishte trokitur shumë herë më kot, i dërguari i posaçëm kishte hyrë në dhomë. Pamja që iu shfaq para syve e habiti : kopshtari gërhiste thellë, në një kohë që gjumi në atë situatë ishte një gabim i rëndë ideologjik. Atij iu desh që ta tundte *Padren* për tu përmendur.

I turpëruar, kopshtari u ngrit duke fërkuar sytë fort. Shikoi orën : një e tridhjetë minuta. Shpëlau fytyrën me ujë të ftohtë, për t’i dalë gjumi, dhe krehu flokët e thinjur përgjysmë. Pastaj deshi të fuste një bonbone në gojë, por ndryshoi mendim në çast. Ky do të kishte qenë gabimi i dytë ideologjik atë natë hidhërimi të përgjithshëm. Kopshtari nxori nga bufeja një send të mbështjellë me letër të bardhë dhe doli bashkë me korrierin.

Në hyrje të vilës së re e priste zonja e parë. Kjo bisedoi kokë më kokë me *Padren* disa minuta, pastaj i priu për tek dhoma e të sëmurit. Pamja e njeriut në

agoni e tronditi kopshtarin. Nuk ishte hera e parë që ai shikonte një person në prag të shpirtdhënies, por grahmat e diktatorit i ngjethën mishtë. Çfarë shikonin në ato çaste sytë e tij gjysmë të mbyllur, shikimi vrastar i të cilëve kishte tmerruar çdo shqiptar ?

Një shenjë kuptimplote e zonjës së parë ia ndërpreu meditimin *Padres*, i cili nuk kishte ardhur aty si një vizitor i thjeshtë. Ai duhej të fillonte ritualin misterioz, ndërkohë që gjithë familja e madhe qëndronte në këmbë.

Kopshtari i moshuar nxori objektin e mbështjellë me letër të bardhë. Ajo ishte një thikë e gjatë me dy presa të mprehta e dorezë të ndritshme. Me pamje kërcënuese në fytyrë, *Padre* filloi të bënte lëvizje të shpejta me thikë përmbi fytyrën ngjyrë limoni të njeriut në shtratin e vdekjes. Ai bënte sikur kapte njeri për flokësh me dorën e majtë, ndërsa me të djathtën i kalonte shpejt thikën në gurmaz.

Këto gjeste të çuditshme donkishoteske filluan të sillnin efektin e tyre pas disa minutash. Nën sytë e përlotur të anëtarëve të familjes, fytyra e njeriut në agoni sikur u gjallërua pak. Pastaj ai lëvizi qepallat dhe u duk sikur donte ta përqëndronte shikimin, pothuajse të shuar, nga ana e majtë e jastëkut. Ky gjest i pashpjegueshëm e çorientoi *Padren*. Ai ndërpreu manovrimet e thikës dhe foli me zë të ulët me zonjën e parë. Kjo futi dorën poshtë jastëkut dhe nxori një kuti të vogël me kapak të praruar. Kopshtari i bëri shenjë që ajo ta tundte kutinë përmbi fytyrën e bashkëshortit, ndërsa rifilloi lëvizjet e shpejta me thikën. Nën efektin e tingujve monotonë të dy dhëmbëve të *Kobrës* brenda kutisë në lëkundje dhe lëvizjeve të përshpejtuara të thikës së *Padres*, mbi fytyrën në agoni u shfaq hieja e një buzëqeshjeje, ndërsa sytë u fikën përgjithmonë.

XXXIV

TJETËR PASOJË E DORËSHKRIMIT TË TRADHTUAR

« *Urrejtja e njerëzve me karakter të dobët nuk është aq e rrezikshme sa miqësia e tyre*. »

Vovënarg

Ishte ora një e mëngjesit të 21 dhjetorit 1991. Një natë e ftohtë e me erë në Tiranë. Dy vetura dhe një furgon blu i errët ndaluan para portës së një kopshti pemësh të larta, të rrethuar me kangjella. Përveç pesë pishave dhe tre ekualiptëve, pemët e tjera ishin të zhveshura. Në mes të kopshtit, një shtëpi dykatëshe.

Porta e hekurt u hap me zhurmë. Tetë persona përshkruan kopshtin në heshtje të lotë. Njëri mbante një kazëm në dorë; një tjetër, lopatë. Një person i tretë mbante një çantë shpine dhe një vare. Shoferët e veturave dhe të furgonit qëndruan në timon. Ata do të luanin njëkohësisht rolin e rojeve.

Ata të tetë, që përshkuan kopshtin, u grupuan në hyrje të shtëpisë. Mandej hapën derën, ndezën dritat dhe u futën brenda. Pesë prej tyre qëndruan në korridor. Tre u futën në një dhomë të katit të parë dhe hapën projektin e shtëpisë mbi tavolinë. Mbasi e shikoi atë me vëmendje, njëri prej tyre bëri një shenjë të kuqe me stilolaps e u tha dy të tjerëve:

— Këtu duhet të ndodhet.

— Të shikojmë, arkitekt…, – u përtyp shefi i ekspeditës me mosbesim. – Na pri për tek vendi.

Meqenëse linja elektrike e bodrumit ishte prishur, ata vendosën të zbrisnin me një prozhektor dore. Bodrumi, me sipërfaqe 16 m² sipas projektit, ishte i mbushur plot me karrige të thyera, arka të prishura e dru të shkurtuara për sobë.

— Ç’do të thotë kjo? pyeti i habitur shefi i ekspeditës së natës.

— Asgjë për tu habitur, – u përgjigj arkitekti. – E kanë mbushur kastile bodrumin me këto sende të kota, për të fshehur atë që gjendet poshtë. Bile kjo është diçka premtuese lidhur me qëllimin e ardhjes sonë.

Pastaj duke u drejtuar pesë punëtorëve, ai u tha:

— Bodrumin duhet ta boshatisni krejt dhe ta pastroni. Kur ta keni përfunduar këtë punë, ejani njëri lart të na lajmëroni.

Ata të tre shkuan e u ulën përsëri tek tavolina e katit të parë, ku ndezën cigare. Pas një heshtjeje të përgjithshme disaminutshe, shefi i ekspeditës foli nëpër dhëmbë :

— Ta kenë varrosur vërtet në këtë bodrum ?

Kuptohej që këtë pyetje ai nuk ua kishte drejtuar vetëm dy të tjerëve, por edhe vetes së tij.

— Sipas përshkrimit në dorëshkrim, kufoma gjendet me siguri në këtë bodrum, gjersa është kjo shtëpia që ka shërbyer si bazë e grupit të tradhëtarëve

të DSJsë atëherë. Sipas projektit, nuk ka bodrum tjetër, – e siguroi arkitekti.

— Të shohim…, tha përsëri shefi gjithmonë i dyshimtë.

Pas njëzet minutash, njëri prej punëtorëve erdhi e i lajmëroi :

— Bodrumi është i lirë.

— Faleminderit, po vijmë, – iu përgjigj shefi.

Pastaj duke iu drejtuar arkitektit, i tha:

— Ec poshtë të organizosh punën. Ne të dy do të qëndrojmë këtu, se edhe hapësira është e kufizuar në bodrum e nuk vijmë dot vërdallë të gjithë atje.

Arkitekti zbriti në bodrum dhe filloi të vëzhgonte shtresën e çimentos. Ajo dukej e njëtrajtshme. Asnjë shenjë nuk linte të kuptohej se mund të kishte qenë prishur ndonjë pjesë e dyshemesë.

— Fillo godite me vare shtresën e çimentos, duke filluar nga dera e bodrumit, – e urdhëroi arkitekti një djalosh që mbante varenë në dorë. – Goditjet do t’i japësh ngadalë, të veçuara mirë nga njëra tjetra.

Djaloshi filloi goditjet sipas udhëzimit. Jehona e zhurmës ishte e njëjtë. Kështu vazhdoi deri në treçerek të bodrumit, kur arkitekti thirri papritur :

— Stop !

Ai u mbush me frymë i lehtësuar. Pastaj e mori vetë varenë. Pas një seri goditjesh intuitive, arkitekti saktësoi vendin ku punëtorët duhej të fillonin të thyenin shtresën e çimentos të bodrumit.

*

Kur punëtorët kishin thyer 1 m² të dyshemesë prej çimentoje, arkitekti urdhëroi që ta pastronin vendin. Ai bëri atje një kontroll me anë të një aparati.

«Po, këtu ndodhet», tha me vete. Pastaj orientoi punëtorët:

— Thyerjen e shtresës së çimentos do ta bëni sipas katërkëndshit që do t’ju skicoj unë. Pastaj do ta pastroni të gjithë vendin prej copave të thyera.

Arkitekti vizatoi me shkumës një katërkëndësh me sipërfaqe rreth 2 m².

Pasi e gjithë kjo sipërfaqe e shtresës së çimentos u thye e u pastrua, arkitekti dha orientimet e mëtejshme:

— Tani do të filloni gërmimin me kazëm. Materialin që krijohet, do ta pastroni mirë me lopatë.

Punëtorët hoqën normalisht katër shtresa dheu të gërmuara me kazën nën vëzhgimin e arkitektit. Kur filluan të pastronin shtresën e pestë, lopata ngeci në një send të fortë.

— Stop! urdhëroi përsëri arkitekti.

Pasi e kontrolloi me vëmendje sendin e fortë ku ngeci lopata, arkitekti dha udhëzime të tjera:

— Tani bëni kujdes! Nuk do të përdorni më kazëm e lopatë, por vetëm mistri. As nuk do të shkelni më direkt në tokë brenda gropës, por mbi një copë dërrase.

Mandej, duke nxjerrë nga çanta një thes najloni, ai ua dha punëtorëve, duke i porositur:

— Çdo eshtër që që do të gjeni do ta çoni këtu.

Një *oh!* u shpëtoi nga goja punëtorëve, të cilët shikuan arkitektin të habitur.

— Nuk ka asgjë të jashtëzakonshme në këtë mes, mos u habisni, – u tha arkitekti. – Fenomeni vdekje nuk është i panjohur për ju. Ne po punojmë për të zhvarrosur skeletin e një njeriu: kjo është e gjitha.

Toni i të folurit të arkitektit imponoi heshtjen e të pranishmëve. Vetëm atëherë e kuptuan punëtorët se njeriu përballë tyre ishte më tepër se një arkitekt…

Pozicioni anormal i skeletit, që po zbulohej gradualisht, i habiti punëtorët. Eshtrat e gjymtyrëve, të trupit e të kafkës po shfaqeshin në pamje të kundërt. Kufoma kishte qenë varrosur përmbys. Ky fakt ua shtoi stresin punëtorëve; një arsye më tepër për të ruajtur heshtjen.

Arkitekti i udhëzoi:

— E pastroni mirë me furça skeletin në atë pozicion që ndodhet, se duhet ta fotografoj, para se të filloni t'i fusni eshtrat në thes.

Gjysmë ore më vonë të gjitha eshtrat ishin në thesin e najlonit. Arkitekti u ngjit në katin e parë.

— Gjithçka është gati, – i tha ai shefit.

— Faleminderit. Futeni thesin në arkivolin e vogël që ndodhet tek dera e shtëpisë. Atje do t'ju gjejmë ne.

*

Frynte erë e fortë e përzier me pika të mëdha shiu, kur ata u nisën nëpër kopsht me hap të përshpejtuar. Arkivolin e vogël të mbështjellë me flamurin anglez e futën në furgon. Në çastin që po mbyllnin derën e kopshtit një degë ekualipti, e thyer prej erës së fortë, u përplas me zhurmë pas xhamit të pasmë të furgonit, duke e copëtuar. Kërcitja e një dege tjetër peme në kopsht i vuri në gjendje alarmi zhvarrosësit klandestinë. Pa e pastruar flamurin e arkivolit prej copave të xhamit të rëna mbi të, ata u nisën me nxitim për udhë.

— Drejt Rinasit ! e urdhëroi shefi i ekspeditës shoferin e veturës së parë, ku kishte zënë vend.

Fishkëllima e erës së fuqishme nëpër degët e pemëve të kopshtit të braktisur rrëmbimthi dhe pikat e mëdha të shiut ngjanin si vajtim i gropës së hapur, të privuar prej pengut të luftës së ftohtë, i cili kishte fjetur shtatë vjet e gjysmë në gjirin e saj.

XXXV

JEHONË E NJË DASHURIE

« *Duhet një tension i madh forcash shpirtërore për të rrëmbyer atë që dashuria e fiton duke luajtur*. »
H. Holst

— **C**iao, Rosanna, come stai ?

E habitur, ajo ndaloi dhe fiksoi sytë mbi të panjohurin, që po i fliste me ton konfidencial. Asnjë tregues i portretit të tij nuk i sillte diçka ndërmend.

— Ciao ! u përgjigj ajo e menduar, pas një çasti hezitimi. – Më falni, zotëri, por unë nuk ju njoh, – shtoi duke u skuqur lehtë në fytyrë.

I sigurtë në vetvete, ai buzëqeshi. Nxori një fotografi nga xhepi dhe ia zgjati Rozanës:

— Po këta të dy i njihni, zonjë? e pyeti.

Atë fotografi ata e kishin bërë dikur bashkë në plazh.

— Ah, po… Ti je, Artan?

— «Sa argëtohem, kur shtrihem mbi ty dhe të numëroj qimet e mustaqeve, duke të tërhequr fort ndonjërën !»

Nuk kishte provë më bindëse për Rozanën lidhur me identitetin e personit përballë saj. Dikur asaj i ishte bërë zakon që, kur ishin në plazh, të shtrihej mbi trupin e bukur të detektivit Meli, të cilin ajo e njihte me emrin Artan. E shtrirë mbi të dashurin, Rozana i numëronte qimet e mustaqeve, duke i tërhequr me të qeshur ndonjërën prej tyre. Kur *Artani* ankohej për këtë, Rozana justifikohej me shprehjen e mësipërme.

Të mallëngjyer, ata u përqafuan nxehtësisht.

Për herë të parë ata ishin njohur në Milano, në vitin 1975. Atëherë ai ishte 26 vjeç, ajo 22. Megjithëse kishin qenë të dy të martuar, ishin dashuruar marrëzisht me njëri–tjetrin, *si asnjëherë më parë* – e pohonin të dy. Rozana shquhej për bukurinë dhe elegancën e saj, ndërsa për *Artanin* thoshte se «e ka bërë Zoti sipas shijeve të mia».

Bashkëshorti i Rozanës ishte kapiten i dytë në një anije tregtare. Dashuria e madhe për nusen e bukur dhe largësitë e deteve, që e ndanin shpesh me të, e kishin bërë xheloz.

— Sikur ai ta marrë vesh që unë shkoj me ty, do të më vriste si një barbar, – i thoshte Rozana duke qeshur dashnorit.

Ajo punonte si administratore e një salloni bukurie në Milano – pronë e të shoqit. Mirësjellja dhe takti i komunikimit të Rozanës e kishin rritur ndjeshëm klientelën e sallonit që drejtonte. Punonjëset ajo i trajtonte si shoqet e saj dhe ndiente kënaqësi të punonte edhe vetë përkrah tyre. Mirëkuptimi me to ia lehtësonte marrëdhëniet intime me *Artanin.* Rozana ishte e sigurtë në besnikërinë e vartëseve të saj, të cilat ia njihnin dashnorin.

I magjepsur nga bukuria, freskia dhe eleganca e së dashurës, *Artani* rrokullisej me të në rërë, duke i folur me pasion :

— Ti je engjëll, Rozana. Gjynah që nuk merr pjesë në konkursin *Miss Italia*.

— Jam fejuar qysh në moshën 17 vjeçe. Të fejuarin e kisha xheloz dhe nuk ishte dakord që unë të merrja pjesë në konkurs, megjithëse më ishin bërë oferta të përsëritura.

— Çfarë shanci për mua ! Po të ishe shpallur *Miss*, do ta shijonin shumë sy magjinë e trupit tënd. Tani ai më përket vetëm mua, gjersa yt shoq rreh detet.

Dhe ata deheshin me dashurinë e tyre…

*

Skenat e paharruara të dashurisë në vitet e rinisë u ringjallën në shpirtin e Rozanës atë pasdite maji të vitit 1993, kur po përqafohej me *Artanin*, pas shumë vitesh.

— Më ke munguar gjatë, Artan; përse kështu? i pëshpëriti ajo tek veshi, pa u shkëputur nga krahët e tij.

Ai e kuptoi se Rozana po përlotej. U mallëngjye, por edhe u shqetësua nga humbja e papritur e vetëkontrollit prej së dashurës.

— Qetësohu, Rozana ! Nuk na lejohet të bëjmë sot një gabim, që nuk e kemi bërë në rininë tonë. Ndonjë e papritur e pakëndshme mund të të rrezikojë marrëdhëniet familjare.

— Unë nuk kam më familje, – u përgjigj ajo gjithmonë në krahët e tij. – Një aksident automobilistik i kushtoi jetën tim shoqi para katër vjetësh. Vajza që pata me të më vdiq vjet nga leuçamia. Jeta ime tani i ngjan një varke të humbur në thellësi të detit, të cilën e shtyjnë dallgët nga mundin. Ndofta takimi ynë i papritur ia kthen sadopak gëzimin.

— Patjetër, dashuria ime, – i premtoi ai i prekur prej fjalëve të saj.

Meli e kishte parë gjithmonë entuziaste këtë krijesë të bukur dhe trishtimi i saj e lëndoi në shpirt. Atë çast ai provoi një shije të re hidhërimi prej shkrehjes së jetës njerëzore.

— Kurajë, Rozana! i murmurit duke e ledhatuar. – Duhet të përpiqemi të përfitojmë diçka nga jeta, edhe kur ajo s’na buzëqesh. Përndryshe ekzistenca jonë e humbet kuptimin. Qyshkur jemi ndarë bashkë, goditjet e fatit ndaj meje kanë qenë edhe më të pamëshirshme nga të tuat. As unë nuk kam më familje dhe, mbi të gjitha, nuk mund të bëhem dot më baba. Në rast se vazhdoj të bëj ende hije mbi tokë, kjo ka ndodhur falë guximit tim për të dyluftuar me fatin. Unë nuk e kam vlerësuar kurrë si dhuratë jetën, por si një detyrë, si një luftë. Unë gjej kënaqësinë time në këtë luftë, duke iu kundërvënë pasojave të disfatës, kur fitorja më kthen krahët. Në qoftë se jeta nuk do të ishte e tillë, ajo do të bëhej e mërzitshme.

Një puthje e nxehtë si dikur qe prova se ata kishin nevojë për njëri–tjetrin.

XXXVII

PRANVERË E DY JETËVE

“*Në art dhe në dashuri mjafton vetëm instikti*.”

A. Frans

Kthimi i *Artanit* pati efektin e një flladi ripërtëritës për ndjenjat e tulatura të Rozanës. Qysh natën e parë ata kujtuan takimet e tyre të fillimit dhe çastet e paharruara të dashurisë së hershme. Argëtimi i saj, duke numëruar qimet e mustaqeve të të dashurit, u ktheu humorin të dyve.

— Të kujtohet numri i qimeve të mustaqeve të mia Roza? e pyeti ai buzagaz.

— Jo, por do filloj të t’i numëroj tani, – iu përgjigj ajo duke ia nisur punës.

Të dy u shkrehën së qeshuri. E qeshura e Rozanës ishte kompensimi më i madh shpirtëror i të dashurit të saj. Gëzimi i të jetuarit, pas goditjeve të fatit, është justifikimi më i mirë i shpresës.

Të nesërmen Rozana shkoi tek salloni i bukurisë pak më herët nga orari i hapjes. Habia e punonjëseve kur erdhën qe e dyfishtë: administratorja ishte paraqitur e para në punë dhe, mbi të gjitha, ajo ishte me një burrë.

— Kush do ta njohë këtë person, do të ketë një dhuratë nga ana ime, – u premtoi Rozana vartëseve të saj.

Ato tashmë e kishin marrë dhuratën e parë të gjitha: kthimin e buzëqeshjes së Rozanës. Ndoshta ky fakt e ndihmoi më moshataren e tyre të zbulonte identintetin e të panjohurit.

— Unë mendoj se ky është ai djaloshi simpatik, për të cilin ti ndërprisje punën kur ishe nuse e re, – hamendësoi ajo.

— E fitove bastin, – i tha Rozana duke qeshur. – Përveç dhuratës, ti ke të drejtën edhe të një dite pushimi suplementar.

— Dhuratën do e pranoj me kënaqësi. Ditën e pushimit, jo. Ne shyqyr që të pamë të qeshur, pas kaq kohësh. Sot do punojmë me gëzim bashkë.

— Unë deri në orën dhjetë do punoj, – i tha Rozana. – Mandej do shkoj në plazh me Artanin.

XXXVII

PËRSËRI SI DIKUR…

“*Dashuri, o marrëzi e ëmbël* !”
Shamfor

Të etur për të shijuar sërish dashurinë e tyre të ripërtërirë, Rozana e *Artani* silleshin si dy fëmijë në plazh. Ata godisnin njëri-tjetrin me rërë të lagur, me stërkala uji, shtyheshin, qeshnin e thërrisnin. Këto ishin britmat e dashurisë së tyre të plagosur.

Artani bënte sikur donte ta mbyste, duke i zhytur kokën në ujë. Ajo rezistonte dhe përpiqej të çlirohej prej kthetrave të tij. Kur nxirte kokën mbi ujë, mezi arrinte të mbushej me frymë prej të qeshurës së saj të marrë. Me gjysma fjalësh i thoshte :

— Oh, ç’kënaqësi ! Edhe vdekja do të më dukej shumë e ëmbël prej duarve të tua, Artan !

— Tani eja të hakmerresh për shkak të brutalitetit im, – i thoshte ai e shkonte e shtrihej me shpinë mbi rërë.

Rozana shtrihej mbi trupin e njomur të të dashurit dhe fillonte t’i numëronte me zë të lartë qimet e mustaqeve.

— Po ti mbrëmë në darkë i numërove, Roza, ç’bën kështu ? « ankohej » ai.

— Po sikur ti të kesh prerë gabimisht ndonjë qime tjetër sot gjatë rrojës ? Përgjigjem unë për inventarin e tyre, – insistonte Rozana.

Pastaj ajo i tërhiqte ndonjë qime kastile, ai ia bënte *ej*! Dhe të dy shkriheshin së qeshuri.

— Duhet të shkojmë tek salloni tani, se vajti ora katër dhe punëtoret duhet ta lënë punën, apo jo? i thoshte *Artani*.

— Oh, kur shkoi ore katër! ankohej ajo. – Kur isha vetëm, sa të gjata më dukeshin ditët! Pse rrjedh kaq shpejt moj kohë e lumturisë! psherëtinte Rozana.

— Ritmin e kohës nuk e ndryshojmë dot, ndërsa atë të dashurisë, po. Le ta shtrëngojmë njëri-tjetrin në krahë, duke mbajtur frymën! Kush do mbushet me frymë i pari, e do më pak tjetrin.

— Ky është një kurth, – protestonte Rozana. – Ti je burrë dhe e mban më gjatë frymën nga unë.

— Mirë, atëherë po të fal njëzet sekonda.

— Unë po të fal reston e jetës!

Rozana i ngjiste buzët pas të tijave dhe ata rrokulliseshin në rërë, duke mbajtur frymën derisa arrinin tek uji.

XXXVIII

ARTANI NË DILEMË

"*Në jetë duhet të dish t'i bësh mirë*
llogaritë, por jo në kurriz të të tjerëve."
P.–L. Tulé

— **P**ushimet verore të vitit 1989 unë e im shoq kishim vendosur t'i kalonim në Havana, në Kubë, – i tha një ditë Rozana *Artanit*. – Fatkeqësisht, ai u aksidentua në prill të atij viti. Sipas përshtypjeve të burrit tim, i cili kishte bredhur botën, Havana është një qytet ideal për pushime. Shkojmë bashkë sivjet atje?

Në rrethana të tjera, një propozim i tillë do të kishte qenë joshës për Melin. Por me dokumentet e tij false nuk ishte i sigurtë, nëse mund të arrinte deri në Kubë pa probleme. Si mund t'i përgjigjej Rozanës, që nuk kishte dyshuar kurrë në sinqeritetin e *Artanit* të saj të dashur? Edhe sa herë mund ta mashtronte ai në të ardhmen? A e meritonin ndjenjat e saj të çiltra hipokrizinë e tij?

Nga mënyra si kishte rrjedhur jeta e ish–detektivit të talentuar, ai kishte provuar dhe përballuar vështirësi të mëdha, përfshirë edhe plumbin. Por asnjëherë nuk e kishte ndier veten aq ngushtë sa përballë syve të qeshur të Rozanës, që priste përgjigjen e tij. Nën ndikimin e jetës së burgut, karakteri i Melit kishte ndryshuar shumë: njeriu kishte arritur ta eklipsonte detektivin.

*

Fillimet e dashurisë së tij me Rozanën nisnin në periudhën, kur instruktorët me përvojë të gjatë të DSJsë i stërvisnin detektivët për t'i trajtuar femrat thjesht si objekte dëfrimi, pa rënë në magjinë e dashurisë së tyre. Ky proces tjetërsimi djallëzor njihej në DSJ me emrin rrëqethës *ngurtësim i shpirtit* dhe fillonte qysh në vitin e tretë të shkollës speciale të shërbimit sekret.

Me qëllim që instruktorët të ndiqnin nga afër në praktikë rezultatet makabre të *ngurtësimit të shirtit*, DSJ kishte krijuar marrëdhënie binjakëzimi ndërmjet shkollës së saj dhe liceut artistik *Jordan Misja* në Tiranë, ku nuk mungonin vajzat e bukura. Falë buxhetit të saj të pasur, DSJ bënte investime të konsiderueshme për kohën në dobi të liceut artistik. Në shenjë mirënjohjeje, klasa të veçanta të liceut organizonin me radhë mbrëmje vallëzimi me detektivët e ardhshëm, për të cilët nuk dihej asgjë konkrete nga ana e tyre.

Ndërkohë u rekomandohej këtyre djemve të zgjedhur, që të krijonin marrëdhënie intime me liceistet e bukura, duke i joshur edhe me dhurata të çmuara, të paguara nga fondi i shkollës. Të ndihmuar prej informatorëve të posaçëm, instruktorët ndiqnin me kujdes ecurinë e këtyre marrëdhënieve. Kur konstatonin se midis një studenti të shkollës së shërbimit sekret dhe një liceisteje ishin vendosur marrëdhënie dashurore, ata i linin që të lulëzonte ca idili i tyre

dhe mandej nisnin procesin *ngurtësimi i shpirtit.*

Atëherë instruktorët e urdhëronin studentin të linte takim me vajzën në vendin dhe orën që i rekomandonin ata. Gjatë takimit të tyre, studenti duhej të sajonte një shkak për tu grindur me mikeshën e tij, ta rrihte atë dhe të ndahej përfundimisht prej saj. Instruktorët, të fshehur me kujdes para kohe tek vendi ku do të zhvillohej seanca e fundit e dashurisë së flijuar, filmonin e regjistronin gjithçka ndodhte.

*

Meli ruante një kujtim të paharruar të provimit të tij të parë në kuadër të operacionit *ngurtësimi i shpirtit*. Kjo i kishte ndodhur me një liceiste me flokë të dëndur të zes e trup të derdhur. Ishte një pianiste e talentuar. Për kënaqësinë e të dashurit, ajo interpretonte me pasion pjesë të njohura. Duke konstatuar se interpretimi i saj e impresiononte djaloshin, brunia pikante fluturonte prej gëzimit. Por në prapaskenë po përgatitej vrasja e gëzimit të saj.

Megjithëse dy të rinjtë dashuroheshin qysh prej tre muajsh, Meli ishte përpjekur shumë që t'i ruante sekrete marrëdhëniet e tyre. Më kot. Një ditë instruktorët e thirrën papritur dhe i caktuan vendin dhe orën kur duhej ta linte takimin me të dashurën. Ai vetë duhej të paraqitej tek vendi i takimit një çerek ore para se të vinte vajza. Njëri prej instruktorëve i dha porositë e fundit. Ai i kishte rekomanduar edhe mënyrën sesi duhej të qëndronte Meli gjatë zhvillimit të takimit, me qëllim që kamera e fshehtë të filmonte sa më mirë. Duke konstatuar emocionet që po provonte studenti në prag të takimit, instruktori i kishte bërë një vërejtje të rëndësishme: ruajtja e gjakftohtësisë ishte faktori bazë i suksesit të provimit.

Meli nuk kishte dashur të vinte kurrë ora e atij takimi, por…

E buzëqeshur, veshur me një fustan të kuq, brunia u shfaq në periferi të liqenit artificial të Tiranës. Ajo mbante dy trëndafila në duar. Pas dy javësh ajo do të festonte 17-vjetorin e ditëlindjes. Natyrisht, i dashuri nuk do t'ia jepte dot më dhuratën që i kishte blerë me këtë rast.

Ndërsa vajza po afrohej, Meli, i turbulluar, e kuptoi se ai nuk do t'i respektonte dot udhëzimet që i ishin dhënë. Pa i përfillur pasojat, ai vendosi të hiqte dorë prej skenarit të parapërgatitur prej instruktorëve të DSJsë.

Ndërsa brunia e buzëqeshur e përshëndeti, duke i zgjatur njërin prej trëndafilave, ai e goditi tek kyçi i dorës. Trëndafili u rrëzua përdhé. Pa i lënë kohë që të mendohej, ai e goditi vajzën me grusht në bark. Ndërsa ajo u shemb përdhe, Meli u largua me të shpejtë, duke e lënë ish-të dashurën në mëshirë të kamerës së fshehtë.

Ky veprim i kushtoi shtrenjtë Melit. Për dy javë iu ndalua të largohej prej territorit të shkollës, mbasi gjesti i tij do të gjykohej *gjetkë*. Më së fundi veprimi i pahijshëm iu fal me kusht: ai nënshkroi një deklaratë, sipas së cilës do ta kalonte me sukses në të ardhmen e afërt provimin *ngurtësimi i shpirtit*.

Edhe bashkëshortja e Melit pati rastin t'i shijonte frutet e hidhura të operacionit çnjerëzor. Detektivi kënaqej duke i shkaktuar brenga bashkëshortes.

«Kurrë nuk ia kam bërë ndonjëherë qejfin, megjithëse Florika më donte e më respektonte», do t'i thoshte një rast në Qafë-Bar Meli Diksit, dhe do të vazhdonte: «Kur ajo më thoshte "je bërë për të rruar, Hamit", unë nuk e prekja me dorë briskun edhe për dy ditë të tjera. Në qoftë se Florika më propozonte të bënim një vizitë tek prindërit e saj, unë as nuk u telefonoja atyre një javë rresht. Po të më thoshte "ky kostum të shkon mirë", unë e vishja sa më rrallë atë. Çfarë deformimi shpirtëror që na kanë bërë me të përbindshmin *ngurtësim shpirtëror*! Do të mjaftonte vetëm ky akt i shëmtuar i tyre që ne, ish-detektivët e shërbimit sekret shqiptar, t'i vlerësojmë tri shkronjat DSJ si trekëmbëshi ku është varur bota jonë shpirtërore.»

XXXIX

RRËFIM…

“*Për mendimin tim, është njeri më i madh ai që di të pohojë gabimin e tij, se ai që di të mos gabojë*. »

P. dë Gondí

Ish-detektivi u indinjua duke kaluar ndërmend pasojat e operacionit *ngurtësimi i shpirtit*. Në cepat e buzëve iu shfaq hieja e një buzëqeshjeje të hidhur. I atillë do të mbetej përherë? Papritur e pushtoi një dëshirë e zjarrtë për t’i provuar vetes ringjalljen shpirtërore, pas vuajtjeve të burgut dhe veprimtarisë antidiktatoriale përkrah ish-kolegëve të tij të profesionit.

Meli e përqendroi shikimin mbi të dashurën, e cila priste përgjigje për propozimin që kishte bërë:

— Roza, ne jemi njohur së bashku në vitet e rinisë. Shumë gjëra kanë ndryshuar qysh nga ajo kohë. Sot unë nuk disponoj dokumente të rregullta për të qarkulluar lirisht nëpër botë.

— S’po të kuptoj, Artan, – buzëqeshi ajo.

— Ke të drejtë. Për cilindo do të ishte e vështirë ta kuptonte botën së prapthi prej nga vij unë. Kur jemi njohur bashkë, unë isha në shërbim të një diktature të egër, e cila më furnizonte me gjithçka më duhej për të bredhur botën. Kjo ishte e domosdoshme, për ushtrimin e profesionit tim të dikurshëm. Disa muaj pas takimit tonë të fundit, mua më arrestuan dhe më burgosën për një kohë të gjatë. Prandaj nuk jemi parë bashkë për gjithë këta vjet.

«Rënia e komunizmit në Evropën Lindore, përfshirë edhe Shqipërinë, më ndihmoi të lirohesha nga burgu. Por liria që fitova ishte fiktive, e pamaterializuar. Aktualisht unë jam një kundërshtar politik i ish-komunistëve, që trashëguan pushtetin prej idolëve të tyre, në saje të një manovre djallëzore të miratuar nga Perëndimi. Në këto rrethana, unë u detyrova ta braktisja vendin tim me dokumente false. Por nuk dëshiroj kurrsesi që ti të vazhdosh të bashkëjetosh me një të panjohur. Prandaj po të vë në dijeni se mua nuk më quajnë Artan.

Sa e habitur edhe e mallëngjyer, Rozana i kishte dëgjuar me shumë vëmendje fjalët e Melit. Kur ky bëri një pauzë të shkurtër, ajo e pyeti e buzëqeshur:

— Cili është emri yt i vërtetë, pëllumbi im?

— Hamit Meli. Dhe profesioni im nuk ka qenë inxhinier elektronik, siç më njeh ti, por detektiv i shërbimit sekret, e dashur Roza.

— Mua më ka tërhequr gjithmonë letërsia policore, – tha duke qeshur ajo. – Këtë mund ta kesh vënë re edhe tek biblioteka ime. Prandaj pohimi yt nuk është një fakt që më shqetëson. Unë të pata dashuruar si njeri; as si inxhinier elektronik, as si detektiv. Dhe as që më interesonte fare kjo punë. Aq më tepër që ti nuk më ke sjellë ndonjë shqetësim, për shkak të profesionit që ushtroje atëherë. Fakti që sot po ma prezanton vetë të kaluarën tënde, ta shton vlerën në

sytë e mi. E ç’rëndësi ka nëse të quajnë Artan apo Hamit, gjersa këtë të vërtetë po ma pohon me gojën tënde ?

«Më vjen keq për vuajtjet e shumta që paske kaluar ; këtë e tregon edhe pamja jote fizike. Por ky interval kohe, që kemi jetuar larg njëri-tjetrit, ka qenë një periudhë vuajtjesh për të dy. Kushtet e reja të dashurisë sonë të lirë do të jenë ndoshta një kompensim për vuajtjet që kemi kaluar. Në qoftë se ti nuk do të ishe burgosur, jeta jote do të kishte rrjedhur ndryshe dhe ne nuk do të ishim takuar dot më. Nga ana tjetër, nëse unë nuk do të kisha mbetur e ve, nuk do të martoheshim dot bashkë. Pra, vuajtjet tona kanë qenë çmimi me të cilin kemi paguar bashkimin tonë të sotëm. Le të përpiqemi ta harrojmë të kaluarën e hidhur, për ta shijuar në paqe të ardhmen ! Problemi i dokumenteve është i zgjidhshëm. Pas martesës sonë zyrtare, ti do të pajisesh me dokumentet e nevojshme për të qarkulluar lirisht nëpër botë.

— Por sivjet ti do të privohesh nga pushimet në Havana…

— Do të ishte e dobët dashuria jonë, në qoftë se nuk do ta kompensonte dot Havanën për këtë verë.

Duke thënë këto fjalë, ajo e përfshiu në krahë të dashurin.

XL

CIA RISHIKON DOSJEN *MELI*

"*Karakteri është një forcë e natyrës;*
mungesa e karakterit edhe më tepër."
A. Çehov

Pas një diskutimi delikat, shefi i seksionit evropian të CIAs dhe tre kolegët e tij po qendronin në heshtje prej disa minutash. Në pamje të parë, problemi për të cilin po preokupoheshin dukej lehtësisht i zgjidhshëm. Por sa më tepër që ishte intensifikuar diskutimi i tyre, aq më shumë komplikohej problemi, në vend që të thjeshtohej. Të bllokuar prej disa pyetjesh, që ata i kishin shtruar vetë, të katër kishin ndier nevojën e një pushimi. Ata po pinin kafe në heshtje.

Shefi buzëqeshi, para se të merrte fjalën i pari :

— Në vitet e adoleshencës kam qenë pak llafazan. Gjyshja, që më donte shumë, më thoshte herë pas here:

«Aq sa e lehtë është të flasësh, aq e vështirë është të arsyetosh, nipçe. Të flasësh pa arsyetuar, do të thotë të punosh për të prishur.»

«Sa herë që ngec në zgjidhjen e një problemi, më kujtohen këto fjalë të gjyshes. Kur i fola Drejtorit të Përgjithshëm për çështjen *Meli*, ai ma preu shkurt : *Ju e njihni më mirë se unë Melin dhe çështjen e tij. Pikërisht ju duhet të vendosni edhe për trajtimin përfundimtar të dosjes së tij.*

«Një kombinim rrethanash të jashtëzakonshme po na ballafaqon me një çështje të thjeshtë në pamje e të komplikuar në përmbajtje. Pyetja e parë dhe më kryesore, së cilës ne duhet t'i japim përgjigje, është kjo : *një Meli i lirë, larg orbitës së CIAs, do të ishte më shumë apo më pak i dëmshëm për interesat tona se një Meli midis nesh* ?

Shefi i seksionit evropian të CIAs rrëshqiti shikimin nga një bashkëbisedues tek tjetri, duke u lënë atyre të kuptonin, se përgjigjen e pyetjes së shtruar e priste nga ata.

I pari u përgjigj më moshatari prej kolegëve të pranishëm :

— Unë mendoj se një Meli jashtë kontrollit tonë do të mbajë lidhje të rregullta me mikun e tij të burgut, i cili ka me siguri një kopje tjetër të dorëshkrimit, veç atij që përfundoi tek ne. Si rrjedhojë, Meli do të bashkëpunojë me atë për ta përkthyer dhe botuar jashtë Shqipërisë. Nga ana tjetër, një Meli i lirë do të ishte një provë e gjallë e ngjarjeve të librit në kontakt me medien e huaj. Kjo jo vetëm që do të siguronte botimin e dorëshkrimit, por edhe një publicitet efikas të tij. Kush na siguron ne se ata të dy nuk bashkëpunojnë edhe sot për këtë qëllim ?

— Në vend që t'i përgjigjeni pyetjes sime, ju shtuat edhe një pyetje tjetër, – i tha shefi duke buzëqeshur. – Për fat të mirë, Meli nuk është bashkë me shokun e tij të burgut. Ai vetë ndodhet në Itali, ndërsa tjetri, në Shqipëri.

— Kjo nuk do të thotë se ata nuk komunikojnë midis tyre, – insistoi

bashkëfolësi.

— Sigurisht. Duke pasur parasysh përvojën e tyre të bashkëpunimit në kushte të vështira në burg, ata bëjnë kujdes të komunikojnë jashtë çdo kontrolli të mundshëm. Prandaj ne nuk mund të jemi të sigurtë në këtë pikë, megjithë informacionet mohuese të agjentëve tanë.

— Në këto kushte ne do të jemi gjithmonë të paqartë për lidhjet e tyre të mundshme, ose për projektet e tyre të përbashkëta. Meli mund të shkojë në çdo çast në Shqipëri, gjithashtu edhe miku i tij mund të dalë jashtë shtetit. Lëvizjet dhe qëllimet e tyre mbeten të paparashikuara. Për mendimin tim, ndarja e tyre është domosdoshmëri.

— Po në qoftë se Meli refuzon përsëri të vijë në Amerikë ?

Meqenëse dy kolegët e tjerë nuk kishin folur fare deri në atë çast, shefi i seksionit evropian të CIAs, pasi bëri pyetjen e mësipërme, iu drejtua pikërisht atyre :

— Po ju, zotërinj, nuk do e thyeni heshtjen sot ?

— Heshtja është më e mirë se një këshillë e keqe, – u përgjigj njëri prej atyre. – Është e vështirë të zgjidhësh një problem me shumë të panjohura. Ne nuk dimë nëse Meli mban lidhje me mikun e tij, nëse ata kanë vërtet projekte të përbashkëta, nëse Meli do të pranonte të vinte në SHBA pas një oferte të re… Unë mendoj se do të ishte më e arsyehme të prisnim derisa të dispononim provat e nevojshme për këto paqartësi.

— Por koha nuk punon gjithmonë për ne, – vërejti shefi. – Edhe sikur sot Meli dhe bashkëpunëtori i tij të mos përpiqen për ta publikuar dorëshkrimin, nesër ata mund ta bëjnë këtë. Megjithatë unë mendoj se Meli, si profesionist i mirë, nuk do ta miratojë botimin e atyre ngjarjeve pa respektuar afatin 15-vjeçar të ruajtjes së sekretit. Nisur nga ky supozim, ata nuk do të jenë të nxituar ndoshta për përkthimin e dorëshkrimit. Por ne nuk mund të nxjerrim konkluzione e të ofrojmë zgjidhje mbështetur në hipoteza.

— Po sikur Meli t’i ketë dhënë fjalën mikut të tij për botiminn e dorëshkrimit sapo ta kenë përkthyer?

— Atëherë ky kapitull mbyllet përfundimisht dhe ne do të na duhej të merrnim masat përkatëse, për ta penguar patjetër botimin e dorëshkrimit, – deklaroi shefi i seksionit evropian të CIAs.

— Sidoqoftë, zgjidhja më e sigurtë mbetet ndarja përfundimtare e atyre të dyve. Duke qenë protagonist i ngjarjeve dhe njeri i sëmurë, Meli mund të shërbejë si nxitës për botimin e dorëshkrimit dhe si dëshmitar okular i ngjarjeve. Nga ana tjetër, ai mund të disponojë edhe prova dokumentare për vërtetësinë e atyre ngjarjeve, mbasi kryesorët e grupit komplotist kanë qenë detektivë me përvojë dhe mund të kenë ruajtur dokumente privatisht. Prandaj, për mendimin tim, jo vetëm që duhet t’i bëjmë doemos ofertë Melit për ta tërhequr, por të marrim të gjitha masat e mundshme për ta detyruar ta pranojë atë. Lipset ta zgjidhim shpejtë këtë nyjë, sa pa u bërë gordiane.

— Aleksandri i Madh na ka mësuar sesi zgjidhen edhe nyjet gordiane, - tha

duke buzëqeshur shefi. – Megjithatë arsyetimi juaj më duket bindës. Prania fizike e Melit është mbështetje dhe frymëzim për mikun e tij të burgut. Ndërsa pas botimit të dorëshkrimit, protagonisti i atyre ngjarjeve do të ishte shumë i kërkuar prej gjahtarëve të sekreteve. Prandaj jam dakord që ne t'i luajmë të gjitha kartat, me qëllim që Meli ta pranojë ofertën tonë të re.

— Përsa i përket autorësisë së ofertës, ka një zgjidhje që besoj se do ta miratoni, – vërejti bashkëfolësi. – Ne kemi mundësi që këtë herë t'ia bëjmë ofertën Melit nëpërmjet miqve të tij shqiptarë, anëtarë të grupit të tyre të dikurshëm. Ata mund t'ia paraqisnin ofertën tonë si një propozim të tyre të miratuar paraprakisht nga CIA. Kjo ka dy anë pozitive. Së pari, minimizohet mundësia e refuzimit të ofertës, për arsye se Meli, me një përgjigje negative, do të vinte në pozitë të vështirë shokët e tij në raport me CIAn, gjersa propozimi ka qenë i tyre. Së dyti, efekti fyes i refuzimit do të binte mbi sedrën e ish-shokëve të tij të armëve, të cilët do të jenë nismëtarët dhe lajmëtarët e ofertës.

— Grupi i tij i dikurshëm, ish-shokët e tij të armëve… Miqtë e mi, a nuk konstatoni në këto terma patetike një motiv nxitës për t'iu dhënë fund sa më parë lidhjeve të Melit me mikun e tij të burgut?

Një buzëqeshje miratimi i kolegëve pasoi pyetjen sugjestive të shefit.

XLI

ANKTHI I NJË TAKIMI

“Ne jetojmë në një shekull ku fshehja
e së vërtetës të mbron më mirë sesa ligji
dhe të siguron më shumë se pafajësia. »
Rivarol

Në orën dhjetë, Streto duhej të paraqitej në zyrën e madhe të shefit të seksionit evropian të CIAs. Megjithë përvojën e tij të gjatë në shërbimet sekrete, ai nuk ndihej i qetë si gjithmonë. Thirrje të tilla paralajmëronin vendimmarrje të rëndësishme. Gjatë vitit të parë me shërbim në radhët e CIAs, Streto kishte pasur mjaft kontakte me drejtues të shërbimeve sekrete amerikane. Dy herë, personalisht me Drejtorin e Përgjithshëm të CIAs.

Me kalimin e kohës, takime të tilla u rralluan. Kuadri më i rëndësishëm që ai kishte takuar gjatë tre vjetëve të fundit kishte qenë shefi i seksonit ballkanik të CIAs. Pas një heshtjeje të gjatë, kjo thirrje mbërriti papritur tek Streto më 12 shtator 1993.

«Çfardo natyre që të ketë, lajmi që do të mësoj atje do të jetë i rëndësishëm», mendoi Streto duke hyrë në ashensor.

Kjo ide iu përforcua kur gjeti tre persona në zyrën hijerëndë të shefit të seksionit evropian të CIAs. Ky vazhdonte të shfletonte ngadalë një dosje që kishte përpara. Kaluan disa minuta, para se shefi t’i shkëputste sytë prej dosjes e të merrte fjalën :

— Ne mendojmë t’i bëjmë edhe një herë thirrje Hamit Melit për të ardhur në SHBA. Ka kaluar mjaft kohë qysh kur e kam takuar për herë të fundit në kampin e punës në Shqipëri. Atëherë ai e refuzoi ofertën tonë, për të mos u ndarë me mikun e tij të burgosur. Mirëpo qysh prej dy vjetësh Meli jeton i lirë, jashtë Shqipërisë. Mendojmë se ai tani është qetësuar deridiku dhe mund të marrë një vendim më me përgjegjësi. Nga ana tjetër, ai tashmë ndihet i çliruar prej detyrimeve të dikurshme morale ndaj mikut të tij të burgut, mbasi ata nuk janë më bashkë. Meli jeton në Itali, ndërkohë që Diksi ndodhet në Shqipëri.

«Pavarësisht prej refuzimit të tij në vitin 1984, ne dëshirojmë ta ndihmojmë Melin, mbasi nuk e harrojmë kurrë kontributin e tij të çmuar në dobi të çështjes sonë të përbashkët. Gjendja e tij shëndetësore ka nevojë për një trajtim mjekësor special, gjë që ai nuk e siguron dot në pozitat e një refugjati të thjeshtë. Ju e njihni Melin prej një kohe të gjatë, prandaj opinioni juaj do të jetë i dobishëm për ne : si mendoni ju, a do ta pranonte ai një ofertë të re nga ana jonë ?

Megjithëse Streto ishte nisur për në këtë takim i bindur se bëhej fjalë për një surprizë, ai ndjeu t’i rrihte fort zemra pas pyetjes që i bëri shefi i seksonit evropian të CIAs. Ideja e bashkimit të mundshëm me shokun e tij të armëve e mallëngjeu. Ky lajm i mirë i kishte ardhur në një çast të përshtatshëm.

Qysh prej nëntë vjetësh Streto militonte në radhët e CIAs dhe gjendja e tij

shpirtërore kishte evoluar mjaft. Ai nuk ishte më 35 vjeçari energjik e plot optimizëm i fillimit të bashkëpunimit entuziast me amerikanët. Nuk kishte vonuar dhe besimi e optimizmi ia kishin lëshuar vendin dyshimit e pesimizmit. Pas një periudhe të gjatë veprimtarie në radhët e shërbimeve sekrete amerikane, Streto kujtonte me nostalgji grupin e tij të përbetuar për luftë deri në vdekje kundër diktaturës shqiptare. Një kujtim që e lëndonte.

Bashkëpunimi me CIAn kishte qenë një dështim i synimeve të tyre në planin kombëtar dhe privat. Ndërkohë karriera e vetë Stretos dhe e shokëve të tij ishte tkurrur së tepërmi. Në Shqipëri ai kishte qenë njëri prej personave më të pushtetshëm dhe e ardhmja e karrierës së tij politike kishte qenë e shkëlqyer, ndërkohë që diktatori nuk ishte më në gjendje për të mbajtur në duar frenat e pushtetit. Streto e kishte përbuzur atë pushtet antishqiptar. Mirëpo në radhët e CIAs ai dhe shokët e tij ishin kuadro modeste, të dyshimtë, të survejuar, që duhej të përballonin të panjohurën.

I deboluar prej pesimizmit, Streto mezi priste të kishte pranë një mik të sprovuar si Meli, për t'i hapur zemrën e mbufatur prej brengave. Kush, më shumë se Meli, do të ishte balsam i shpirtit të tij në atë periudhë depresioni? Ata të dy kishin qenë bashkryetarë të grupit komplotist të shpërndarë tashmë në radhët e CIAs e të vënë nën kontroll të rreptë prej saj. Streto e ndiente se dy zemra të lënduara prej së njëjtës brengë mund ta qetësojnë reciprokisht njëra-tjetrën.

*

Shefi i seksionit evropian të CIAs dhe kolegët e tij e kishin parashikuar efektin që do të bënte tek Streto diskutimi i papritur i këtij problemi. Duke e shikuar të menduar, ata synonin të dallonin ndonjë shenjë reaksioni emocional mbi fytyrën e tij. Dhe ashtu ndodhi. Një valë e brendshme gëzimi i ndriçoi fytyrën Stretos tek po imagjinonte bashkimin e mundshëm me shokun e tij të armëve në jetën e lirë. Megjithatë përgjigjja e tij nuk qe premtuese:

— Unë jam ndarë me Melin prej një kohe të gjatë. Ai ka vuajtur edhe shtatë vjet të tjerë në kampin e punës, pas ndarjse sonë. Ju e dini mirë që ai ishte mjaft i sëmurë dhe gjendja e tij shëndetësore ka të ngjarë të jetë përkeqësuar vitet e mëvonshëm të burgut. Natyrisht, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore të degraduar, edhe sistemi i tij nervor mbetet problematik. Për këtë arsye, unë nuk jam shumë optimist lidhur me reagimin e tij ndaj një oferte të re, për të ardhur në SHBA.

— Për mendimin tuaj, sa përqind shpresë duhet pasur për pranimin e ofertës nga ana e Melit ?

— Unë kam nëntë vjet pa e takuar atë dhe nuk jap dot një opinion të saktë lidhur me qëndrimin e tij. Sidoqoftë, mendoj se jeta në liri e ka qetësuar disi, megjithë peripecitë e njohura të jetës së një refugjati të rëndomtë.

— Jo, nuk është tamam ashtu. Aktualisht Meli bashkëjeton me një grua të

bukur italiane; sigurisht, ndonjë mikeshë e tij e vjetër. Ajo e do marrëzisht dhe ai po bën një jetë të qetë e në mirëqenie. Sipas informatorëve tanë, Meli gëzon një shëndet stabël; ai nuk ka shkuar asnjëherë tek mjeku kohët e fundit.

Një buzëqeshje e lehtë reflektoi në fytyrën e Stretos. Mirëqenia e mikut të tij besnik në Itali – vendi i adhuruar i Melit – dhe mundësia e bashkimit të tyre e inkurajoi.

— Ky është një faktor i favorshëm për pranimin e ofertës së re prej tij, – u shpreh Streto.

— Po dashuria e tij për italiankën? pyeti buzagaz shefi i seksionit evropian për CIAn. – A do të jetë i gatshëm Meli ta sakrifikojë dashurinë e tij për të pranuar ofertën tonë? Muajin e kaluar ata janë martuar zyrtarisht. Ndërkohë Meli ka paraqitur kërkesë në kuesturën e Milanos, për tu pajisur me dokumente qëndrimi të përhershëm në Itali.

— Ne, detektivët shqiptarë, kemi qenë të ushtruar mirë për të mos u bërë skllevër të dashurisë. Meli e ka divorcuar lehtësisht bashkëshorten e tij në Shqipëri, megjithëse kishte një fëmijë me të.

— Kjo do të thotë se Meli mund ta pranojë një ofertë të re sot për të ardhur në SHBA?

— Besoj se po.

— Nuk mendoni se motivi i refuzimit të ofertës sonë të parë – besnikëria ndaj mikut të tij të burgut – mund të jetë gjithmonë e pranishme në shpirtin e tij?

— Nuk besoj të jetë ashtu. Atëherë ata ishin dy bashkëvuajtës, dy shokë besnikë, dhe, më pas, dy bashkëpunëtorë të grupit tonë. Ata vuanin dhe luftonin së bashku. Në këto kushte Meli nuk mundej ta braktiste bashkëvuajtësin, që të fitonte për vete lirinë. Realiteti i sotëm është i ndryshëm. Aktualisht ata jetojnë të dy të lirë dhe larg prej njëri-tjetrit. Nëntë vjet pas atyre ngjarjeve, unë mendoj se Meli mund ta pranojë ofertën tuaj.

— Kjo do të jetë oferta *e juaj*, jo *e jona*. Ju personalisht do t'ia bëni këtë propozim Melit në emër të të gjithë anëtarëve të ish-grupit tuaj, të cilët militojnë sot me sukses në radhët e CIAs. Ne mendojmë që t'ia japim edhe një herë dorën Melit, por jeni ju që duhet t'ia paraqisni kërkesën dhe të insistoni që ai të bashkohet me grupin, që drejtuat së bashku me sukses. Ju do të zgjidhni vetë njërin prej shokëve tuaj të këtushëm, me të cilin do të shkoni të takoni Melin në Itali. Detektivi ynë, që e çliruat nga robëria nëpërmjet arratisjes, do t'ju shoqërojë. Shpresojmë se ai mund t'ju ndihmojë, mbasi është i gatshëm që t'i lutet Melit për të ardhur me ju në SHBA. Pas një jave do të niseni për kryerjen e këtij misioni.

XLII

MARTESA E DYTË PËR TË DY

« *Martesa është si shartimi : mund të zërë, mund të mos zërë.* »
V. Hygo

E bukur si gjithmonë, Rozana e veshur me fustanin e bardhë i buzëqeshte Melit e kënaqur. Ajo ngjante dhjetë vjet më e re. Të gjitha punonjëset e sallonit të saj të bukurisë ishin okupuar me flokët e Rozanës, që i jepnin një pamje të freskët fytyrës së saj.

Melit i ra në sy bukuria e ripërtërirë e dashnores që po bëhej nusja e tij. Kostumi blu i errët e vinte më tepër në dukje pamjen serioze të fytyrës brune të ish-detektivit. Meli gjithashtu i buzëqeshi Rozanës, duke i shtrënguar duart në dorashkat e bardha të kostumit simbolik. Atij nuk i pëlqente ceremonia fetare, por Rozana kishte këmbëngulur në këtë pikë :

— Unë e kam trdhtuar të ndjerin burrin tim të parë dhe dua që Zoti të ma falë mëkatin, duke u martuar në kishë me dashnorin tim.

Megjithëse ish-detektivi kishte pasur një mori marrëdhëniesh dashurore në të kaluarën, ai e donte shumë Rozanën dhe bënte kujdes të mos ia lëndonte ndjenjat. Në emër të dashurisë, Meli kishte pranuar t'i nënshtrohej ceremonisë fetare. Për çudinë e tij, jo vetëm që kjo ceremoni e shkurtër nuk po e bezdiste, por po i dukej interesante. Me instiktin e gruas së dashuruar, Rozana e diktoi kënaqësinë që po ndiente i dashuri dhe kjo ia shumëfishoi gëzimin. Ky ishte një ogur i mirë për jetën e ardhshme bashkëshortore.

*

Muaji i mjaltit në Sardenjë qe dehës për çiftin e ri. Ishin ditët e para të një gushti të nxehtë. Uji i pastër i detit kufizonte nxehtësinë e kohës, por jo afshin e dashurisë së tyre. Ata formonin një çift që nuk do të kishte fëmijë. Mungesa e të ardhmes afatgjatë të bashkimit të tyre i nxiste të jetonin me intensitet të tanishmen. Vetëm çasti kishte kuptim për ta.

Ata dëshironin të kishnin jetëgjatësi të barabartë, me qëllim që asnjëri prej tyre të mos mbetej vetëm. Pleqëria e secilit prej tyre, në mungesë të tjetrit, do të ishte një udhëtim i mundimshëm në ftohtësinë e vetmisë drejt një fundi të trishtuar. Por pleqëria ishte ende larg dhe ata nuk donin ta çonin mendjen atje. Donin të përqëndroheshin në shijimin e së sotmes.

Ditën e kalonin në plazh. Meli e linte Rozanën në gjumë dhe shkonte në buzë të detit, për të përfituar prej rrezeve të para të diellit. Ai lahej vetëm në ujin e freskët të detit deri në orën nëntë. Mandej shkonte të zgjuante Rozën, e cila flinte pjesërisht zbuluar. Nën efektin e pamjes së saj provokuese, ai e mësynte. Ajo ankohej duke qeshur dhe ëmbëlsisht merrte pjesë në gostinë mëngjesore…

Pastaj bënin dush dhe hanin mëngjesin. Më pas Rozana donte të flinte pak nën rrezet e diellit. Pjesa tjetër e ditës ishte shumë aktive për ta. Arsenali i lojërave fëminore në rërë dhe në ujë pasurohej përditë.

Pas tri javësh, ata e braktisën buzëvarur Sardenjën.

XLIII

JETA E ÇIFTIT TË RI

« *Burri pa gruan dhe gruaja pa burrin* janë qenie të pakompletura në rendin *natyror*. »

B. dë Sen-Pier

Para se të niseshin për në Sardenjë, Rozana ia kishte lënë çelësat e shtëpisë punonjëses që drejtonte aktivitetin e sallonit të bukurisë në mungesë të saj. Me porosi të Rozanës, kolegia ishte interesuar që shtëpia të lyhej jashtë e brenda dhe të ndërroheshin mobiliet e dhomës së gjumit, si edhe pajisjet e kuzhinës. Kangjellat, që rrethonin kopshtin, ishin lyer me bojë jeshile, ndërsa pjesa e poshtëme e trungut të pemëve me gëlqere. Ishin ndërruar gjithashtu dy stolat ndanë të shatërvanit të vogël.

Kur u kthyen në shtëpi, çifti i ri e gjeti ambientin të rinovuar. Fotografi të zmadhuara të Rozanës dhe të Melit ishin vendosur në sallon dhe në dhomë të gjumit, ndërkohë që ato të burrit të parë të Rozanës nuk i kishin lëvizur prej vendit. Një dhuratë e bukur me një buqetë lulesh të freskëta në dhomë të gjumit simbolizonte dëshirën e punonjëseve të sallonit të bukurisë, për të ardhmen e çiftit të ri.

Të lodhur prej udhëtimit, Rozana e Meli nuk dolën në qytet ditën e kthimit në Milano. Pasi bënë dush, ata fjetën dy orë. Në mbrëmje shëtitën gjatë në kopsht. Herë llafazanë e herë të heshtur, ata nuk i shpëtuan dot jehonës së kujtimeve të të kaluarës së largët. As njëri e as tjetri nuk e kishte parashikuar një kurorëzim të tillë të marrëdhënieve të kahershme dashurore. Me legalizimin e martesës, aventura e tyre dashurore nuk ekzistonte më. Mosha dhe vuajtjet e justifikonin këtë fazë të re të dashurisë së tyre.

Të nesërmen ata shkuan bashkë tek salloni i bukurisë. Punonjëset e gëzuara i pritën për herë të parë si bashkëshortë. Sapo Rozana e Meli zbritën nga vetura, buzëqeshja e tyre u pasua nga një duartrokitje frenetike e punonjëseve, që u rreshtuan para hyrjes. Ato u takuan si pjesëtarë familjeje me çiftin e ri.

XLIV

ADIO, ROZA !

“*Mënyra më e thellë për të ndier diçka*
është të vuash për të.”
G. Flober

I hipur në një shkallë metalike, Meli po merrej me instalimin e një prozhektori në kopsht. Rozana po e ndiqte me sy, e ulur në një karrige kashte para derës së shtëpisë. I gufonte zemra prej gëzimit duke konstatuar se bashkëshorti e konsideronte veten si zot shtëpie. Ky fakt shënonte fundin e vetmisë torturuese për të.

Për një çast shkalla lëvizi prej vendit. Meli, me duart e zgjatura lart, e humbi ekuilibrin dhe u detyrua të kërcente në tokë. Rozana lëshoi një britmë frike dhe vrapoi atje.

— U plagose, i dashur ? e pyeti e shqetësuar.

— Jo, qetësohu, Roza! S’jam aq i brishtë, sa mendon ti.

Duke qeshur, ai e puthi në ballë.

— E di që ti nuk je aq i brishtë, por fati im, po. Edhe në çastet më të lumtura të jetës sime, nuk kam arritur dot të çlirohem nga një lloj ankthi që më pushton padashje, një trishtim i pashpjegueshëm lidhur me të ardhmen. Optimizmi më ka munguar gjithmonë. Edhe një nuancë e zbehtë fatkeqësie bën të më kalojnë mornica në trup.

— Ato brenga i përkasin së shkuarës. Tani duhet të jesh më optimiste, Roza. Bashkimi ynë duhet të kthehet në një burim lumturie për ty ; përndryshe ai mbetet pa vlerë. Mërgoi një herë e përgjithmonë mendimet e zymta.

— Nuk arrij dot… ; trishtimi është pjesë përbërëse e shpirtit tim. Mbrëmë pashë një ëndërr të keqe, prandaj u tremba shumë, kur ti re nga shkalla.

— Çfarë ëndrre paske parë ?

— Do ta dish vërtet ?

— Pse jo ? Është turp të trembesh nga një ëndërr.

— Pashë në ëndërr të ndjerin burrin tim dhe ty. Ai po nisej si gjithmonë për lundrim. Duke qendruar në këmbë tek kiçi i anijes që po shkëputej nga moli, ai po më salutonte me kapele. Unë po përkundja në erë një rrobë të bardhë. Deti ishte shumë i trazuar. Valët e fuqishme ia vështirësonin anijes avancimin në det. Pas një çerek ore, ajo nuk ishte shkëputur më shumë se njëqind metra nga moli. Im shoq dhe unë vazhdonim të përshëndeteshim së largu. Papritur një dallgë e madhe e përpiu anijen. Ndërsa deti po egërsohej gjithmonë e më shumë, anija nuk po dukej më. Unë shpërtheva në të qara. Atë çast m’u shfaqe ti duke m’u lutur : «Mos qaj, Roza, se ti nuk je vetëm në këtë botë. Sot e tutje do të jetojmë së bashku përgjithmonë.»

«Pastaj ne morëm një taksi bashkë. Duke udhëtuar për në shtëpi, ti vazhdoje të më flisje, për të më qetësuar. Mirëpo kur taksia ndaloi përpara portës, ti ishe

zhdukur. E mbetur përsëri vetëm, qava me lotë të nxehtë.

— Mos e le veten peng të ëndrrave, Roza. Për fat të mirë unë ja ku jam, pranë teje, në mes të kopshtit tonë të bukur ; nuk jam zhdukur si në ëndërr.

— Në mes të kopshtit tonë të bukur… Veç këto fjalë dua të dëgjoj.

Ajo u lëshua në krahët e hapur të bashkëshortit.

*

Më 21 shtator 1993 Rozana kishte shkuar në zyrën e taksave. Në sallonin e bukurisë puna ishte ndërprerë, mbasi lokali po lyhej. Rozana dhe Meli kishin vendosur t'ia ndryshonin ngjyrat sallonit. Meli vigjëlonte që nuancat e bojërave të zgjedhura të dilnin sa më të realizuara. Ai mbeti i kënaqur prej fillimit të punës dhe i porositi bojaxhinjtë që të respektonin rigorozisht ato nuanca ngjyrash.

Për të kaluar kohën, Meli filloi të pastronte pasqyrat e sallonit të bukurisë. Një punë që ai e bënte me qejf.

— Lereni për në fund pastrimin e pasqyrave, kur të kemi mbaruar punë ne, – e këshilloi njëri prej bojaxhinjve.

— Nuk mërzitem t'i pastroj përsëri, edhe mbasi të keni mbaruar punë ju, – iu përgjigj Meli me të qeshur.

Ai ishte duke pastruar pasqyrën e dytë, kur papritmas atje iu shfaqën tiparet e një fytyre shumë të njohur; buzëqeshja e Stretos e la pa frymë.

— Ti Guri je vërtet, apo një fantazmë? e pyeti duke u kthyer me vrull.

— Përpiqu ta verifikosh; kjo nuk është e vështirë për një detektiv, – u përgjigj Streto duke e shtrënguar në krahë.

Mandej ai i prezantoi dy shoqëruesit:

— Ky është detektivi amerikan, ish-rob i DSJsë, ndërsa ky tjetri është njëri prej dy anëtarëve të grupit tonë, që u arratis bashkë me të.

Të buzëqeshur, ata të dy u takuan përzemërsisht me Melin.

Streto mori përsëri fjalën:

— Hamit, duhet të flasim sa më parë bashkë. Meqenëse nusja jote mund të vijë nga një çast në tjetrin, duhet të largohemi prej këtej.

— Si, e ditke që qenkam i martuar ?!

— Di edhe më tepër se kaq, veç duhet të largohemi.

— Dua të takoj gruan njëherë ; pastaj ajo do rrijë këtu, unë do të vij për të biseduar.

— Gruan nuk do ta takosh më, Hamit…

— Si?

— E dëgjove tamam. Do të nisemi bashkë për në SHBA.

— Nuk dua të dëgjoj të flitet më për këtë çështje, Guri.

— Shohim e bëjmë, por eja të largohemi prej këtej. Do të ishte marrëzi të na gjente nusja jote këtu.

Streto me dy shoqëruesit dolën jashtë. Meli u bashkua me ta tek vetura me

targë të ambasadës amerikane.

Rruga nuk qe e gjatë. Pas një çerek ore ata ndodheshin në një restorant luksoz. Mbasi bënë porositë, Streto u fut në temë:

— E di që ti je zoti "Jo", Hamit, por këtë herë çështja është më e komplikuar nga ç'mund ta imagjinosh. Ti ke krijuar tashmë një familje të re dhe ke nevojë të bësh një jetë të qetë, pas vuajtjeve prej ferri të burgut. Por fati të ka privuar nga e drejta për të zgjedhur në këtë rast.

— Fati më ka braktisur prej një kohe të gjatë; ti e di mirë këtë, Guri. Por aktualisht unë ndihem shumë i lodhur. Qetësia nuk është luks, por domosdoshmëri për jetën time. Zhgënjimet e njëpasnjëshme më kanë acaruar shumë dhe unë nuk dua më të dëgjoj të flitet për profesionin tim të dikurshëm dhe pasojat e tij. Harresa e së shkuarës është kushti bazë për pjesën e mbetur të jetës sime. Për të qenë i sinqertë, po ta pohoj se nuk dua të diskutoj më për këto çështje, as me ty Guri.

— Unë gjithashtu, miku im. Si dëshmitar okular i vuajtjeve të tua, unë nuk do të pranoja kurrë të të shqetësoja me një propozim të tillë, sikur kjo të mos ishte domosdoshmëri për të ardhmen e shokëve tanë të armëve, që gjenden në SHBA.

— Ata jetojnë atje prej gati një dekade dhe e ardhmja e tyre nuk varet aspak nga e imja. Honi i harresës e përpiu veprimtarinë tonë antidiktatoriale në Shqipëri.

— Përkundrazi : autoritetet e CIAs e vlerësojnë domosdoshmëri sot prezencën tënde atje. Herën e parë ti e refuzove ofertën e tyre, për të mos braktisur Sazanin. Ata ta kanë falur atë, mbasi motivi ishte i qëndrueshëm. Por kuniukturat e tanishme nuk e justifikojnë dot më një refuzim të dytë nga ana jote.

— Qëndrimi im i atëhershën nuk kishte asgjë të qortueshme. Një njeri që do të braktiste aq lehtë mikun besnik të burgut, nuk do ta kishte fare problem të tradhtonte cilindo për hir të egoizmit. Një mesazh besnikërie nuk mund të përbuzet, apo të ndëshkohet.

— Pikërisht për këtë arsye CIA ruan konsideratë të lartë për ty. Dëshmi për këtë është oferta që po të bëjnë pas kaq vjetësh. Në qoftë se ata do ta kishin gjykuar si tendencioz refuzimin tënd të qershorit 1984, nuk do të ta bënin kurrë propozimin e sotëm. Duhet të mendohesh mirë, para se t'i përgjigjesh ofertës së re. Ti nuk je më si dikur, Hamit. Unë e ti përgjigjemi për të ardhmen e secilit prej anëtarëve të ish-grupit tonë, mbasi jemi ne që i futëm ata në këtë qerthull. Dhe duhet ta ndajmë fatin me ta deri në fund. Mundohu të marrësh një vendim të denjë për emrin tënd. Sot nuk je më në burg, por i lirë.

— I lirë…, por i martuar.

— Martesa është një e drejtë, Hamit, jo një detyrë.

— Një e drejtë që kthehet në detyrë, sapo realizohet.

— Të kuptoj. Por të gjitha detyrat nuk janë të barasvlefshme, miku im. Në qoftë se nusja jote do të humbasë lumturinë pas ndarjes së papritur me ty, bashkëluftëtarët tanë në SHBA do të humbasin çdo shpresë për çështjen

shqiptare; ndoshta edhe më tepër se kaq… Boshllëku që krijon mungesa jote na rëndon të gjithëve dhe na i nxin horizontin. Mendoj se duhet ta ndajmë bashkë fatin, siç e nisëm.

Me dhëmbë të shtrënguar prej sikletit, Meli nxori bllokun e shënimeve dhe diçka shkroi në një fletë.

— Para se të nisemi, më duhet të lë këtë letër, – murmuriti ai.

— Ku ?

— Të shohim.

Vetura ndiqte itinerarin që diktonte Meli. Ata ndaluan para shtëpisë së Rozanës dhe… Melit. Ky pa veturën e së shoqes të parkuar pranë trotuarit. U afrua me kujdes dhe e ngeci fletën tek xhami i përparmë në drejtim të timonit, me shkrimin nga brenda.

— Më fal, Roza ! psherëtiu dhe shikimi iu mjegullua.

Ai hyri në veturë dyllë i verdhë në fytyrë.

Një heshtje varri sundoi deri në aeroport.

XLV

DIKSI DHE LIBRI I TIJ

« *Kush i jep kohës, jep dy herë*.”
I. Krilov

Ëndrra e çdo të burgosuri është rikthimi në jetën e lirë. Kjo ndodh edhe kur liria e një vendi është e cunguar apo inekzistente, si në Shqipërinë diktatoriale. Ndryshimi është i pranueshëm e i nevojshëm, edhe kur është i parëndësishëm. Aq më tepër kur bëhet fjalë për jetën e vështirë e monotone të një të burgosuri. Gjithsesi një palë tela me gjemba në largësi, si kloni, ishin më të pranueshëm se tre rrethimet e larta përpara syve në kampin e Spaçit apo të Qafë-Barit. Brigadierët dhe përgjuesit e *jetës së lirë* ishin më pak asgjësues se brigadierët, policët dhe spiunët e kampeve të punës. Dhe vdekja në *jetën e lirë* ishte pak më njerëzore, se ajo në burgjet dhe kampet e punës të diktaturës.

Kalimi nga e keqja më e madhe tek një më e vogël është lehtësim. Sidomos për jetën e një populli të mësuar të shikojë vetëm prapa, duke e ngushëlluar veten me shprehjen: *ka edhe më keq*. Po më mirë, a ka? Një pyetje e tillë është e huaj për turmat me mentalitet skllavi; ajo është moto e popujve që e njohin lirinë dhe kanë qenë gjithmonë të gatshëm ta paguajnë çmimin e saj.

*

Si çdo i burgosur, edhe Sazan Diksi e kishte pritur me ankth ditën e lirimit. Por ankthi i tij ndryshonte cilësisht nga ai i bashkëvuajtësve të tjerë. Më shumë se gjithçka, Diksin e tërhiqte jashtë telave me gjemba kryerja e misionit që i ishte besuar: përgatitja e dorëshkrimit. Në qoftë se ai nuk arrinte të dilte prej burgut, ato ngjarje do të varroseshin, ashtu siç kishte ndodhur me protagonistë të veçantë të tyre.

Gjithë pjesëmarrësit e tjerë të grupit komplotist ishin profesionistë, që kishin nënshkruar deklaratë për ruajtjen e sekretit profesional në të gjitha rrethanat. Ata nuk mund të shkruanin kurrsesi rreth atyre ngjarjeve. Vetëm në raste të veçanta kuadro të shërbimit sekret autorizohen për të shkruar kujtimet e tyre, me ndonjë objektiv të caktuar. Por kjo nuk ndodh kurrë me kuadro të huaja, të asimiluara qëllimisht në radhët e një shërbimi sekret të fuqishëm, për të shuar jehonën e keqe të flijimeve politike.

Ishte për këtë arsye që Meli u entuziazmua kur lexoi dorëshkrimin në Athinë më 1991 dhe iu shpreh optimist Diksit:

«Ka mundësi që njohja jonë të ketë qenë një predestinim nga Zoti, me qëllim që aktiviteti i grupit tonë të mos humbiste si sëpata pa bisht në arkivat e CIAs»

Afati 15 vjeçar prej datës së ngjarjeve të dorëshkrimit po afronte; ai përkonte me vitin e fundit të shekullit XX. Ky afat kushtëzonte kohën e botimit të librit. Ndonëse dorëshkrimi ishte i gatshëm edhe në një gjuhë të huaj, për herë të parë

libri duhej të botohej domosdoshmërisht në gjuhën shqipe, mbasi ngjarjet që përbënin subjektin e tij ishin shqiptare dhe lidheshin me të kaluarën dhe të ardhmen e Shqipërisë. Edhe protagonistët e tyre ishin kryesisht shqiptarë.

Ngjarjet e dhunshme të viteve 1997–'98 e bënë të pamundur çdo tentativë botimi në Shqipëri. Në këto kushte, Diksi u detyrua ta shtypte jashtë atdheut librin në gjuhën shqipe. Me ndihmën e një njeriu të besuar, ai shtypi njëmijë kopje në Romë.

Ndërkohë që Diksi me familjen e tij ndodhej jashtë atdheut, persona të tjerë u interesuan posaçërisht për shpërndarjen e librit me ngjarje të jetuara, në janar të vitit 2000.

XLVI

ARMIQTË DHE MIQTË E LIBRIT

"*Librat që një pushtet abuziv i quan amoralë janë ata që tregojnë poshtërsitë e tij*."

O. Vild

E vetmja diktaturë e Evropës Lindore, e cila i caktoi detyrë vetes (me rekomandim të tutorëve të saj) të shkatërronte popullin e vet deri në maksimumin e mundshëm, ishte ajo shqiptare. Një njeri cinik me horizont kulturor të kufizuar (me gjithë fatin e mbarë, ai nuk arriti dot kurrë të kishte një diplomë në jetë) u zgjodh dhe u vendos në krye të një populli të çoroditur, i cili ka luftuar gjithmonë për mbijetesë, por nuk ka mundur asnjëherë të jetojë në mënyrë të denjë. Një popull me gjakun e të cilit kanë abuzuar gjithmonë ata që ka pasur mbi krye, por që ai vetë nuk ka ditur ta derdhë ndonjëherë për të mirën e tij gjakun e vet.

Diktatura komuniste – si autokracia më e zhveshur moralisht që ka njohur njerëzimi – u gjet mjeti më efikas për shpërbërjen si popull të shqiptarëve prej arkitektëve të politikës globale, që drejtojnë botën si në një film vizatimor. Kjo do të shërbente si *colpo di grazia* për të ardhmen e një populli, që nuk pati kurrë të ardhme për të qenë.

U pushkatua pa gjyq, apo nëpërmjet farsash gjyqësore skandaloze, elita intelektuale e kombit, e cila do të kishte qenë shumë e dobishme dhe e mirëpritur në çdo vend të përparuar të botës. U asgjësuan në burgun e Burrelit qindra intelektualë të shquar, trupat e të cilëve, të varrosur qëllimisht cekët, u bënë ushqim për derrat e komandës së burgut. Turmave injorante e të droguara ideologjikisht u bëhej thirrje t'i godisnin me bajga, apo të urinonin mbi trupat e intelektualëve të shquar, që prezumoheshin si armiq të komunizmit e pushkatoheshin, pa kryer asnjë faj. U ideua dhe u aplikua me rigorozitet farkëtimi i *njeriut të ri* – këtij bufoni moral që luftonte e përbuzte si *vlera borgjeze* dinjitetin dhe personalitetin e tij e të familjes.

Fabrika ideologjike e partisë prodhoi me shumicë pseudointelektualë të depersonalizuar deri në shëmti, që do të lartësonin gërmadhën diskredituese të mjeranit *realizëm socialist*, tek i cili realizmi ishte elementi më i dënueshëm. Për dekada të tëra kollarexhinj eunukë të diplomuar, të cilët do të investoheshin pa kursim prej partisë për ta bërë të zezën të bardhë, do të vargëzonin e shkruanin për diktaturën e proletariatit *si demokracia më e kulluar në botë*, do t'i këndonin mjerimit ekstrem të jetës socialiste si apogjeu i lumturisë e do të *diskreditonin* imperializmin (ashikun e idolit të tyre), që i digjej toka nën këmbë… Sa më lavire të ishte pena e autorit të realizmit socialist, aq më e pakursyer tregohej partia ndaj tij.

Emrat më të dëgjuar të merhumit *realizëm socialist* ishin edhe mëkatarët më

të mëdhenj, të cilëve partia u dha bujarisht dorën, për t'i ngjitur deri pranë kupolës së pushtetit diktatorial.

Ndonjë disident i heshtur (të shpallurit asgjësoheshin qysh në vezë), si *Bilbili i Liqenit* – Lasgush Poradeci – detyrohej të jetonte si eremit, por nuk pranonte të bëhej bilbil kafazi i realizmit socialist. Po aq dramatike rrodhi jeta e prozatorit të shquar, Kuteli. Fat të përafërt do të kishte edhe patrioti Petro Marko, të cilin diktatura e shikonte gjithmonë vëngër, duke i burgosur edhe të birin.

Me ardhjen e *demokracisë* neokomuniste të komanduar prej sekretarëve të PPsë e ideologëve të saj, autorët servilë politikë të realizmit socialist u shpallën *disidentë të kamufluar* (?!) [O tempora, o mores!], ndërsa Fishta, Kuteli, Harapi, Camaj, apo Lasgushi, emrat e të cilëve partia mëmë i kishte vendosur në rreth të kuq, mbetën *persona non grata* për bijat e saj dhe *yjet e karvanit* të realizmit socialist, të cilët i trembeshin ballafaqimit moral e letrar me ata krijues e atdhetarë të shquar. Natyrisht, atje ku gëlon vesi, nuk ka vend për virtytin.

*

Në këto ujëra të trubullta lundronte pseudodemokracia shqiptare pas gjakderdhjes ende të pagjykuar të viteve 1997-'98, kur në janar të vitit 2000 u shpërnda libri *Odiseja e një detektivi* (vëllimi i parë) në Tiranë.

Në një vend ku ndjenja kombëtare nuk është në agoni dhe inteligjencia nuk i ka kartona false diplomat e titujt butaforikë *docent, akademik, doktor, profesor-doktor etj*. [ç'tituj të bujshëm!] shfrytëzohet çdo mundësi e hapësirë për t'i dhënë frymëmarrje së vërtetës në të mirë të kombit, të popullit e të historisë së tij. Një libër me emër, biografi e fotografi autori, me ngjarje të jetuara e personazhe realë, të prezantuar me të dhëna identiteti e poste shërbimi të sakta që kishin vepruar në një qytet të vogël si Tirana, ku familjet me zë njheshin nga e gjithë lagjja e më gjerë në kohën e diktaturës, u anashkalua prej intelektualëve dështakë, që nuk kanë pasur kurrë kurajë ta shikojnë të vërtetën në sy. Këta kalemxhinj servilë të partisë e të Sigurimit – gjellë e përvjellur e kazanit të ideologjisë së kuqe – janë moralisht të lëngshëm dhe marrin gjithmonë formën e koniukturave politike të ditës. E vërteta e atij libri u djeg sytë këtyre alergjikëve të së vërtetës. Natyrisht, pasqyra është objekti më i urryer për atë që është i ndërgjegjshëm, se ka fytyrë të shëmtuar.

«E vërteta nuk pranon shërbëtorë të pabesë», ka shkruar Hygoi. Në këtë këndvështrim intelektualët dështakë shqiptarë i bënë nder atij libri me heshtjen e tyre.

Pikërisht këta kollarexhinj eunukë, që për dekada me radhë ngritën në qiell idolin e tyre pervers e gjakatar dhe *demaskuan* (e kush se!) kapitalizmin e imperializmin, po të njëjtët emra e fytyra të neveritshme, si pa gjë të keq, filluan të bënin të kundërtën në demokracinë ala-puniste. Veç me një ndryshim në tone. Ndërsa gjatë dekadave të diktaturës, ata ishin ngjirrur duke i thurur ditirambe diktatorit e duke mallëkuar imperializmin, tani ngjirreshin duke i bërë hosana

imperializmit – si kështjella e pamposhtur e demokracisë botërore (*ai që i digjej toka nën këmbë*!) – dhe shanin nganjëherë nën zë edhe idolin, i cili mbetet i patjetërsueshëm në ndërgjegjen e tyre. Ashtu siç mbeti edhe në legjislacionin e pseudodemokracisë, sipas të cilit diktatori Hoxha edhe sot gëzon titujt *Hero i Popullit* dhe *Hero i Punës Socialiste*.

Në qoftë se këta intelektualë eunukë e perversë do të kishin pasur qoftë edhe një fije dinjiteti, ata nuk duhej të pranonin të bënin kinse antikomunistin, gjersa kishin flirtuar aq gjatë e aq ndyrë me enverizmin dhe Sigurimin e tij. Por *njerëzit e rinj* të partisë e kanë humbur prej kohësh nocionin e nderit dhe të turpit. Dinjitetin dhe personalitetin ata i quajnë *dukuri primitive*, që e pengojnë njeriun-robot të bëjë karrierë në moçalin politik shqiptar, apo të përfitojë tërthorazi prej tij.

*

Sipas njoftimeve që i vinin Diksit prej bashkëpunëtorëve të tij, pjesa e pamolepsur e inteligjencies shqiptare (mjerisht, minorancë), qytetarë të devotshëm e studentët interesoheshin mjaft për librin *Odiseja e një detektivi*. Këtë e tregonte shumëfishimi i tij me fotokopjim. Kur Diksi në vitin 2003 donte të botonte një libër tjetër në Tiranë, botuesi me të cilin komunikoi për herë të parë i tha : «Se mos më dërgosh atë librin që vazhdon të fotokopjohet…» Ky fakt dëshmonte se Shqipërisë nuk i kanë munguar e nuk i mungojnë shtetasit që i duan të mirën dhe preokupohen për të mjekuar plagët e saj të shumta, por, mjerisht, në krye të vendit janë perversët. Një shërbim të madh moral i bëjnë sot klasës politike antishqiptare çibanët e djeshëm të realizmit socialist që, për interesa të ulëta egoiste, vazhdojnë të injektojnë vrer në venat e Shqipërisë së rraskapitur, ashtu siç vepruan për dekada të tëra në diktaturë.

*

Në fillim të vitit 2000 Diksi dërgoi disa kopje të librit *Odiseja e një detektivi* në SHBA. Dy copë ia nisi *Seksionit Shqip* të *VOA*. Të tjerat ua dërgoi miqve të tij, protagonistë të ngjarjeve të librit, në adresën e mëposhtme :

DARI MELI
3609 BROADWAY, Apt. 4L,
NEW YORK, N.Y. 10031
U. S. A.
Tel. 00 12 12 – 491 – 12 12

XLVII

DY VARRE QË AKUZOJNË

"*Njerëzit e mëdhenj e bëjnë vetë piedestalin; e ardhmja u ngre statujën.*"

V. Hygo

Ndryshe nga ç'priste, Diksi ndeshi në një indiferencë të qëllimshme të autoriteteve belge për njohjen e të drejtës së azilit politik. Atij nuk i refuzohej dot kjo e drejtë, për shkak të provave të pakundërshtueshme që kishte paraqitur për motivimin e strehimit politik, prandaj u zgjodh varianti i zvarritjes së qëllimshme administrative lidhur me përgjigjen përfundimtare.

Natyrisht, kjo nuk ishte thjesht dëshirë belge, por rekomandim i dikujt tjetër, për të arritur në një zgjidhje me marrëveshje verbale, pa dosje azilanti. Mosbindja e Diksit në këtë pikë të rëndësishme i bezdiste të dy palët. Por, gjithsesi, autoritetet belge ishin të detyruara të respektonin legjislacionin përkatës.

Personi i ngarkuar për trajtimin e dosjes së Diksit jo rrallë ndihej më në siklet sesa vetë azilkërkuesi. Ai ishte kuadri i dytë i *Komisariatit të Refugjatëve* që trajtonte atë dosje, mbasi i pari dha dorëheqjen. Intelektual i hollë dhe profesionist i përgatitur mirë, ai bënte çmos ta bindte Diksin se zgjidhja me marrëveshje ishte më e përshtatshmja, mbasi e drejta ekziston, por fuqia e saj zbehet në rrethana të caktuara. Ai habitej sinqerisht nga insistimi i Diksit për zgjidhje pa kompromis të kërkesës së azilit.

Belgët njihen në nivel evropian si mjeshtra të kompromisit. Madjé në BE qarkullon një thënie e tillë: *Ku ka mosmarrëveshje, të thirret një belg për të ofruar zgjidhje* [natyrisht, me përjashtim të pseudopolitikanëve shqiptarë që preferojnë moszgjidhjen, për të peshkuar në ujë të turbullt si gjithmonë]. Vetë ekzistenca e Belgjikës është një vazhdimësi kompromisesh midis dy komuniteteve kryesorë që përbëjnë popullsinë e saj. Ndonëse belgët mbajnë rekordin botëror të kohëzgjatjes për krijimin e një qeverie të re pas zgjedhjeve, normaliteti i jetës së përditshme ka qenë përherë shembullor, falë institucioneve të konsoliduara dhe edukatës së lartë qytetare.

I brumosur me një mentalitet të tillë konstruktiv, personi që shqyrtonte çështjen e Diksit habitej me këmbënguljen e këtij për të refuzuar një kompromis që belgu vetë e cilësonte *chouette* (më se i mirë). Jo rrallë, ai kishte theksuar se *kompromis do të thotë lëshime reciproke*.

Ishte hera e pestë dhe e fundit që ai po e thërriste Diksin gjatë shtatë vjetësh, për të mbyllur shqyrtimin e një dosjeje që shumëkujt nuk i interesonte të ekzistonte. Si specialist i mirëfilltë dhe person inteligjent, ai e kishte kuptuar mirë përmbajtjen e dosjes dhe kishte nxjerrë konkuzionet përkatëse si profesionist dhe si njeri. Në realitet ai kishte arritur të njihej mirë me Diksin,

ngandonjëherë edhe më në thellësi nga sa i kërkonte vendi i punës. Kjo ndodhte kur merrnin kafe jashtë zyrës, ku zhvillohej intervista pa përkthyes, por brenda pallatit të xhamtë, apo duke zbritur me ashensor për ta shoqëruar të intervistuarin deri tek porta, sipas rregullit. Ai ia kishte bërë të qartë Diksit, se nuk vendoste dot vetë mbi dosjen e tij, ndryshe nga ç'ndodhte me shqyrtimin e dosjeve të tjera. Si zvarritja e stërzgjatur edhe kthimi i përgjigjes, nuk ishin kompetencë e mirëfilltë e tij.

Mirëpo ditën e fundit që do të ndaheshin, siç dukej ishte vënë më së fundi pika mbi "i". Ai manifestonte një humor dukshëm më të mirë se herët e tjera dhe i la të kuptonte Diksit, se gjithçka ishte mbyllur. Veçse kishte dëshirë të sqaronte diçka që ai mendonte se nuk kishte arritur ta kuptonte mirë. Thjesht për kureshtje, jo në kuadrin profesional. Duke pirë kafe bashkë (kafeja e fundit midis tyre), i tha :

— Ka të ngjarë që njohja me dosjen tuaj të mbetet një nga kujtimet e rrallë të profesionit tim. Sa herë që do të shqyrtoj në të ardhmen këkesa për azil të paraqitura prej shtetasve shqiptarë, do të më kujtoheni ju. Por kam diçka të paqartë në qëndrimin tuaj. Megjithëse ju e kuptoni që nuk ndikoni dot në zhvillimin e ngjarjeve politike në Shqipëri, përsëri refuzuat një zgjidhje të kërkesës së azilit shumë më të favorshme, sesa një përgjigje pozitive nga ana jonë. Si e justifikoni këtë në ndërgjegjen tuaj, ndërkohë që keni vuajtur shumë në jetë dhe jeni një person i moshuar me fëmijë të vegjël në vend të huaj ?

Diksi buzëqeshi prej gjuhës dashamirëse me të cilën po i fliste bashkëbiseduesi dhe iu përgjigj :

— Midis provave shkresore që ju kam paraqitur për të vërtetuar ngjarjet e librit tim, kanë qenë dhe identitetet e dy kuadrove të shërbimit sekret shqiptar, të vrarë gjatë atyre ngjarjeve dhe të varrosur në Tiranë. Besoj se ju kujtohet.

— Më kujtohen mirë edhe emrat e tyre : Fatmir Merdari e Afrim Pahia.

— Pikërisht. Ata e dhanë jetën në moshë të re, në luftë kundër diktaturës agjenturore shqiptare. Unë ju kam shtruar qysh në fillim, në mënyrë të përsëritur, këtë kërkesë : të zhvarrosen ata dy trima dhe të bëhet egzaminimi i skeleteve. Në qoftë se nuk do të rezulutojë se Fatmiri është goditur në afërsi me dy plumba nga pas krahëve, ndërsa Afrimi ka gjetur vdekjen si pasojë e një frakture të rëndë pas përplasjes së kokës kundër murit në tentativë vetëvrasjeje, unë pranoj që ju të mos i merrni në konsideratë provat e tjera dokumentare për vëtetësinë e ngjarjeve të librit dhe ta refuzoni kërkesën time për azil politik. Por në rast se do të vërtetohet e kundërta, ju duhet të nxirni konkluzionet e duhura, duke mbajtur parasysh këtë fakt sa të rëndësishëm aq edhe domethënës : kur kanë ndodhur këto dy ngjarje tragjike (prill-maj 1984) unë isha një i burgosur politik qysh prej vitit 1978 dhe kisha për të vuajtur edhe disa vjet burg akoma. Vërtetimet përkatëse i keni në dosje. Atëherë natyrshëm lind pyetja : në qoftë se ngjarjet e librit tim nuk do të ishin të vërteta, nga e mësova unë datën dhe mënyrën e vdekjes së këtyre kuadrove të DSJsë, ndërkohë që ndodhesha në burg e punoja me tre turne në minierë prej disa vitesh ? Ju siguroj se as familjet e

atyre trimave nuk dinë gjë nga e vërteta e vdekjes së njerëzve të tyre, mbasi diktatura, megjithëse i vrau vetë, i varrosi me ceremoni solemne dhe i dekoroi si *të rënë në krye të detyrës*, për të mbuluar të vërtetën. Unë ju kam kërkuar gjithashtu që, para egzaminimit, skeleteve t'iu bëhet analiza e ADNsë në universtitetin e Lëvenit, sepse prej neokomunistëve shqiptarë dhe *yshtësve* të tyre pritet çdo lloj pabesie.

— Të paktën në këtë rast, jo, – vërejti shqyrtuesi i dosjes. – Nuk është nevoja as për zhvarrim e as për ekspertizë shkencore. Unë kam shkuar dy herë në Tiranë për verifikimin e identitetit të personazheve të librit tuaj dhe të disa ngjarjeve të veçanta të tij. Atje pashë edhe dosjet e vdekjes së Fatmir Merdarit dhe Afrim Pahisë, të kompletuara me të dhënat përkatëse, si dhe me fotografitë e tyre pas plagosjes dhe në momentin e vdekjes. Por kam përshtypjen se ju nuk i jeni përgjigjur akoma pyetjes që ju drejtova unë, jo si shqyrtues i dosjes suaj, por si kureshtar.

— Keni të drejtë, veçse dëshiroja t'i kthjelloja edhe një herë këto rrethana, me qëllim që përgjigjja ime të bëhej sa më transparente për ju. Gjersa në kryeqytetin shqiptar ekzistojnë dy varre trimash, që akuzojnë e do të vazhdojnë të akuzojnë për prapaskenat e politikës së të mëdhenjve në dëm të atdheut të tyre, për të cilin ata dhanë jetën në moshën 35 vjeçare, unë nuk kam kurrsesi të drejtë morale për kompromis, për hir të mirëqenies personale apo familjare. Nuk ka rëndësi fakti nëse me qëndrimin tim unë nuk ndikoj dot për mirë në zhvillimet politiko-shoqërore në Shqipëri. Problemet e ndërgjegjes nuk kushtëzohen materialisht.

— Ju kuptova. Tani fjalët e mia të fundit : brenda dy javësh do t'ju vijë me postë rekomande përgjigjja përfundimtare e kërkesës për azil ; besoj pozitive. Do të jeni nën mbrojtjen e organeve tona. Ju uroj një jetë më të qetë se deri sot.

— Faleminderit.

XLVIII

ROBERTI

“*Agjentëve të CIAs vetëm nënat ua dinë emrat e vërtetë*.”

Hamit Meli

Megjithë urimin e përzemërt të ekspertit belg të *Komisariatit të Refugjatëve* ditën e ndarjes me të, jeta e Diksit nuk do të vazhdonte aq e qetë edhe më pas. Dhe atë ditë që do të kishte ndonjë lloj shqetësimi aspak të rastësishëm, në mesnatë – fiks në orën 24, do t’i binte zilja e celularit. Kur ai përgjigjej, nga ana tjetër dëgjohej një e qeshur irrituese me zë të ulët, e cila zgjaste mbi dy minuta. Pastaj binte sërish heshtja. Ajo që ishte më interesante, telefonuesi provokator nuk e merrte fare mundimin që ta maskonte të paktën numrin e tij dhe në ekranin e celularit të Diksit afishoheshin shifrat: 0021 267 082 769.

Diksit i kishin dhënë një adresë, ku duhej të ankohej për shqetësime të tilla. Për çudi, pas ankesës që ai bëri, jo vetëm që telefonata e mesnatës nuk u ndërpre (veçse ai tani e fikte celularin, në vend që të përgjigjej), por u shtua edhe një telefonatë tjetër enigmatike nga një numër me prefiks gjerman: 0049 611 532 63 08. Veçse ky i bënte thirrjet ditën dhe komunikonte me Diksin në një mënyrë të veçantë, pothuajse teatrale. Fillimisht një zë burri i fliste anglisht. Mbasi Diksi i thoshte: *më flisni frëngjisht, ju lutem*, ai e vazhdonte bisedën frëngjisht, duke thënë diçka sa për tu justifikuar. Pastaj i thoshte “më fal!” dhe e mbyllte celularin. Brenda pak sekondash zilja e celularit të Diksit binte përsëri dhe në ekran afishohej po i njëjti numër me prefiks gjerman. Një zë femre fillonte të fliste anglisht dhe mbasi Diksi i sugjeronte gjuhën frënge, ajo e vazhdonte bisedën me një frëngjishte elegante, duke përsëritur tekstualisht fjalët që kishte thënë partneri i saj disa sekonda më parë.

Ja teksti i bisedës së parë me ta e zhvilluar në frëngjisht:

— Dua të flas me z. Foks, përgjegjësin e një agjensie imobiliare në Bruksel.

— Keni ngatërruar numërin, zotëri. Nuk jam personi që kërkoni.

— Si, nuk jeni ju z. Foks ?

— Jo.

— Më falni.

Pas pak sekondash, të njëjtat fjalë tha edhe zëri femëror, sikur t’i kishte të shkruara para syve.

Kur kjo telefonatë u përsërit edhe dy herë të tjera prej të njëjtëve zëra, me të njëjtin numër celulari, por me tekst justifikues tjetër në çdo rast, Diksi shkoi përsëri tek zyra ku duhej të ankohej. Takoi të njëjtin person dhe ia shpjegoi skeçin telefonik. Ai buzëqeshi, tundi kokën dhe e pyeti Diksin :

— Në të vërtet, flisni anglisht ju ?

— Jo.

— E dini çdo të thotë *Mister Foks* ?

— Zoti Foks.

Ai qeshi e i tha:

— Jo në kuptimin e drejtpërdrejtë, në atë figurativ.

— Ju thashë që nuk flas anglisht.

— Foks anglo-amerikanët i thonë dhelprës. Por termi *Mister Foks* në gjuhën figurative të një "profesionisti" nënkupton një zotëri dinak.

— E ç'lidhje ka kjo me mua?

— Atë e dinë ata që ju kanë thirrur kështu.

— Unë kam ardhur këtu që ju t'i bëni ata të heshtin. Gjersa unë ju jap numrin e telefonit dhe orën e saktë kur më kanë folur, si dhe jam i gatshëm t'ju vë në dispozicion celularin tim, ju e keni të lehtë të verifikoni gjithçka, besoj.

— Teknikisht po, por… vështirësitë teknike janë më të lehtat, kur bëhet fjalë për probleme të kësaj natyre. Unë duhet të flas me dikë tjetër dhe përgjigjen e tij do t'jua bëj të ditur në ndonjë takim, që do t'ju fiksoj brenda javës së ardhshme.

Diksi e falënderoi dhe u largua.

Pas pesë ditësh ai i telefonoi dhe i la takim në zyrë në orën katër e gjysmë pasdite. Kur Diksi u paraqit atje, ai i propozoi të merrnin një kafe bashkë e i tha :

— Personi që takova nuk më autorizoi t'ju transmetoja asnjë përgjigje. Ai dëshiron të flasë vetë me ju. Do t'ju çoj unë në zyrën e tij, në orën pesë. Kemi kohë ta pimë rehat kafenë.

*

Institucioni ku ai e çoi Diksin nuk ndodhej në rajonin zyrtar të Brukselit. Duke hyrë atje, Diksi e kuptoi se shoqëruesi i tij nuk ishte një zyrtar i rëndomtë. Në orën e caktuar Diksin e thirrën. Personi që donte ta takonte ishte vetëm në zyrë. Ai e ftoi të ulej dhe hyri direkt në temë:

— Jam në dijeni të ankesave tuaja. Verifikimet përkatëse janë bërë dhe rezulton se autorët e telefonatave nuk përbëjnë burim rrezikshmërie për ju. Natyrisht, ato nuk janë korrekte dhe cenojnë lirinë e personit, veprim që ndëshkohet nga ligji. Mirëpo në rastin konkret çështja është pak më e koklavitur nga sa duket në shikim të parë. Telefonatat shqetësuese ju vijnë prej mbrojtësve tuaj të hershëm, të cilët i justifikojnë këto si një testim për cilësinë e mbrojtjes që ju ofron aktualisht shteti belg.

— Më falni, por nuk po ju kuptoj, – i tha Diksi paksa i hutuar.

Tjetri buzëqeshi në mënyrë kuptimplote dhe e pyeti me një ton midis humorit dhe ironisë:

— Nuk kuptoni dot frëngjishten time [*ai ishte flaman – jo frankofon*], apo çfarë?

— Domethënien e fjalëve tuaja.

— Po ju a shpjegoj pak më qartë. Arsyeja e azilit tuaj politik është libri *Odiseja e një detektivi*. Është kështu?

— Po.

— Sipas përmbajtjes së atij libri dhe të intervistës që keni dhënë, CIA ka marrë në mbrojtje protagonistin e atyre ngjarjeve, detektivin Hamit Meli, si edhe ju vetë me cilësinë e mikut dhe të bashkëpunëtorit të tij në burg. Dakord?

— Po.

— Ajo mbrojtje mbetet në fuqi, pavarësisht se cili është qëndrimi juaj sot, apo edhe i mikut tuaj, Hamit Meli; kjo nuk ka asnjë rëndësi. Në këto rrethana ekziston një arsye juridike, e cila përligj interesimin e CIAs për verifikimin e efikasitetit të mbrojtjes sonë ndaj një personi, kundrejt të cilit ajo ka detyrimet e saj me një shtrirje më të gjatë në kohë se angazhimi i organeve tona në mbrojtje tuaj. Këtu nuk ka asnjë kontradiktë ligjore, gjersa as detektivi Hamit Meli e as ju vetë nuk keni bërë ndonjë denoncim zyrtar të mbrojtjes nga ana e CIAs.

— A mund ta bëj unë diçka të tillë nëpërmjet jush?

— Mundet, por unë nuk do t'jua këshilloja kurrë një pakujdesi të tillë.

— Por telefonatat shqetësuese mund të vazhdojnë.

— Sot e tutje ato nuk duhet të jenë më shqetësuese për ju, gjersa po ju bëhet i ditur burimi i tyre. Pikërisht për t'i evituar shqetësime të tilla me justifikim ligjor, ne insistuam aq gjatë që ju të pranonit një zgjidhje me konsensus të kërkesës së azilit, pa arkivim dosjeje. Meqenëse ju nuk hoqët dorë nga e kundërta, tani duhet t'i suportoni këto lloj shqetësimesh, që rrjedhin nga zgjedhja që bëtë vetë. E rëndësishme është që ne ju garantojmë, se prej tyre nuk do t'ju vijë asgjë e keqe, prandaj përpiquni t'i evitoni telefonatat duke mos u përgjigjur.

— Unë e kam ndërruar dy herë kartën e celularit dhe ata e gjejnë shpejt numrin e ri.

Ai qeshi e i tha:

— Unë ju sugjerova të mos ju përgjigjeni telefonatave të dyshimta, jo të ndryshoni numrin e celularit. Për ata kjo është njësoj sikur të tentoni të fshiheni pas hijes suaj. Ju uroj gjithë të mirat.

— Faleminderit; gjithashtu.

Pas këtij takimi, shqetësimet telefonike u rralluan ndjeshëm, por nuk u ndërprenë. Dy-tre herë në muaj dikush i kujtonte Diksit, se emri i tij nuk ishte fshirë nga lista. Nuk mungonin as sinjalet në kalim e sipër në ndonjë qendër shëndetësore a institucion shtetëror, ku e çonte jeta e përditshme Diksin. Por ky u mësua me gjëra të tilla dhe i kalonte si pa vënë re fare. Bile përpiqej të besonte se ishin rastësi, apo thjesht përshtypje të tij.

Mirëpo një ditë Krishtlindjesh ballafaqimi qe konkret, i drejtpërdrejtë. I dërguari i posaçëm i mbrojtësve të kahershëm iu prezantua Diksit me emrin *Robert* (natyrisht, vetëm ashtu nuk e quanin). Propozimet që i ishin bërë tërthorazi Diksit, gjatë viteve që i zvarritej përgjigjja e intervistës, më së fundi po i bëheshin direkt. *Roberti* shprehu keqardhjen që Diksi nuk e fliste gjuhën *ndërkombëtare* – anglishten –, por ai vetë e njihte edhe frëngjishten më mirë nga bashkëbiseduesi.

Roberti ishte një dialogues i aftë. Dinte mirë çfarë thoshte dhe pse e thoshte, ndonëse të folurin e shoqëronte me një buzëqeshje babaxhani dhe me një impenjim të dukshëm për të krijuar përshtypjen, se preokupimi i tij i vetëm ishte bamirësia në favor të atij që e dëgjonte, i cili meritonte (sipas tij) një jetë krejt tjetër nga ajo që bënte. Parashtrimi i argumenteve dhe mënyra e arsyetimit nxirrnin në pah aftësinë e tij negociuese :

— Pranimi i propozimit tim nga ana juaj nuk sjell kurrsesi aq dobi për organet tona, sa do të sjellë për ju vetë dhe për familjen tuaj. Tekefundit dosja juaj është e arkivuar pranë aleatëve tanë, jo tek kundërshtarët tanë, që të përbëjë ndonjë problem aq shqetësues për ne. Por gjersa ekzistojnë premisat e një konsensusi rentabël bilateral, pse u dashka që ky të mbetet peng i një dosjeje, që vetëm mund të prish punë e nuk rregullon asgjë ? E kuptojmë që ju keni rezervat tuaja për mohimin që ju është bërë prej organeve tona për një kohë të gjatë, por duhet të mbani parasysh faktin se CIA është zembereku që vë në lëvizje pjesën më të madhe të botës dhe në veprimtarinë e saj globale nuk mund të ketë perfeksion. Sidomos kur bëhet fjalë për fate individësh – gjëra pa peshë. Por mos harroni në asnjë mënyrë faktin që, pa mbrojtjen e saj, nuk dihej cili do të kishte qenë fati juaj pas publikimit të librit *Odiseja e një detektivi* në vitin 2000. As shërbimet sekrete angleze e as ato shqiptare nuk do të qëndronin neutralë, pa marrëveshjen e nënshkruar me CIAn në maj 1984. Fundi i luftës së ftohtë nuk ishte kurrsesi fillimi i një paqeje botërore midis shërbimeve sekrete. Pavarësisht se ai libër cenonte edhe interesat amerikane, ne kemi respektuar mbrojtjen që ju kemi akorduar, duke i detyruar edhe të tretët ta respektojnë patjetër atë. Përsa i përket neglixhencës së organeve tona për trajtimin tuaj në aspekte të tjera, pikërisht këtë synon të korrigjojë propozimi i sotëm. Nga ana juaj nuk kërkohet asgjë tjetër veç deklaratës së dorëheqjes prej statusit të azilantit politik të ofruar nga shteti belg dhe, si rrjedhojë, suprimimit të dosjes përkatëse. Në këtë mënyrë ju do të kaloni nga gjendja e një azilanti pothjuajse vegjetues në atë të fitimit të të drejtave të plota si pjesëtar i një grupi antidiktatorial të dekoruar prej CIAs. E thënë ndryshe : nga pothuajse asgjë në pothuajse gjithçka. Besoj se nuk ia vlen të humbisni kohë për tu menduar që të zgjidhni.

Pavarësisht se çfarë besonte në të vërtetë *Roberti*, vazhdimi i bashkëbisedimit nuk qe aq i këndshëm për asnjërin. Dalëngadalë buzëqeshja babaxhane e *Robertit* filloi të zbehej. Kuptohej që ai kishte qenë i bindur se propozimi i tij nuk kishte gjasa të refuzohej. Duke provuar të kundërtën, *Roberti* nuk ishte më ai i fillimit. Tek ai ndryshoi jo vetëm shprehja e fytyrës, por edhe mënyra e të shprehurit, duke i bërë të ditur bashkëbiseduesit se *kokëfortësia nuk ka qenë dhe nuk është vlerësuar si virtyt në asnjë kohë, aq më pak në shekullin XXI, dhe se ajo dëmton, më tepër se këdo, mbartësit e saj*.

Ndërkohë që Diksi përpiqej ta ruante vetëkontrollin në lartësinë që e kërkonin rrethanat, bashkëbiseduesi i tij, sa më shumë që i humbiste shpresat e konsensusit, aq më pak kujdesej për etikën e komunikimit. Kur *Roberti* e kuptoi se kompromisi ishte i pamundur, ai nuk ngurroi t’i adresonte bashkëfolësit dhe

shprehje të tilla:

— Ndodh që fati të trokasë edhe në derën e një shurdhi. Në këtë rast viktimë e koniukturave është fati jo shurdhi, të cilin Zoti nuk e ka destinuar për më lart.

Buzëqeshja e hidhur e Diksit ia shtoi revoltën e brendshme *Robertit*, prej fytyrës së të cilit ishte zhdukur tashmë buzëqeshja babaxhane. Në çastin e ndarjes ai i adresoi disa fjalë që Diksi nuk i priste:

— Lexojeni me vëmendje kartëvizitën, në anën e pasme të së cilës ju kisha fiksuar takimin. Ajo i përket një hoteli me emrin *Hagë*, që të kujton Gjykatën e Hagës. Ai hotel ndodhet në qytetin Sheveningen të Hollandës, ku gjendet edhe burgu i sigurisë së lartë, në të cilin përfundojnë të dënuarit e Hagës. Lamtumirë!

Pas këtyre fjalëve, *Roberti* me pamje aktoriale u përzie me kalimtarët e shumtë të stacionit ndërkombëtar të trenit në Bruksel.



Duke lexuar të dhënat e kartëvizitës që i kishte përmendur *Roberti*, Diksi buzëqeshi e tha me vete:

«Sidoqoftë, krahasuar me kampet e Spaçit e të Qafë-Barit, burgu luksoz i Sheveningenit do të ishte një strehë paqeje për mua. Faleminderit, *Robert*!»

Në vend të pasthënies.

RRETHANA QË KUSHTËZOJNË TË ARDHMEN E SHQIPTARËVE

Në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar, numri i popullsisë shqiptare ishte pothuajse i barabartë me atë të intelektualëve të sotëm shqiptarë. Ndërsa numri i intelektualëve të atëhershëm, në shkallë vendi, ishte më i vogël nga ai i intelektualëve që vegjetojnë sot në një qytet të kategorisë së dytë.

Megjithë të metat e saj të njohura, monarkia shqiptare e atyre viteve krijoi me atë grusht intelektualësh shtetin më të konsoliduar të historisë njëqindvjeçare, qysh prej shpalljes së pavarësisë kombëtare e deri sot, të cilin do ta pasonte shteti-burg i diktaturës komuniste.

Në kohën e monarkisë monedha shtetërore rreshtohej me të fortat e kontinentit, qarkullimi i lirë i shqiptarëve ishte i barabartë me atë të qytetarëve të shteteve më të zhvilluar të Evropës dhe prona mbrohej me ligj. Defektet ishin evidente, por edhe arritjet ishin reale e jo gënjeshtra banale të propagandës shtetërore si sot.

*

Por ç'ndodh në Shqipërinë e shekullit XXI, e cila ka intelektualë aq sa kishte banorë monarkia?

Po bëjnë vaki ato krime e turpe kombëtare, që nuk ka kryer kurrë ndonjë qeveri kuislinge në historinë e Evropës e më gjerë. Dhe shumica dërrmuese e intelektualëve shqiptarë qëndrojnë të ftohtë si peshqit përballë një drame kombëtare, që shtjellohet përditë para syve të tyre indiferentë. Janë vërtet intelektualë apo… pretendojnë?

U falen grekëve pjesë të atdheut në mes të ditës, sikur të ishin vezë pashke, dhe autori i këtij krimi kundër kombit shan e mallkon një kolonel atdhetar në pension, që sakrifikoi për të shpëtuar territorin shtetëror dhe dinjitetin kombëtar. Dhe kjo iu shpërblye duke e detyruar të braktiste atdheun prej kërcënimeve të përditshme, se do ta zhduknin me gjithë familje. Ndërsa vasali grek i Tranës u zotua solemnisht, se do ta çonte deri në fund legalizimin e paktit antikombëtar të detit Jon. Pra, linçohet Virtyti prej Vesit dhe intelektualët heshtin, ose bëjnë sikur flasin. Në shekullin XXI !

Ndërsa në skenë dy klanet politiko-mafioze *opozitaro-solidarë* bëjnë sikur janë armiq të betuar, në prapaskenë gjithçka shkon vaj midis tyre e në dëm të shqiptarëve. Opozita-solidare po korrigjon *gabimin* e ankimimit të paktit detar në Gjykatën Kushtetuese, duke miratuar aktualisht në heshtje rinegocimin progrek të jetimit deti Jon nën rrogoz, i cili po i afrohet finalizimit. Këtë herë mjaft i përkushtuar në këtë akt antikombëtar po tregohet edhe presidenti, të cilit i ka hyrë në qejf kolltuku dhe di të sakrifikojë për të. Me bekimin e tij (si kompensim të ndonjë premtimi bosh për karrierë në të ardhmen), negocimi i

paktit e ka anashkaluar përsëri institucionin e presidencës. Madjé, për t'iu treguar grekëve se është ai vetë që e ka autorizuar këtë veprim ilegal, presidenti firmosi rishtas emërimin si përfaqësues të Shqipërisë në NATO të Kristaq Gervenit, arkitektit të paktit detar të anulluar nga Gjykata Kushtetuese. Në vend që të burgosej për tradhti kombëtare, Gerveni përfaqëson në Bruksel atdheun e tradhtuar !

Ndërkohë armata e akademikëve, e rektorëve, e docentëve, e doktorëve, e profesor-doktorëve, e … (ç'tituj keni më, o intelektualë shqiptarë?), e vetëshpallur *elitë e kombit* ndahet në dy elika, blu e rozë, sa herë që dy klanet respektivë politiko-mafiozë e *opozitaro-solidarë* organizojnë furtunat në gotë të antagonizmit të tyre imagjinar, të cilat përdoren si bomba tymëse, për të tërhequr vëmendjen e publikut të lodhur nga prapësitë antikombëtare të këtij sezoni të begatë progrek.

Rezultati? Greva e urisë nën dritaret e kryeministrit, që tallej me ta, përfundoi në një darkë krokodili, mbasi opozita-solidare ishte betuar e stërbetuar se, po të mos hapeshin kutitë e votimit, nuk e ndërpriste grevën. Mandej filluan demonstratat deri në rrëzimin e qeverisë(sic). Mbasi u vranë katër fatkeqë të pafajshëm, opozita-solidare u betua, se nuk nuk bëhej më fjalë për t'i ndërprerë demonstratat, deri në rrëzimin me çdo kusht të qeverisë hajdute e kriminele. Për çudi, demonstratat organizoheshin vetëm të xhumanë, e cila i krijon alergji BE.

Përfundimisht gjithçka u avullua me shpalljen *burrë shteti* të kryetarit të qeverisë prej ambasadorit amerikan. Ndërkaq opozitarët-solidarë harruan jo vetëm grevën diskredituese të urisë për verifikimin e kutive të votimit, por edhe rrëzimin e qeverisë hajdute e kriminele, si dhe bojkotimin e zgjedhjeve lokale.

– Ku ishe? – Asgjëkundi. – Çfarë bëre? – Asgjë. Dhe jo pak, por dy vjet! Natyrisht, kjo nuk është rastësi, por një strategji e studjuar e krerëve të të dy klaneve abuzivë politiko-mafiozë.

Intelektualët shqiptarë, të mbingarkuar me tituj, vazhdojnë të bëjnë sehir tragji-komedinë e popullit të tyre. Në kundërshtim të plotë me ta, Vasil Bollano & co po bëjnë në tokën shqiptare sot e gjithë ditën aq shumë punë në favor të Greqisë e në dëm të Shqipërisë, sa nuk bëjnë dot gjithë intelektualët shqiptarë në mbrojtje të interesave jetike kombëtare, të së ardhmes së tyre e të fëmijëve të tyre.

Progrekët antishqiptarë organizuan konferencë në Tiranë për ta shpallur Himarën minoritet të tyre, ndërkohë që Akademia e Eunukëve (që ka uzurpuar emrin *e Shkencave…*) nuk ka kurajë të përmendë të drejtat e nëpërkëmbura të popullsisë çame. Vetëm një historian 90 vjeçar dhe ndonjë nxënës i tij ngritën zërin për paligjshmërinë e asaj konference provokative, të cilën akademikët *modernë* e justifikonin me të drejtat e pakicave në kuadër të BE. Por dihet se të drejtat e pakicës mbarojnë atje ku fillojnë ato të shumicës dhe anasjelltas. Pse nuk e provojnë njëherë këta akademikë dështakë të mbajnë në Athinë ndonjë konferencë shkencore për të drejtat e nëpërkëmbura të çamëve, mbështetur në të njëjtat parime të BE, anëtare e të cilit është Greqia? Vetëm ideja e një veprimi të

tillë do t'i detyronte eunukët tanë akademikë t'i bënin pis bebelinat nga frika, mbasi e dinë mirë se atje vendi ka zotër të tillë që po bëjnë ligjin edhe në Tiranë.

Pas Himarës, e kishte radhën Korça për tu deklaruar minoritet grek prej një konsulli agresiv vorioepirotas. Në vend që ai të shpallej menjëherë *persona non grata* e të largohej nga Shqipëria, ndodhi krejt e kundërta, e pabesueshmja, poshtëruesja. Qeveria greke urdhëroi vasalin e saj të Tiranës ta pushonte menjëherë nga puna diplomatin atdhetar, i cili kishte guxuar të ngrinte zërin për nëpërkëmbjen që po u bëhej interesave jetike dhe dinjitetit të vendit të tij. Tashmë është fakt publikisht i njohur që qeveria greke është më e fortë në Tiranë sesa në Athinë, ku ka probleme serioze me popullin e saj, për shkak të krizës ekonomike.

Është papjekuri politike që populli shqiptar të ketë inat fqinjët grekë, pse e shijnë lëmin siç ju intereson në një Shqipëri të tradhtuar prej krerëve shqiptarë. Politika nuk është filantropi dhe mallin pa zot e përlan më i forti, direkt apo tërthorazi. Burimi i fatkeqësisë shqiptare është Tirana, jo Athina. Mirëpo askush nuk e mohon dot faktin, se pjesa dërrmuese e inteleligjencies së sotme shqiptare është dështake. Dhe dihet që tonin një ambienti shoqëror ia jep gjithmonë shumica.

Cilat janë defektet më dëmsjellëse të inteligjencies së sotme shqiptare ?

Ata janë të shumtë, por le të përmendim tre më kryesorët.

A. Interpretimi ireal i realitetit, dukuri psikologjiko-morale e trashëguar nga koha e diktaturës së proletariatit – si demokracia më e kulluar në botë.

Inteligjencia shqiptare e di shumë mirë që në disa vende të BE ka parti komuniste, programi i të cilave garanton interesat kombëtare, pronën private, liritë e individit, etj., në pajtim me kushtetutën e këtyre vendeve.

Dy klanet politiko-mafiozë solidarë me njëri-tjetrin, të cilët po luajnë me Shqipërinë dhe me shqiptarët prej njëzet vjetësh, të dy i kanë tradhëtuar disa herë interesat kombëtare dhe u kanë vjedhur pronat pronarëve të ligjshëm me ligjin 7501. Nuk bëhet më fjalë për votat, me të cilat ata janë tallur e vazhdojnë të tallen. Rrjedhimisht, të dy këta klane politiko-mafiozë janë më të majtë se partitë komuniste evropiane (ngaqë në të vërtetë nuk janë parti politike) dhe shkelin pa teklif kushtetutën e vendit, parimet bazë të demokracisë, duke mos i respektuar fare edhe programet e tyre fiktivë. Ndërkohë parlamenti shqiptar nuk ka pranuar t'ia heqë titujt *Hero i Popullit* e *Hero i Punës Socialiste* diktatorit Hoxha edhe pas njëzet vjetësh *demokraci…*

Atëherë, me ç'të drejtë morale e juridike armata e intelektualëve shqiptarë, e mbingarkuar me tituj shkencorë, pranon se në Shqipëri paska parti të djathta, parti të qendrës e parti të majta evropiane? Qoftë cektësi gjykimi (pak e besueshme), qoftë kompromis me ndërgjegjen për hir një mbijetese banale (trashëgimi nga diktatura), ky është një interpretim i tjetërsuar i spektrit politik shqiptar dhe shërbimi më i madh që mund t'iu bëhet dy klaneve solidarë politiko-mafiozë, që po e trajtojnë Shqipërinë si plaçkë tregu dhe shqiptarët si

bujkrobër të tyre.

Intelektualët duhej ta denonconin ashpër këtë realitet të politikës shqiptare dhe ta quanin me emrin që i takon, duke treguar me gisht sundimin e monizmit politiko-mafioz, i cili është po aq i rrezikshëm sa edhe diktatura që e polli. Por ata kanë heshtur e heshtin – indiferentë. Në pajtim me interesat e tyre të çastit. Për një mbijetesë mjerane, përveç militantëve të verbër të të dy klaneve, që shpërblehen për veprimtarinë e tyre antishqiptare.

B. Pranimi me naivitet foshnjarak i rikonvertimit të kriminelëve në qeveritarë.

Pas ngjarjeve tragjike të viteve 1997-1998, humbën jetën mbi 3500 shqiptarë, u palgosën mbi 11 mijë të tjerë, u shkatërrua shteti totalisht, duke iu shkaktuar vendit një dëm material prej disa miliarda dollarë. Ndërsa shteti pësoi një deformim ekstrem, duke u kthyer në një ndërmarrje private. Asnjë këmbë pushtuesi nuk shkeli në Shqipëri dhe gjithë ajo tragjedi kombëtare ishte përgjegjësi e drejtpërdrejtë e dy klaneve politiko-mafiozë e opozitaro-solidarë.

Megjithatë armata e intelektualëve shqiptarë e quajti të mirëqenë faktin, që shkaktarët e tragjedisë kombëtare me përmasa të rrëqethshme ta rifillonin politikën mafioze atje ku e kishin lënë. Dhe pastaj, me një naivitet të tejskajshëm, shprehin habi pse nuk dënohen shkaktarët e tragjedisë së Gërdecit, autorët e katër vrasjeve të 21 janarit 2011, ose krimet e tjerë që do i pasojnë këto prapësi, ndërkohë që mbeti pa u gjykuar gjoli i gjakut të vitit 1997–1998 !?

Në kuadër të revolucioneve popullore të jaseminit në Afrikë, diplomacia amerikano-evropiane dhe ajo botërore në tërësi i denoncuan me të drejtë si vrasës e kriminelë udhëheqësit e atyre vendeve, kur shtinin mbi turmat e demonstruesve. Vetëm në Shqipëri (gjoja në Evropë) ata i quajnë normale vrasjet e shtetasve të pafajshëm në bulevard. Kështu ndodhi më 1997-1998, kështu po ndodh edhe sot. Të gjithë shqiptarët e kuptojnë se më 21 janar 2011 asnjë qytetar nuk mund të vritej para Kryeministrisë pa urdhërin e të zotit të shtëpisë, e jo më katër persona paqësorë! Por a nuk ishte pikërisht ai që u shpall *burrë shteti* prej ambasadorit-guvernator të kolonisë shqiptare, ndërkohë që të tjerë do shkojnë për koka turku në vend të tij prej ekspertëve amerikanë?

Edhe Mubaraku me vota ishte zgjedhur, bile pak më të pastra se ato të *burrit të shtetit* shqiptar, por nuk mund të përligjeshin vrasjet e 300 demonstruesve në Afrikë, aq lehtë sa përligjen mijëra të tillë në skutën e përbuzur të Evropës me emrin Shqipëri.

Klika politiko-mafioze blu-rozë, që bën sikur po qeveris Shqipërinë, ka ngecur në gjolin e gjakut të viteve 1997-1998 dhe ajo është absolutisht e detyruar të respektojë urdhërat nën zë, që i jepen prej atyre që i shpëtuan qëllimisht atëherë, për t'i pasur në të ardhmen vegla të verbëra në arritjen e objektivave të caktuara të politikës rajonale, në dëm të shqiptarëve e në dobi të fqinjëve. Krimet nuk parashkruhen dhe gjoli i gjakut të viteve 1997-1998 qëndron si shpata e Demokleut mbi kokat e nxehta të gjynahqarëve të politikës shqiptare, duke i katandisur krerët e klasës së sotme politike të Tiranës në

skllevër rrethanash. Prandaj prej tyre nuk duhet pritur asgjë, se nuk mundin të bëjnë dot asgjë të mirë, edhe sikur të duan, mbasi suflerat e huaj politikë, që veprojnë si këshillëtarë *bamirës*, u thonë gjatë bisedave kokë më kokë:

«Duhet vepruar si ju themi ne, në qoftë se doni të keni mbështetjen tonë. Përndryshe… a nuk jeni ju përgjegjësit e gjakderdhjes së viteve 1997-1998, të tragjedisë së Gërdecit të kthyer në parodi, të manipulimit skandaloz të votave, të korrupsionit të pashëmbullt në Evropë, ku akuzat reciproke të dy klaneve tuaja përfshijnë afera me qindra miliona euro, sikur Shqipëria të ishte perandori ? Ne disponojmë dosjet përkatëse si të krimeve edhe të korrupsionit tuaj galopant.»

Kush do të ishte ai që, në rrethana të tilla, nuk do të përgjigjej ezber:

«Jam gati të bëj ç'të më këshilloni ju. Më thoni çfarë duhet të bëj…»

A ka të ardhme tjetër, veç greminës, një popull që drejtohet nga kërma të tilla politike ? Aq më tepër që shqiptarët e presin zgjidhjen e problemeve të tyre gjithmonë prej të huajve, detyra e të cilëve është t'iu shërbejnë objektivave politike të shteteve të tyre, sidomos në një vend ku prapësitë rrëshqasin si në gjalpë.

C. Sindroma *Domate*: nevoja për tu mbështetur patjetër tek një i huaj, për të qeverisur vendin tënd, sipas porosive të tij e jo sipas interesave të vendit.

Nuk ka asgjë më të dëmshme për interesat kombëtare e shoqërore të një shteti, sesa t'ia besojë ato symbyllas një të huaji, cilidoqoftë ai. Vetëm naivët mendojnë se politika e të fortëve udhëhiqet nga humanizmi. Shtetet e fuqishme juridike vigjëlojnë për demokracinë në vendet e tyre, ndërsa udhërrëfyes dhe objektiv i politikës së tyre të jashtme është vetëm një: interesi shumëplanësh i shteteve të tyre. Dhe kjo është krejt normale.

Është fat i madh për një vend të vogël, kur interesat e një të fuqishmi kërkojnë forcimin e shtetit në atë vend. Veçse kur ndodh e kundërta, ajo është fatale për të. Për Shqipërinë e Kosovën pikërisht këto kambana bien. Ndërsa Jugu i Shqipërisë po greqizohet me shpejtësi, ndërkohë po përgatitet serbizimi i Veriut të Kosovës, i cili do të shënojë hapin e parë drejt rikthimit të Kosovës së tkurrur e të sëmurë në vartësi serbe. Pushtimi me armë i një vendi nuk jep rezultate të përhershme, ndërsa asimilimi i tij gradual e i studjuar mirë e fshin atë nga historia. Atë udhëtim të kobshëm ka nisur kombi shqiptar.

Interesat kombëtare të një shteti, që qeveriset nëpërmjet asistencës së huaj politike, janë më të rrezikuara sesa të një kolonie të shpallur ligjërisht, për të cilën shteti kolonizator përgjigjet. Dëmi shtetëror i shkaktuar prej kukullave politike vendase, nën diktatin e kushtëzuar për karrierë të diplomacisë së të fortëve, është kombëtarizim i faktorëve shkatërrues. Ky proces shpërbërës përparon paralelisht si në Shqipëri edhe në Kosovë. Gjendja bëhet katastrofike kur qeverisesh prej një kryeministri, i cili nga njëra i kërcënon me shpirtligësi shtetasit e tij se do qëndrojë në pushtet deri në vitin 2036 (kush po pyet për merhumin *sovran* !) e nga ana tjetër i thotë të dërguarit të BEsë, Lajçak:

«Jam gati të bëj ç'të më këshilloni ju. Më thoni çfarë duhet të bëj.»

Hajde, *pavarësi*, hajde! Dhe këtë bastardë ambasadori-guvernator na i servir si *burrë shteti*, megjithëse është i bindur që me një *burrë shteti* të tillë Amerika do të përjetonte vetëm drama si të 11 shtatorit.

*

Të nderuar intelektualë shqiptarë !

Po bëni sikur nuk e kuptoni se në ç'gjendje të mjeruar është katandisur atdheu ynë, apo nuk e kuptoni në realitet?

Cilado qoftë e vërteta, mëkati është i njëllojtë. Maqedonia, që shumë prej jush kanë kurajën ta përçmojnë si *shtet i paemër*, për vite të tëra po i reziston presionit të Athinës e të BEsë pikërisht për çështjen e emrit. Sikur vetëm Greqia t'ua kërkonte këtë gjë vasalëve të saj në Tiranë, emri i Shqipërisë do të ishte ndërruar të paktën pesë herë deri sot.

Mjaft prej jush janë shprehur këto javë të pranverës politike afrikane, se *Shqipëria nuk është Tunizi*. Kjo është shumë e vërtetë, por jo në atë kuptim që u pëlqen ta interpretojnë këtyre *intelektualëve evropianë* (largqoftë, se me eunukë të tillë Evropa do të ishte ende në feudalizëm!). Për hir të së vërtetës, duhet pranuar se prej këtij krahasimi ka të drejtë të ofendohet shumë Tunizia afrikane, jo Shqipëria evropiane (vetëm gjeografikisht).

Megjithëse në Tunizi nuk kishte opozitë politike, mjaftoi organizimi i një grupi avokatësh të zotë e atdhedashës që, të mbështetur pa rezerva prej intelektualëve të tjerë, e drejtuan me aq kurajë e zgjuarsi popullin e tyre liridashës, saqë e detyruan sundimtarin e tyre (shumë më përparimtar e patriot se vasalët athinjotë të Tiranës) të braktiste vendin. Dhe të vdiste shpejt nga marazi, si njeri me sedër. Opozita tuniziane, e organizuar në luftë e sipër, nuk i pranoi masat gjysmake, derisa e detyroi gjithë ekipin e mëparshëm qeveritar të zhdukej nga skena politike.

Mjaft intelektualë e gazetarë shqiptarë janë shprehur entuziastë për arbitrazhin hetimor amerikan lidhur me vrasjet e 21 janarit 2011. Kjo është një dukuri tipike shqiptare, e cila ka brenda ca përqindje të mungesës së kurajës për t'iu dalë zot vetë problemeve të vendit, ca të servilizmit funksional ndaj të fuqishmit (përqindja më e lartë), ca të indiferentizmit të dështakut dhe ca të naivitetit politik. Një inteligjencie e përgjegjshme e mirëpret ndihmën e huaj, por pa dezertuar kurrsesi nga detyra e saj atdhetare.

Mendoni ju se amerikanët nuk e dinë si qëndron e vërteta e tragjedisë së Gërdecit? Janë profanë ata që e besojnë këtë, ndërkohë që shërbimet sekrete amerikane po menaxhojnë edhe vetë SHISHin. Kush i ka ndaluar ose po i ndalon amerikanët, që të kontribuojnë për gjykimin e drejtë të asaj tragjedie rrëqethëse, e cila nuk ka për tu gjykuar kurrë, pikërisht falë *kontributit* amerikan? Ashtu siç nuk ka për tu ndëshkuar kurrë vrasësi i vërtetë i katër viktimave të 21 janarit 2011, i cili u shpall paraprakisht *burrë shteti* prej ambasadorit-guvernator, gjë që nënkuptonte merita e jo fajësi të vrasësit.

Fatkeqësisht një pjesë e mirë e inteligjencies shqiptare mendon se do fitojë simpatinë e amerikanëve nëpërmjet servilosjes, si në kohën e diktaturës. Koncept arkaik. Natyrisht, amerikanët preferojnë të kenë të bëjnë me servilë e eunukë, që u shërbejnë falas apo me çmim të ulët (ky është objektiv i çdo të forti), por ata kurrë nuk kanë respekt për intelektualët e depersonalizuar, për veglat e verbëra, që veprojnë në dëm të vendit të tyre. Përkundrazi.

Dy aleatët e vetëm strategjikë të SHBA – Anglia dhe Izraeli – janë edhe dy vendet ku presidentët amerikanë priten më ftohtë.

Në Shqipëri, në vitin 1991, vetura e Sekretarit amerikan të Shtetit, Xhejms Bejker, ndryshoi ngjyrë prej të kuqit të buzëve të grave që e puthën. Kurse një shtetas shqiptar i puthi atij këpucët tek sheshi para xhamisë. Në raste të tilla kompensimi moral është neveria ndaj primitivitetit, por cili qe në të vërtetë kompensimi material prej Sekretarit amerikan të Shtetit atëherë? Vetëm 6 milionë dollarë të premtuar për tre milionë e gjysmë shqiptarë! Dhe ky mbeti vetëm një premtim, mbasi nuk u aprovua nga Kongresi dhe shqiptarët ngelën pa lëpirësen amerikane.

Ndërsa për kapërcimin e krizës greke u hodhën në lojë 140 miliardë dollarë dhe gjysma e kësaj shume do paguhet nga Banka Botërore me garancinë amerikane. Ndërkohë dihet që presidentët amerikanë, gjatë vizitave të rralla që bëjnë në Athinë, priten gjithmonë me demonstrata të fuqishme, nën diktatin e patrikanës së Moskës. Aktualisht Greqia ka në Afganistan 8 herë më pak ushtarë sesa Shqipëria, në raport me numrin e popullsisë.

Si mendojnë intelektualët e squllët shqiptarë, për cilin ka më shumë respekt Amerika, për vorioepirotin e hazdisur Nikolla Gejxh, apo për ata që i kthejnë krahët popullit e vendit të tyre?

*

Reporteri i famshëm francez, specialist i politikës së jashtme, Eric Laurent, i cili ka vepruar mjaft kohë në SHBA, shkroi një libër me titull *Lufta e Bushëve* (*sekretet e papohuara të një konflikti*), i cili u botua në janar 2003, në prag të fillimit të luftës kundër Sadamit. Suksesi i librit qe më i madh në Amerikë sesa në Evropë, ku gjithashtu ishte një *best-seller*.

Analizën e dinastisë *Bush* autori e fillon në libër qysh prej Prescott Bush, gjyshit të presidentit amerikan që nisi luftën në Irak për rrëzimin e Sadam Huseinit. Veç të tjerash, Prescott Bush ka qenë senator prestigjioz republikan prej vitit 1952 deri në vitin 1962.

Ja si shkruan Laurent:

«Më 20 tetor 1942, pak pas hyrjes në luftë të SHBA, *Union Banking Corporation* u bë objekt i një denoncimi të qeverisë federale për "tregti me armikun". Prescott Bush ishte drejtori i saj dhe tre ortakët e aksionerët kryesorë, përveç Roland Harriman, ishin tre kuadro naziste, dy prej të cilëve punonin për Thyssen. Tetë ditë më vonë, administrata e Ruzveltit aplikoi të njëjtat sanksione

kundër *Holland-American Trading Corporation* dhe *Seamless Steel Equipment Corporation*, që të dyja të drejtuara nga Bush dhe Harriman, dhe të akuzuara për bashkëpunim me Rajhun e Tretë.» [Eric Laurent, *La guerre des Bush* – (*les secrets inavouables d'un conflit*), faqe 19. Plon, 2003, Paris.]

Dhe më tej në libër ai vazhdon:

«Drejtuesit e këtyre shumëkombësheve dhe bankave amerikane konstatonin [*në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar* – A.H.] se vendet e Evropës Lindore dhe Bashkimi Sovjetik posedonin burime me një vlerë shumë të madhe: sasi të konsiderueshme punonjësish të kualifikuar, ekstremisht të disiplinuar, me kosto të ulët. Mungesa e dinjitetit të tyre ka të ngjarë të mos ua ketë përshkuar kurrë shpirtin, megjithëse ata mbështesnin dhe forconin një regjim totalitar, siç kishin bërë paraardhësit e tyre me Gjermaninë naziste tridhjetë vjet më parë.» [Eric Laurent, *La guerre des Bush* – (*les secrets inavouables d'un conflit*), faqe 24. Plon, 2003, Paris.]

Ndërsa mbi kopertinën e pasme të librit në fjalë, [*La guerre des Bush* – (*les secrets inavouables d'un conflit*), Plon 2003, Paris], shkruhet :

«Pse presidenti aktual amerikan dhe babai i tij mbajnë prej më se njëzet vjetësh lidhje me familjen Bin Laden? Pse një bankier i fuqishëm saudian, kunat i Bin Ladenit, i dyshuar se ka financuar rrjetet e Al Kaidës, e ka ndihmuar vazhdimisht Xhorxh W. Bushin në veprimtarinë naftënxjerrëse, duke e shpëtuar edhe prej falimentimit? Si shpjegohet harbimi i babait të tij, kur ishte president, për të armatosur e financuar Sadam Huseinin, duke provokuar ndoshta pushtimin e Irakut? Pastaj, dymbëdhjetë vjet më vonë, harbimi i të birit për të shkatërruar të njëjtin Husein?»

Megjithëse 250 faqet e librit të tij janë një akuzë e rëndë për dinastinë Bush (të argumentuar me fakte tronditëse), Eric Laurent është i nderuar e i respektuar në Amerikë dhe miqtë e tij të atjeshëm (Laurent kishte qenë një reporter shumë i njohur në SHBA) e furnizuan me materiale informative, për të shkruar po atë vit një libër tjetër të suksesshëm me titull: *Bota sekrete e Bushit* [Eric Laurent: *Le monde secret de Bush*, Plon 2003, Paris].

Këta libra ia rritën edhe më shumë prestigjin autorit në Amerikë, ku ai edhe u ftua nga universitete të ndryshme.

Të nderuar intelektualë shqiptarë!

Rruga për të fituar respektin e kujtdoqoftë nuk kalon kurrë nëpër baltovinat e servilizmit e të nënshtrimit pa kushte; përkundrazi.

*

Sado që të rrëzohet një popull prej pushtetarëve abuzues që ka mbi krye, ai nuk bie kurrë aq poshtë sa të mos meritojë shërbimin e ndërgjegjshëm të intelektualëve të tij. Natyrisht, kur këta të fundit kanë ndërgjegje.

Dihet se e keqja nuk mund ta sundojë gjatë një popull, pa mbështetjen e një pjese të mirë të inteligjencies së pandërgjegjshme. Ison e mbajnë indiferentët.

Por dihet gjithashtu se një populli nuk i mungojnë kurrë edhe intelektualët e ndërgjegjshëm e të përkushtuar. Përndryshe ai nuk do të ekzsitonte dot si popull.

Popujt e kulturuar nuk e tolerojnë të keqen. Ata e luftojnë atë si armikun e tyre të përbashkët, ashtu siç është në të vërtetë. Dhe për këtë nuk ndikohen fare prej flamujve të partive, apo bindjeve politike.

Popujt e pazhvilluar, si i yni, e durojnë gjatë të keqen, pushteti i së cilës bëhet gjithmonë e më kërcënues, gjersa një ditë të zë frymën. Ditë të tilla po jeton aktualisht populli shqiptar në të dy anët e kufirit. Tirana është e sëmurë rëndë, Prishtina dridhet nga ethet. Grekëve nuk do t'iu ecte më mirë puna në Shqipëri, sikur kryeministër të ishte një bashkatdhetar i tyre. Përkundrazi, për arsye taktike, ai do të ishte më i përmbajtur nga Berisha në pathosin progrek e antishqiptar.

Serbët nuk mund të imagjinonin dot kushte më të favorshme për fillimin e dialogut me Kosovën e drobitur, sesa momenti kur kryeministri i saj pësoi një nokaut moral të llogaritur mirë nga diplomacia evropiane tërësisht proserbe. Ndërkohë serbët jo vetëm që nuk e njohin shtetin e Kosovës, por *de facto* e kanë nën kontrollin e tyre veriun industrial dhe manastiret i kanë kthyer në enklava kanceroze për perspektivën e Kosovës. Kushti që i ishte vënë Serbisë, për të njohur Kosovën para hyrjes në BE, u harrua. Tre vjet pas shpalljes së pavarësisë së saj, Republikës së Kosovës i merren këmbët.

Populli shqiptar, në të dy anët e kufijve, po e shikon qartë rrezikun dhe i shqetësuar shtron pyetjen:

«Ç'duhet të bëjmë, gjersa politikanët s'po na i zgjidhin problemet, veç po na i shtojnë ato?»

Kjo pyetje prekëse, më aktuale se kurrë – mbasi thika ka mbërritur tashmë në kockë – shtrohet në komentet e shumicës së lexuesve të shtypit në internet. Është pyetje e dalë nga thellësia e shpirtit të plagosur të një populli shpresëhumbur, që në shumë raste preferon vetëvrasjen, për të shpëtuar nga vdekja e përditshme e mjerimit ekstrem. Por edhe duke vdekur ata marrin me vete një brengë suplementare, se mos edhe varret e tyre e pësojnë një ditë si ata të Boboshticës.

Ndërkohë fëmijët e familjeve të ngujuara, fytyrëzbehtë nga uria e tmerri i armës që pret të shkrehet, dëgjojnë zërin (ata s'kanë televizor) e kryeministrit që i siguron me besë malsori, se jemi një nga popujt më të lumtur të Ballkanit…

«Ç'të bëjmë?», pëshpërisin edhe buzët e thara të fëmijëve të ngujuar anemikë, që shikojnë me sy të përlotur babanë e tyre duke pirë duhan, në pritje të ditës së plumbave. Jo rrallë ai e shpejton vetë atë ditë, me një pakujdesi të qëllimshme, për të shpëtuar prej atij tmerri pa fund.

«Po tani ç'të bëjmë?», lebetiten jetimët e këputur, të mbetur në mes të katër rrugëve.

Por ata nuk kanë internet që ta shkruajnë këtë pyetje atje e t'i qajnë hallet së bashku me të tjerët. Psherëtimat e tyre treten në eter.

Fshati që duket nuk do kallauz – thotë një proverb i popullit tonë.

Media shqiptare në tërësi dhe shtypi në veçanti, megjithë mangësitë evidente që manifeston, nuk duhet të harxhojnë më energji e kohë për t'iu prezantuar skëterrën kombëtare shqiptarëve, e cila po i lemeris të gjithë. Jo vetëm të gjallët, por edhe të vdekurit, eshtrat dhe varret e të cilëve po ndërrojnë kombësi dhe po kthehen në sinorë të helenizimit të trojeve amëtare.

Shqiptarëve ua shtron problemet mjerimi i tyre përditë e përnatë. Është ora për t'i zgjidhur ato. Është ora për t'iu dhënë një përgjigje serioze e premtuese pyetjeve të shumta, që shtrojnë shqiptarët e shqetësuar në komentet e tyre në internet:

«Ç'duhet të bëjmë, për të shpëtuar nga kjo gjendje?»

Kësaj pyetjeje jetike i duhet dhënë përgjigje sa më parë nga ju, intelektualë shqiptarë, mbasi nesër do të jetë vonë. Dhe mos harroni mësimin e historisë së hidhur të popullit tonë: e kemi paguar gjithmonë shtrenjtë udhëtimin në histori, se përherë kemi qenë udhëtarë të vonuar. Le të përpiqemi së bashku të shpëtojmë kësaj here nga ky kurth i kohës. Për këtë fati na i ka ofruar rastin, i cili vjen vetëm një herë në jetë.

Libri me ngjarje të jetuara që keni në dorë denoncon *Thembrën e Akilit* të problemit tonë kombëtar e shoqëror, duke shtruar njëherësh edhe mënyrën e zgjidhjes së tij. Asnjë pasojë nuk mund të meremetohet, pa u eliminuar më parë shkaqet e saj. CIA ka sabotuar në maj 1984 komplotin antidiktatorial të 22 kuadrove e detektivëve të Drejtorisë së Sigurimit të Jashtëm (DSJ), organ që drejtohej nga Ilir E. Hoxha në atë kohë. Ky ishte shërbimi më i madh që mund t'i bëhej diktaturës komuniste.

Provat për këtë veprimtari të tyre antishqiptare të trajtuar në libër janë absolutisht të pakundërshtueshme. Njëzet prej autorëve të komplotit të lartpërmendur ndodhen në SHBA, nën kontrollin e CIAS. Midis tyre edhe këta tre persona: Guri Streto – ish-zëvendësi i Ilir Hoxhës në detyrë (përkohësisht edhe baxhanak i tij), ish-detektivi i burgosur Hamit Meli, si edhe vëllai i tij, Dari Meli. Në libër keni edhe adresën e Dari Melit në Amerikë dhe numrin e tij të telefonit. Veçse bëhet fjalë për një linjë telefonike speciale, e cila i filtron telefonatat.

Siç jeni informuar nga përmbajtja e dy vëllimeve të librit, njëzet kuadrot e shërbimit sekret shqiptar që mbahen nën kontrollin e CIAs, disponojnë në Shqipëri një arkiv shumë të pasur me materiale ilustruese të atyre ngjarjeve të jetuara: filmime të shumta, fotografi pa hesap, incizime sekrete e dokumente shkresore tronditëse. Për fat të mirë, ata i përkasin sot kryesisht moshës 58–62 vjeç, pra një moshë aktive pune dhe pjekurie maksimale.

Ndërkohë dy varre akuzues ndodhen në Tiranë, të dy heronjve Fatmir Merdari e Afrim Pahia. Familja Merdari është me origjinë nga Korça, por janë banorë të hershëm të Tiranës. Familja Pahia e ka origjinën nga Kavaja, por banojnë prej një kohe të gjatë në Tiranë.

Të nderuar gazetarë shqiptarë!

A ka ndonjë vështirësi për ju t'i verifikoni këta varre trimash në Tiranë dhe të

kontaktoni me familjet respektive, për tu informuar rreth jetës dhe fundit të bijve të tyre martirë të kombit ? Kolegët tuaj rrezikojnë sot jetën në Afrikë, për t'i ndjekur nga afër ato ngjarje të rrezikshme, që nuk ndodhin në vendin e tyre. Juve ju duhet fare pak punë në kushte komode në qytetin tuaj, për tu bindur për vërtetësinë e ngjarjeve të një libri, që hap një perspektivë kombëtare për zgjidhjen e problemeve të rënda që përjeton populli shqiptar, pjesë e të cilit jeni edhe ju vetë, familjet e fëmijët tuaj. Ashtu siç u bind kuadri belg që shqyrtoi gjatë e gjerë dosjen time për disa vjet, para se të më njihej me zemër të thyer e drejta e azilit politik. Për vdekjen e Fatmirit dhe të Afrimit ka dosje të posaçme të ilustruara me fotografi, të cilat i ka parë me sytë e tij personi që shqyrtonte dosjen time. Si gazetarë, ju keni të drejtë t'i shikoni me sytë tuaj ato dosje, mbasi nuk përbëjnë ndonjë sekret. Madjé, për hir të së vërtetës, duhet pranuar se shthurja e shtetit krijon hapësira më të mëdha manovrimi për një gazetar të përkushtuar në profesion.

Mendoj se ju duhet t'i inkurajoni familjet e atyre heronjve që, me ndihmën tuaj, të kërkojnë të hidhet dritë mbi të vërtetën e rrethanave në të cilën bijtë e tyre kanë humbur jetën. Është e drejta e atyre familjeve që ta kërkojnë edhe në rrugë gjyqësore diçka të tillë. Ata nuk janë varre të rëndomtë që t'i mbulojë pluhuri i kohës, por janë varre heronjsh të rrallë, që Shqipërisë po i mungojnë prej një kohe shumë të gjatë. Mbi të gjitha, zbardhja e asaj të vërtete përbën një akuzë të drejtpërdrejtë e shumë të argumentuar ndaj autoriteteve amerikane, të cilave do t'iu faturoheshin edhe riparimet e pasojave të sabotimit që kanë bërë, gjë që do t'i jepte një shtysë të fuqishme pozitive zgjidhjes së drejtë të problemit kombëtar e shoqëror të shqiptarëve. Njëkohësisht do të shërbente si zanafillë e një miqësie të shëndetshme e dinjitoze me popullin e qeverinë amerikane. Ata nuk pranojnë miq zvarranikë, që tremben nga hieja e tyre. Këtë kategori dykëmbëshash ata e quajnë të denjë për skllevër dhe nuk hezitojnë ta trajtojnë si të tillë, mbasi vetë e kanë arritur gjithçka me sakrifica, pa pritur t'ua dhuronte kush, siç presim ne shqiptarët.

Si gazetarë, ju e keni mundësinë të informoheni, se cili ka qenë Guri Streto dhe ku ndodhet ai tani. Dhe pse vazhdon të qëndrojë ende në Amerikë, kundër dëshirës, ndërkohë që familja e tij nuk di asgjë të saktë sesi i ka shkuar filli djalit të tyre shumë të talentuar, shumë trim e po aq të pushtetshëm në atë kohë në Tiranë. Ashtu siç mbahen sot edhe anëtarët e tjerë të grupit të tij antidiktatorial. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për vëllezërit Hamit e Dari Meli të lindur në lagjen *Palorto* të Gjirokastrës.

Ata të njëzetë përbëjnë një kontigjent të rrallë heronjsh të gjallë, të cilët me aftësitë e horizontin profesional që disponojnë, si edhe konceptet bashkëkohore amerikane për lirinë e demokracinë, do të shërbenin si oksigjen jetëdhënës për Shqipërinë e asfiksuar. Ndërsa administrata amerikane do të detyrohej të ndryshonte kursin e politikës së saj ndaj kombit shqiptar, duke i hapur perspektiva të mëdha zhvillimit të popullit shqiptar. Ata janë shtet juridik dhe dinë t'i pranojnë e t'i korrigjojnë padrejtësitë, kur dalin në dritë. Në këtë drejtim

ndikon shumë edhe populli i tyre liridashës, kur viktimat politike bëhen publike. Kjo mbetet detyrë e inteligjencies shqiptare në tërësi dhe e gazetarëve në veçanti.

Natyrisht, nëse ata do të hedhin dritë e do t'i publikojnë shkaqet e dramës shqiptare, mirënjohja mbarëpopullore ndaj tyre nuk do të mungojë në një rast të tillë, të papërsëritshëm. Përndryshe, shpresa për një të ardhme të denjë të popullit e të kombit shqiptar do të mbetet përgjithmonë e varrosur në varret e Fatmir Merdarit e Afrim Pahisë.